European Commission

JRC TECHNICAL REPORTS

Monitorimi i zhvillimeve të politikave bujqësore në vendet e Ballkanit Perëndimor

Autorë: Tina Volk, Miroslav Rednak, Emil Erjavec, Edvin Zhllima, Grigor Gjeci, Sabahudin Bajramović, Željko Vaško, Dragana Ognjenović, Jakub Butković, Mihone Kerolli-Mustafa, Ekrem Gjokaj, Bekim Hoxha, Dragi Dimitrievski, Ana Kotevska, Ivana Janeska Stamenkovska, Aleksandra Martinovic, Darko Konjevic, Mirsad Spahic, Natalija Bogdanov, Ružica Papić, Saša Todorović

Redaktorë: Tina Volk, Emil Erjavec, Pavel Ciaian, Sergio Gomez y Paloma

2017

South Eastern Europe
SWG RRD
Regional Rural Development Standing Working Group

EUR 28527 EN

Ky publikim është një Raport Teknik nga Qendra e Përbashkët Kërkimore (QPK), shërbimi shkencor dhe kërkimor i Komisionit Evropian. Ky entitet ka si qëllim të ofrojë mbështetje shkencore të bazuara në dëshmi apo fakte për procesin e krijimit të politikave evropiane. Produkti shkencor i shprehur nuk nënkupton një qëndrim politik nga Komisioni Evropian. As Komisioni Evropian e as ndonjë person që vepron në emër të Komisionit nuk është përgjegjës për përdorimin e mundshëm të këtij botimi.

Informacione kontakti
Pavel Ciaian
Adresa: Edificio Expo. C/Inca Garcilaso, 3. E-41092 Seville (Spain)
E-mail: pavel.ciaian@ec.europa.eu
Tel.: +34 95 448 8429
Fax: +34 95 448 8300

Qendra Shkencore QPK
https://ec.europa.eu/jrc

JRC105784

EUR 28527 EN

Print	ISBN 978-92-79-66934-7	ISSN 1018-5593	doi:10.2760/73968
PDF	ISBN 978-92-79-66935-4	ISSN 1831-9424	doi:10.2760/146697

Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2017

© Bashkimi Evropian, 2017

Ripërdorimi i dokumentit është i autorizuar, në rast se citohet burimi dhe nuk shtrembërohet kuptimi origjinal apo mesazhi i tekstit. Komisioni Evropian nuk duhet të konsiderohet përgjegjës për asnjë pasojë që rrjedh nga ripërdorimi.

Si të citohet ky raport:Volk, T., M. Rednak, E. Erjavec, E. Zhllima, G. Gjeci, S. Bajramović, Ž. Vaško, D. Ognjenović, J. Butković, M. Kerolli-Mustafa, E. Gjokaj, B. Hoxha, D. Dimitrievski, A. Kotevska, I.J. Stamenkovska, A. Martinovic, D. Konjevic, M. Spahic, N. Bogdanov, R. Papić, S. Todorović (autorë); Volk, T., E. Erjavec, P. Ciaian, S. Gomez y Paloma (eds.) (2017), *Monitorimi i zhvillimeve të politikave bujqësore në Balkanin Perëndimor,* Komisioni Evropian, Qendra e Bashkuar e Kërkimit, EUR 28527 EN,doi:10.2760/73968 (Print), doi:10.2760/146697 (PDF).

Të gjitha imazhet © Bashkimi Evropian 2017, me përjashtim të: imazhit në fund të kopertinës nga ana e majtë*: peisazh malor rural*; imazhit në fund të kopertinës nga ana e djathtë: *perime sere* dhe *logoja e SWG* © SWG

Përmbajtja e Lëndës

Falënderime
1 Zhvillimet e politikave bujqësore në vendet e Ballkanit Perëndimor – sintezë rajonale 4
1.1 Hyrje 4
1.2 Bazat e të dhënave dhe shënimet mbi metodologjine 6
1.3 Situata dhe tendencat në bujqësi....9
1.4 Kuadri i politikave bujqësore 17
1.5 Mbështetja buxhetore për bujqësinë 19
1.5.1 Shpenzimet totale buxhetore për bujqësinë....19
1.5.2 Masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte për prodhuesin....21
1.5.3 Masat e zhvillimit strukturor dhe rural 23
1.5.4 Masat e mbështetjes së përgjithshme....25
1.6 Analiza e mbështetjes direkte ndaj prodhuesit....26
Shqipëria....31
Bosnja e Hercegovina....32
Kosova* 33
IRJ e Maqedonisë....33
Mali i Zi 34
Serbia 35
1.7 Konkluzionet dhe rekomandimet mbi politikat 37
1.7.1 Fokusi rajonal....37
1.7.2 Komente përfundimtare dhe detyrat për të ardhmen 39
2 Shqipëria: zhvillimi dhe vlerësimi i politikave bujqësore....42
2.1 Hyrje dhe qasje 42
2.2 Strategjitë dhe dokumentet e programimit për politikat bujqësore 43
2.3 Zhvillimi i politikave bujqësore 43
2.4 Masat e mbështetjes direkte ndaj prodhuesit 46
2.5 Zbatimi i dokumenteve të politikave bujqësore....47
2.6 Përfundime dhe rekomandime për politikat 50
3 Bosnja dhe Hercegovina: zhvillimi dhe vlerësimi i politikave bujqësore 52
3.1 Hyrja dhe qasja 52
3.2 Strategjitë dhe dokumentet e programimit për politikat bujqësore 53
3.3 Zhvillimi i politikave bujqësore 56
3.4 Masat e mbështetjes direkte ndaj prodhuesit 58
3.5 Zbatimi i dokumenteve të politikave bujqësore....63
3.6 Përfundime dhe rekomandime për politikat 64
4 Kosova*: zhvillimi dhe vlerësimi i politikave bujqësore 67

4.1 Hyrje 67
4.2 Strategjitë dhe dokumentet programuese për politikat bujqësore 67
4.3 Zhvillimi i politikave bujqësore 69
4.4 Pagesat direkte 71
4.5 Zbatimi i dokumenteve të politikave bujqësore 73
4.6 Përfundime dhe rekomandime për politikat 73
5 IRJ e Maqedonisë: zhvillimi dhe vlerësimi i politikave bujqësore 75
5.1 Hyrje dhe qasja 75
5.2 Strategjitë dhe dokumentet programuese për politikat bujqësore 75
5.3 Zhvillimi i politikave bujqësore 77
5.4 Mbështetja direkte ndaj prodhuesit 79
5.5 Përfundime dhe rekomandime për politikat 81
6 Mali i Zi: zhvillimi dhe vlerësimi i politikave bujqësore 83
6.1 Hyrje dhe qasje 83
6.2 Strategjitë dhe dokumentet programuese për politikat bujqësore 83
6.3 Zhvillimi i politikave bujqësore 84
6.4 Pagesat direkte 89
6.5 Vlerësimi i zbatimit të dokumenteve të politikave bujqësore dhe përfundimet 90
7 Serbia: zhvillimi dhe vlerësimi i politikave bujqësore 92
7.1 Hyrje dhe qasja 92
7.2 Strategjitë dhe dokumentet programuese për politikat bujqësore 92
7.3 Zhvillimi i politikave bujqësore 95
7.4 Mbështetja direkte ndaj prodhuesit 97
7.5 Zbatimi i dokumenteve të politikave bujqësore 100
7.6 Përfundime dhe rekomandime për politikat 102
Referenca 104
Lista e akronimeve dhe përkufizimeve 107
Lista e figurave 109
Lista e tabelave 111

Falënderime

Ky raport është bazuar në rezultatet e *projektit 'Instrumentet e politikave kombëtare dhe procesi i përafrimit në BE: Efektet në njësitë ekonomike bujqësore në vendet e BP-së'*, financuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Qendrës së Përbashkët Kërkimore e Komisionit Evropian.

Do të donim të falënderonim të gjitha organizatat pjesëmarrëse dhe individët për punën profesionale dhe entuziaste që bënë gjatë zbatimit të projektit. Në veçanti, do të donim të falënderonim Boban Ilic, Sekretarin e Përgjithshëm të SWG-së, dhe ekipin e zyrës qendrore/sekretariatit të SWG-së për asistencën e tyre dhe bashkëpunimin e ngushtë në zbatimin e projektit.

Do të donim të shprehnim falënderimin dhe mirënjohjen tonë ndaj Z. Marius Lazdinis nga Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (DG AGRI E.5) për mbështetjen e tij në zbatimin e projektit dhe komentet e tij të vlefshme mbi rezultatet e projektit.

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për menaxheren rajonale të projektit, Irena Dzimrevska. Gjithashtu vlerësojmë tej mase asistencën teknike të Oliver Pop Arsov.

1 Zhvillimet e politikave bujqësore në vendet e Ballkanit Perëndimor – sintezë rajonale

Tina Volk*, Miroslav Rednak* dhe Emil Erjavec**

* Instituti Bujqësor i Sllovenisë
** Universiteti i Lubjanës, Fakulteti i Bio-teknikës

1.1 Hyrje

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian (BE) është padyshim një qëllim politik për vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) ([1]), edhe pse këto vende janë në faza të ndryshme të integrimit([2]). Përshtatja dhe modernizimi i bujqësisë luajnë role të rëndësishme në këtë proces dhe monitorohen nga vendimmarrësit kombëtarë, të cilët përdorin Instrumente të Para-Antarësimit, ndryshime në legjislacion, ngritjen e institucioneve dhe reformave të politikave bujqësore për të përmirësuar zhvillimin e sektorit bujqësor dhe të zonave rurale.

Reformat e politikave bujqësore mund të marrin forma të ndryshme dhe mund të kryhen bazuar në koncepte dhe ritme ndryshimi vazhdimisht të luhatshme brenda një periudhe kohe të caktuar. Megjithatë, që politika të shërbejë si një mjet për të arritur synime të caktuara, reformat duhet të planifikohen, drejtohen dhe ekzekutohen në përputhje me parimet e politikë-bërjes bazuar në evidenca. Kjo do të thotë që një qeveri moderne duhet të prodhojë politika të cilat janë të bazuara në fakte të prekshme, dhe jo në ideologji, që janë pro-aktive dhe jo reaktive, dhe të cilat adresojnë shkaqet dhe jo simptomat.

Parimet teorike të politikës bujqësore moderne shprehin që politikat e bazuara në evidenca janë të mbështetura në fakte objektive të ngritura me rigorozitet, të dhëna të vlefshme, përdorimin dhe zhvillimin e mjeteve empirike, ne analizën e politikave, matjen krahasuese dhe vlerësimet e ndikimeve të tyre. Rrjedhimisht, qeveritë e vendeve të BP-së jo vetëm që po punojnë drejt harmonizimit të bujqësisë së tyre në kuadër të anëtarësimit të tyre të mundshëm në BE, por gjithashtu po bashkëpunojnë për të ndërtuar themelet e një politike bujqësore moderne dhe efikase. Edhe pse politikat e përbashkëta bujqësore (PPB) mundet të mos paraqesin gjithmonë një model të politikës të bazuar në evidenca, elementët e listuar më sipër përfshihen vazhdimisht në PPB dhe rrjedhimisht mund të shërbejnë si shembull për vendet e BP-së.

Vendet e BP-së janë në faza të ndryshme të krijimit të kësaj lloj politikëbërjeje. Ndërsa zhvillimi dhe cilësia e monitorimit të politikave është vetëm në një fazë fillestare në disa vende, në vendet e tjera tashmë realizohen raporte të rregullta vjetore për sa i përket situatës së sektorit bujqësor. Megjithatë, raportimi i transfertave buxhetore drejt bujqësisë është kryesisht më pak transparent, ndërkohë që vlerësimet e ndikimit/impaktit të politikave praktikisht nuk ekzistojnë, duke rezultuar në një cilësi të ulët të planifikimit të politikave dhe në një vendimmarrje që nuk bazohet në evidenca.

Një rrjet ekonomistësh bujqësorë nga institucione akademike udhëheqëse, që koordinohen dhe drejtohen nga një grup ekspertësh i Institutit Bujqësor të Sllovenisë dhe Universitetit të Lubjanës, po përpiqet të adresojë këtë boshllëk dhe të prezantojë një logjikë të re në hartimin e politikave në rajon. Ky rrjet ka qenë aktiv që prej vitit 2008 i cili fillimisht u formua nën ombrellën e një projekti kërkimor të FP7-ës (Volk 2010) me qëllimin për të krijuar një sistem të mbledhjes sistematike dhe të

([1]) Ky punim përdor termin 'Ballkani Perëndimor' për të përfshirë vendet e rajonit: Shqipëria (AL), Bosnje dhe Hercegovina (BA), Kosovë* (në linjë me UNSCR 1244/99 dhe Opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës, XK), Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (MK), Mali i Zi (ME) dhe Serbia (RS),

([2]) Për sa i përket statusit të pranimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, konsultoni: http://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/check-current-status_en.

krahasueshëm të të dhënave në nivel ndërkombëtar për bujqësinë dhe politikat bujqësore të cilat mund të shërbejnë për monitorimin dhe analizën e politikave bujqësore. Si rrjedhojë, grupi i kërkimit gradualisht ka ndërtuar një bazë të dhënash të pavarur dhe ka përgatitur një set analizash dhe vlerësimesh të situatave dhe zhvillimeve në bujqësi dhe politikat bujqësore, të cilat gjithashtu mund të lejojnë matjet krahasuese rajonale me PPB-në e BE-së. Kjo infrastrukturë është duke u përdorur tashmë për të mbështetur vendimmarrjen në rajon, veçanërisht për hartimin e dokumenteve strategjikë, dhe shërben si një burim i rëndësishëm të dhënash dhe analizash faktike për komunitetin ndërkombëtar.

Që prej vitit 2010, kjo punë kërkimore e kryer në 3 projekte të ndryshme, ka luajtur një rol të veçantë edhe në aktivitetet e Grupit të Përhershëm të Punës për Zhvillimin Rural Rajonal (SWG). Rezultatet e projektit të parë, i cili u financua nga Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara (FAO), mund të gjenden në Volk et al. (2014); projekti i dytë u financua nga Qendra e Përbashkët Kërkimore e Drejtorisë së Përgjithshme (QPK) e Komisionit Evropian (KE) dhe është publikuar në Volk et al (2016). Raporti aktual është bazuar në rezultatet e projektit të tretë, 'Instrumentet e politikave kombëtare dhe procesi i Përafrimit me BE-në: Efektet në njësitë ekonomike bujqësore të vendeve të BP-së (EUEWB)' projekt i cili u financua nga QPK-ja. Objektivat kryesore të këtij projekti janë sigurimi i mbështetjes analitike për vendimmarrësit në rajon nëpërmjet përditësimit të statistikave bujqësore dhe mbështetjes në monitorimin cilësor dhe sasior të politikave bujqësore në vendet e BP-së. Gjithashtu, projekti po tenton të përmirësojë kapacitetin analitik të vendeve kandidate duke forcuar institucionet e tyre dhe duke trajnuar ekonomistët bujqësorë që merren me politikat bujqësore. Rrjeti gjithashtu ka përgatitur analiza specifike për vendet, të cilat jepen në raport të ndara në kapituj më vete.

Ky kapitull prezanton rezultatet e monitorimit të bujqësisë dhe politikave bujqësore në vendet e BP-së në formën e një raporti përmbledhës. Analizat e situatave dhe trendeve janë të bazuara në të dhëna të grumbulluara nga ekspertë kombëtarë dhe përdoren në raportet e vendeve përkatëse (Kapitujt 2 deri 7). Ky kapitull përpiqet të tregojë (1) modelet kryesore të zhvillimit në prodhimin dhe tregtinë e vendeve të BP-së; (2) një përmbledhje të shkurtër të kuadrit të ri të politikave (dokumentet e reja të programimit) dhe zbatimin e tij; (3) shtrirja dhe struktura e transfertave buxhetore për bujqësi duke e krahasuar midis vendeve në aspektin e përafrimit të tyre me PPB-në; dhe (4) karakteristikat kryesore të mbështetjes së direkte për prodhuesin në rajon. Analizat kryesisht mbulojnë periudhën 2010 – 2015.

Raporti i mëparshëm (Volk et al, 2016) tregon që dokumentet e reja strategjike të lidhura me bujqësinë rajonale, të adoptuara nga vendet e BP-së janë relativisht moderne dhe janë të orientuara drejt integrimit në BE. Pyetja mbetet nëse këto dokumente kanë sjellë apo jo ndryshime reale në politikat e vendeve të BP-së në vitet e para të zbatimit të tyre; kjo mund të përcaktohet duke përdorur analiza të detajuara të transfertave buxhetore, sic dhe përshkruhet në këtë raport. Këto analiza gjithashtu u përdorën për të përcaktuar shkallën dhe drejtimin e përafrimit me PPB-në e BE-së dhe orientimin zhvillues të politikave bujqësore në vendet e BP-së.

Çështja analitike kryesore në këtë raport është vlerësimi i mbështetjes direkte për prodhimin, i cili është instrumenti kryesor i politikave bujqësore në pjesën më të madhe të vendeve të BP-së (si edhe PPB-ja). Për herë të parë, llojet e mbështetjes, kriteret e përzgjedhjes të lidhura me to dhe shumat e përfshira, prezantohen në mënyrë transparente. Analiza e shprehur në këtë raport gjithashtu tenton të japë një pamje të ngjashmërive dhe ndryshimeve për sa i përket mbështetjes direkte për vendete BP-së krahasuar me atë për BE-në.

Analizat tona cilësore dhe sasiore na lejojnë që të nxjerrim disa përfundime dhe rekomandime të përgjithshme në nivel rajonal mbi reformat dhe përshtatjet e politikës bujqësore. Gjithashtu kemi tentuar të nxjerrim disa teza për sa i përket çështjeve madhore në politikat bujqësore kombëtare të BP-së për të mbështetur edhe më tej reformën dhe modernizimin e këtyre politikave.

1.2 Bazat e të dhënave dhe shënimet mbi metodologjinë

Analizat cilësore dhe sasiore të bujqësisë dhe zhvillimit të politikës bujqësore në vendet e BP-së janë të bazuara në të dhëna dhe informacione të siguruara nëpërmjet ekspertëve akademikë kombëtarë dhe janë të mbledhura në tre baza të dhënash të secilit vend që përmbajnë (1) statistikat kryesore të përgjithshme dhe ato bujqësore, (2) të dhëna mbi transfertat buxhetore për bujqësinë, dhe (3) një inventar të skemave direkte të mbështetjes për fermat. Të dhënat vijnë nga burime të ndryshme, kryesisht nga zyrat statistikore kombëtare, organet administrative shtetërore (ministritë e bujqësisë, Agjencitë e Pagesave) dhe nga dokumente të politikave bujqësore (programuese dhe ligjore). Këto baza të dhënash u zhvilluan me qëllimin e krijimit të një sëre të dhënash sa më i qëndrueshëm dhe koherent që të jetë e mundur dhe që të ofrojnë krahasueshmëri të mirë në kohë dhe midis vendeve të BP-së, veçanërisht në kontekstin e procesit të integrimit në BE dhe përgatitjen e strategjive kombëtare mbi politikat bujqësore dhe planeve të veprimit në të ardhmen.

Baza e përgjithshme e të dhënave statistikore bujqësore është hartuar për vitet 2005 – 2015, bazuar në një model të përbashkët dhe e organizuar në një sërë tabelash të para-përcaktuara për tema specifike të dhënash të cilat mbulojnë treguesit e përgjithshëm (makroekonomik) kryesorë, të gjitha fushat kryesore të statistikave bujqësore (strukturën e fermave, përdorimin e tokës bujqësore dhe prodhimin, çmimet e produkteve bujqësore, llogaritë ekonomike për bujqësinë) dhe tregtinë e sektorit agro-ushqimor.

Në vitet e fundit, shumica e vendeve të BP-së kanë bërë një progres të konsiderueshëm në harmonizimin e statistikave të tyre bujqësore me metodologjitë e BE-së. Megjithatë, ky proces kryesisht është përfunduar në Ish Republikën Jugosllave (IRJ) të Maqedonisë, në Kosovë sipas Rregullores së Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara 1244/99 (Kosovë*) dhe në Serbi (Tabela 1.1), edhe pse të dhënat nuk janë të gjitha të disponueshme ose janë publikuar me një vonesë të gjatë kohore në këto vende. Në vende të tjera të BP-së, ende nuk ka të dhëna për disa nga fushat më të rëndësishme të statistikave bujqësore.

Në Shqipëri, nuk ka të dhëna mbi strukturën e fermave, çmimet e produkteve bujqësore apo llogaritë ekonomike për bujqësinë. Të dhënat për strukturën e fermës dhe llogaritë ekonomike për bujqësinë nuk janë të disponueshme në Bosnje e Hercegovinë, ndërsa në Malin e Zi, me përjashtim të llogarive ekonomike për bujqësinë, të dhënat mbi çmimet e produkteve bujqësore mungojnë. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe IRJ e Maqedonisë ende nuk kanë të dhëna të besueshme (dhe të harmonizuara) mbi përdorimin aktual të tokës bujqësore (sipërfaqe bujqësore e shfrytëzuar, SBSH). Statistikat e prodhimit nuk janë harmonizuar me rregullat e Eurostat-it në Shqipëri dhe Bosnje dhe Hercegovinë, ndërsa në Kosovë* harmonizimi i statistikave të prodhimit është duke u kryer, bazuar në Censusin e Bujqësisë të kryer së fundmi (2014); prandaj, një rishikim i setit të të dhënave mund të pritet të kryhet në të ardhmen.

Tabla 1.1. Vlerësimi i njehsimit të metodologjive statistikore në vendet e BP-së me rregullat dhe përkufizimet e Eurostat-it, 2015

	AL	BA	XK	MK	ME	RS
Treguesit makroekonomikë	+	+	+	+	+	+
Tregtia e jashtme	+	+	+	+	+	+
Struktura e fermave	/	/	+(2014)	+(2007, 2010, 2013)	+(2010)	+(2012)
Përdorimi i tokës (SBSH)	-	-	+(nga 2014)	-	+(nga 2007)	+(nga 2005)
Prodhimi bujqësor	-	-	+/-	+(nga 2007)	+(nga 2007)	+(from 2005)
Çmimet e produkteve bujqësore	/	+(nga 2014)	+	+	/	+(nga 2013)
Llogaritë ekonomike për bujqësinë	/	/	+(nga 2005)	+(nga 2006)	/	+(nga 2007)

+, kryesisht e harmonizuar; +/-, harmonizim i paplotë;-, e pa-harmonizuar; /, nuk ka të dhëna.

Burimi: analiza e autorëve.

Në këtë raport përmbledhës, vlerësimi i tendencave kryesore në prodhimin bujqësor dhe tregtinë fokusohet në periudhën 2010-2015. Zhvillimet në prodhimin bujqësor u analizuan bazuar në të dhëna mbi ndryshimet e volumit të prodhimit bujqësor, përllogaritur nga llogaritë ekonomike për bujqësinë të cilat ishin të disponueshme për Kosovën*, IRJ të Maqedonisë dhe Serbinë. Për vendet e tjera, këto zhvillime u vlerësuan bazuar në të dhënat e disponueshme mbi kulturat bimore kryesore, numrat e krerëve të blegtorisë dhe prodhimin e qumështit.

Të dhënat mbi mbështetjen buxhetore për bujqësinë janë mbledhur në bazat e të dhënave të masave të politikave bujqësore (MPB). Në këto baza të dhënash, i gjithë informacioni sasior i disponueshëm mbi politikat bujqësore për secilin vend të BP-së mblidhet çdo vit në nivelin e masave të detajuara. Mblidhen të dhëna mbi karakteristikat e secilës masë politike dhe transfertave buxhetore (monetare) të kryera. Për Malin e Zi, baza e të dhënave të MPB-së përmban fondet e planifikuara dhe jo pagesat që janë ekzekutuar aktualisht, sepse të dhënat mbi fondet e disbursuara/paguara nuk janë të disponueshme për publikun. Analiza e mbështetjes bujqësore në këtë raport mbulon periudhën 2010 – 2015, edhe pse shumica e vendeve të BP-së kanë plotësuar bazat e të dhënave të MPB-së për periudha më të gjata.

Masa në bazat e të dhënave të MPB-së janë sistemuar dhe klasifikuar në përputhje me një model të përbashkët (uniform). Sipas klasifikimit të MPB-së, masat grupohen në tre shtylla kryesore: (1) masat mbështetëse të tregut dhe direkte për prodhuesin; (2) masat e zhvillimit strukturor dhe rural; dhe (3) masat e përgjithshme lidhur me bujqësinë (Tabela 1.2).

Tabela 1.2. Skema e klasifikimit të MPB-së e mbështetjes buxhetore për bujqësinë.

Masat mbështetëse të tregut dhe direkte ndaj prodhuesit			
	Masat e mbështetjes së tregut (subvencionet për eksportet; ndërhyrjet në treg; kostot e rezervave publike)		
	Masat mbështetëse direkte ndaj prodhuesit		
		Pagesat direkte dhe subvencionet për input variabël	
			Pagesat direkte për prodhuesin (të zbërthyera më tej sipas kritereve të zbatimit) Subvencionet për input variabël (të zbërthyera më tej sipas llojit të inputit)
		Pagesat për katastrofa dhe kompensime të tjera për prodhuesit (të zbërthyera më tej sipas kritereve të zbatimit)	
		Të ndryshme (mbështetje direkte për prodhuesin)	
Masat e zhvillimit strukturor dhe rural			
	Përmirësimi i konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor		
		Mbështetje për investimet dhe ristrukturimin e fermës	
			Mbështetje investimi në fermë (e përgjithshme; kulturat bimore të përhershme; përmirësimi i tokës; të tjera)
			Mbështetje për ristrukturime të tjera në fermë (ndihmë për nisjen e aktiviteteve fermere; adaptimi me standardet; pjesëmarrja në skemat e cilësisë së ushqimit; të tjera)
		Mbështetje për ristrukturimin e agro-ushqimit	
			Mbështetje në lidhje me infrastrukturën bujqësore (infrastrukturë hidrologjike dhe infrastruktura të tjera për tokën; konsolidim i tokës; të tjera)
			Mbështetje për përpunimin ushqimor, marketing dhe promovim (investime në përpunimin ushqimor; veprime marketingu dhe promovimi; grupet e prodhuesve; të tjera)
		Mbështetje për pyjet	
	Përmirësimi i mjedisit dhe fshatit		
		Pagesa për fermerët në zona me vështirësi natyrore (zona që përballen me vështirësi natyrore apo me kufizime të tjera specifike; zona të mbrojtura; e zbërthyer më tej sipas kritereve të zbatimit)	
		Pagesat për mirëqenien e bujqësisë-mjedisit-klimës-krerëve të blegtorisë (zbërthyer më tej sipas kritereve të zbatimit)	
		Pagesa të tjera lidhur me mjedisin	
	Mbështetje për ekonominë dhe popullsinë rurale		

		Shumëllojshmëria e aktiviteteve në ferma
		Masa të tjera për të mbështetur ekonominë dhe popullsinë rurale (krijimi dhe zhvillimi i biznesit; zhvillimi i zonave rurale dhe infrastrukturës rurale; të tjera; LEADER)
Masa të përgjithshme të lidhura me bujqësinë		
	Shërbime kërkimi, zhvillimi, këshillimi dhe ekspertësh (kërkim dhe zhvillim, shërbime ekstensioni; trajnim profesional; shërbime ekspertësh)	
	Siguria e ushqimit dhe kontrolli i cilësisë (kontrolli veterinar; kontrolli i shëndetit të bimës; kontrolli i cilësisë)	
	Masa të tjera të mbështetjes së përgjithshme (organizatat e fermerëve dhe joqeveritare; sistemet e informimit; asistencë teknike; të tjera)	
Të ndryshme		

Burimi: analiza e autorëve, bazuar tekRednak et al. 2013

LEADER, Liaison Entre Actions de DéveloppementdelʼÉconomieRurale/Lidhjet Midis Ekonomisë Rurale dhe Veprimeve Zhvillimore.

Klasifikimi i MPB-së përdor konceptin e BE-së mbi klasifikimin e politikave, kombinuar me metodologjinë e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) (OECD 2008). Klasifikimi i MPB-së ndërtohet në parimin hierarkik, me nivelin e parë që përkufizon shtyllën e politikave bujqësore, niveli i dytë përkufizon kategorinë e politikave dhe secili nivel vijues përcakton një nën-kategori të nivelit të mëparshëm (Rednak et al. 2013). Një sistem hierarkik lejon të analizosh në nivele të ndryshme agregimi. Në këtë raport të dhënat janë paraqitur deri në nivelin e tretë, dhe në disa raste, nivelin e katërt ose të pestë të klasifikimit.

Për të krahasuar nivelin e mbështetjes midis vendeve, transfertat buxhetore për bujqësinë në euro (totali dhe sipas grup-masave) janë shprehur për hektarë të SBSH-së. Për të llogaritur këtë tregues, për Kosovën*, Malin e Zi dhe Serbinë u përdorën të dhënat e SBSH-së nga censusi bujqësor, ndërsa për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe IRJ e Maqedonisë, SBSH-ja u vlerësua bazuar në statistikat e disponueshme për tokën bujqësore në total (Tabela 1.3) ([3]).

Tabela 1.3. Sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar e përdorur për llogaritjen e niveleve relative të mbështetjes buxhetore për bujqësinë në vendet e BP.

	AL	BA	XK	MK	ME	RS
SBSH (mijë hektarë)	955.5 ([a])	1 152.2 ([b])	413.6 ([b])	724.0 ([a])	221.3 ([b])	3 437.4 ([b])

([a]) Vlerësimi i autorëve bazuar në të dhënat e vitit 2013 mbi tokën bujqësore.
([b]) Të dhëna të censusit bujqësor (Kosovë*, 2014; Mali i Zi, 2010; Serbi, 2012).

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore.

Bazuar në një inventar të skemave të politikave të përgatitura nga ekspertët kombëtarë, u krijuan baza të dhënash të mbështetjes direkte të fermave, për të siguruar një pamje të përgjithshme të karakteristikave kryesore të kësaj lloj mase politike në secilin rajon. Modeli i përbashkët për mbledhjen e të dhënave u organizua në dy seksione, duke marrë parasysh kërkesat bazë të sistemit klasifikues të MPB-së. Seksioni i parë përfshin pagesat direkte dhe subvencionet për inputet (përfshirë në shtyllën e parë të MPB-së), e cila ndahet më tej në katër grupe, sipas tipit të pagesës (për prodhim, për hektarë, për krerë apo për input). Seksioni i dytë ka të bëjë me pagesat e lidhura me mjedisin dhe pagesat e lidhura me zonat që përballen me vështirësi natyrore (ZVN) (të përfshira këto në shtyllën e dytë të MPB-së). Inventari është përgatitur çdo vit që prej vitit 2010 për të gjitha skemat e zbatuara të pagesave.

Pas miratimit nga vendet partnere, të dhënat thelbësore nga të tre bazat e të dhënave, pra, statistikat bujqësore, MPB-ja dhe skemat e mbështetjes direkte për prodhuesit, u

([3]) Në të gjitha vendet ku censusi bujqësor u krye në përputhje me metodologjinë e Eurostat-it, u tregua që statistikat e rregullta të tokës bujqësore janë mbivlerësuar, kryesisht për sa i përket sipërfaqes me kullota të përhershme (me rreth 50% mesatarisht). Rrjedhimisht, totali i MPB-së për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe IRJ të Maqedonisë u vlerësua duke reduktuar shumën totale të tokës bujqësore me tokën bujqësore të papërdorur të regjistruar dhe me 50 % të tokës si kullota të përhershme.

kombinuan në një bazë të dhënash bujqësie dhe politikash bujqësore të konsoliduar (më vete për çdo vend), duke përdorur të njëjtën qasje për të gjitha vendet. Edhe pse baza e konsoliduar e të dhënave u krijua kryesisht për monitorimin dhe vlerësimin e zhvillimeve bujqësore dhe të politikave bujqësore brenda këtij projekti, ajo mund të konsiderohet edhe si një prezantim i mëvetësishëm i të dhënave të sektorit agro-ushqimor në vendet e BP-së.

Baza e konsoliduar e të dhënave për të gjitha vendet e BP-së është publikuar në hapësirën publike të faqes së internetit të projektit (http://app.seerural.org/) dhe rrjedhimisht është e disponueshme për analiza krahasuese të mëtejshme dhe për analiza më të detajuara dhe të fokusuara, për përdorim më të gjerë nga vendimmarrësit dhe të interesuarit si në nivelet kombëtare, ashtu edhe rajonale e ndërkombëtare (Tabela 1.4).

Tabela 1.4. Baza e konsoliduar e të dhënave për bujqësinë dhe politikat bujqësore hartuar për vendet e BP-së: pamje e faqes së përmbajtjes.

	Shqipëria
	PËRMBAJTJA
1	STATISTIKA TË PËRGJITHSHME KRYESORE
2	STATISTIKA BUJQËSORE KRYESORE
3	PRODHIMI BUJQËSOR
3.1	Bimet: Sipërfaqja dhe prodhimi
3.2	Blegtoria dhe produktet blegtorale: përmasa e kopesë dhe prodhimi
4	ÇMIMET
4.1	Çmimet e prodhimit bujqësor (çmimet e prodhuesve në fermë)
4.2	Treguesit e çmimit të prodhimeve bujqësore (nuk disponohen)
4.3	Treguesit e çmimit të inputeve bujqësore (nuk disponohen)
5	TREGTIA AGRO-USHQIMORE
5.1	Eksportet agro-ushqimore sipas grup-mallrave
5.2	Importet agro-ushqimore sipas grup-mallrave
5.3	Bilanci i tregtisë agro-ushqimore sipas grup-mallrave
5.4	Detajimi rajonal i tregtisë se produkteve agro-ushqimore
6	STRUKTURA E FERMËS (nuk disponohet)
7	LLOGARITË EKONOMIKE PËR BUJQËSINË (nuk disponohen)
8	POLITIKAT BUJQËSORE
8.1	Skemat e pagesave direkte dhe subvencionet per inputet
8.2	Mbështetja buxhetore për bujqësinë sipas skemës së klasifikimit të MPB-së
8.3	Mbështetja buxhetore për bujqësinë sipas skemës së klasifikimit OECD/PSE
	Simbole statistike
-	E paaplikueshme
0	Më pak se gjysma e njësisë
:	Nuk disponohet

Burimi: analiza e autorëve.

1.3 Situata dhe tendencat në bujqësi

Rimëkëmbja ekonomike

Në vitin 2015, ekonomitë e BP-së shfaqën disa zhvillime pozitive që tregonin fillimin e rimëkëmbjes nga ngadalësimi i ashpër apo rënia në prodhimin e brendshëm bruto (PBB) e cila u nxit nga kriza ekonomike globale në vitin 2008. Serbia regjistroi një rritje prej 0,8% në aspektin e PBB-së reale në vitin 2015, ndërkohë që në vendet e tjera të BP-së rritja e PBB-së ishte në mënyrë të ndjeshme më e lartë, midis 3% dhe 4%. PBB-ja për

frymë – e matur me paritetin e fuqisë blerëse (PFB) – ishte 29% e mesatares së BE-28 në Shqipëri dhe Bosnje dhe Hercegovinë, 36% në Serbi, 37% në IRJ të Maqedonisë dhe 41% në Malin e Zi.

Nivelet e inflacionit ishin të ulëta (poshtë 2%) ku në Bosnje dhe Hercegovinë dhe IRJ të Maqedonisë ishin negative. Niveli i papunësisë ende është i lartë në të gjitha vendet e BP-së, por ka rënë lehtësisht në Kosovë* (në 33% në vitin 2015), IRJ të Maqedonisë (në 26%) dhe Serbi (në 18%), dhe mbeti i qëndrueshëm në Bosnje dhe Hercegovinë (28%) dhe Malin e Zi (20%). Në vitin 2015, niveli i papunësisë u rrit vetëm në Shqipëri, duke arritur nivelin e saj më të lartë që nga fillimi i recesionit global (18%).

Bujqësia vazhdon të jetë një sektor i rëndësishëm ekonomik

Në të gjitha vendet e BP-së bujqësia është një sektor i rëndësishëm për ekonominë kombëtare. Në vitin 2015, përqindja e vlerës së shtuar bruto totale (VSHB) gjeneruar nga sektorët e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit ishte rreth 22% në Shqipëri dhe midis 8% dhe 13% në vendet e tjera të BP-së (Tabela 1.5). Në shumicën e vendeve të BP-së, rëndësia relative ekonomike e bujqësisë në ekonominë kombëtare pati një tendencë në rënie, duke treguar që sektorët e tjerë të ekonomisë po zhvilloheshin më shpejt.

Tabela 1.5.Rëndësia e bujqësisë në ekonominë e vendeve të BP-së.

	AL		BA		XK		MK		ME		RS	
	2010	2015	2010	2015	2010	2015	2010	2015	2010	2015	2010	2015
VSHB për bujqësinë (% ndaj totalit VSHB)	21.2	21.6	8.6	7.6	16.2	13.5	11.7	11.4	9.2	9.8	10.2	8.2
Punësimi në bujqësi (% ndaj punësimit total)	54.9	44.7	19.7	17.9	n/a	n/a	19.1	17.9	n/a	n/a	22.2	19.5

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (të dhënat për vitin 2015 janë paraprake)

Disa zhvillime pozitive në luhatshmërinë e prodhimit bujqësor

Prodhimi i kulturave bimore në kohë, në të gjitha vendet e BP-së karakterizohet nga luhatje të mëdha të nxitura kryesisht nga kushtet e motit. Që prej vitit 2010 prodhimet e kulturave bimore janë ndikuar ashpër nga thatësira në vitin 2012 dhe nga shirat e shumta dhe përmbytjet në vitin 2014 në shumicën e vendeve të rajonit, duke rezultuar kështu në rënie të menjëhershme të prodhimit të kulturave bimore kryesore në këto vite. Viti 2015 ishte i favorshëm për shumicën e kulturave bujqësore, veçanërisht për rrushin, por gjithashtu për frutat, perimet dhe patatet, ndonëse prodhimet e drithërave ishin poshtë mesatares së periudhës 2010–2014 në shumicën e vendeve (me përjashtim të Bosnjes dhe Hercegovinës).

Që prej vitit 2010, prodhimet e kulturave bimore në përgjithësi kanë treguar tendenca në rritje në Shqipëri, Kosovë*, IRJ të Maqedonisë dhe Malin e Zi, tendenca lehtësisht në rënie në Serbi ndërsa në Bosnje dhe Hercegovinë tendencat ishin të paqarta (Figura 1.1).

Në Shqipëri, zhvillimet e përgjithshme pozitive tregohen nga tendencat në rritje të prodhimeve të perimeve dhe patates, dhe niveleve të qëndrueshme të prodhimit të drithërave. Midis nën-sektorëve më të rëndësishëm të prodhimit, vetëm prodhimi i frutave ka treguar një tendencë negative që prej vitit 2010.

Kosova* karakterizohet nga luhatjet më të mëdha në prodhimin e kulturave bimore midis të gjitha vendeve të BP-së. Tendenca e përgjithshme pozitive në prodhimin e kulturave bimore kryesisht pasqyron tendencën në rritje në prodhimin e drithërave dhe frutave. Zhvillimet në prodhimin e perimeve dhe patateve janë kryesisht negative.

Në IRJ të Maqedonisë tendenca e përgjithshme pozitive në prodhimin e kulturave bimore është rezultat i një tendence në rritje në prodhimin e perimeve, frutave dhe rrushit, të

cilët janë nën-sektorët më të rëndësishëm në këtë vend, që përfaqësuan respektivisht 47% dhe 19% të prodhimit total të kulturave bimore në periudhën 2010-2014. Prodhimi i drithërave nuk ka treguar një tendencë të veçantë që prej vitit 2010, ndërkohë që tendencat në prodhimin e duhanit dhe patates janë lehtësisht negative.

Zhvillimi i prodhimeve të kulturave bimore në Malin e Zi përgjithësisht vlerësohet si pozitiv, sepse prodhimi në të gjithë nën-sektorët kryesorë të kulturave bimore (me përjashtim të rrushit) shfaqi një tendencë në rritje në periudhën 2010-2015.

Në Bosnje dhe Hercegovinë që prej vitit 2010 nuk shikohet asnjë tendencë e qartë në prodhimin e kulturave bimore, bazuar kjo në tendencat e prodhimit të kulturave kryesore bimore. Në periudhën 2010-2015 një tendencë lehtësisht në rritje u vu re në prodhimin e drithërave, perimeve dhe rrushit dhe kishte një tendencë lehtësisht në rënie në prodhimin e frutave dhe patateve.

Prodhimi i kulturave bimore në Serbi është kryesisht i përbërë nga drithërat, të cilat përfaqësojnë mesatarisht 44% të prodhimit total të kulturave bimore për periudhën 2010-2015. Që prej vitit 2010, prodhimi i drithërave nuk ka treguar asnjë tendencë të veçantë. Midis nën-sektorëve të tjerë kryesorë të kulturave bimore, prodhimi i frutave dhe farërave vajore ka treguar zhvillime pozitive, ndërkohë që rrushi dhe perimet kanë treguar tendenca në rënie. Në periudhën 2010-2015 u regjistrua një tendencë lehtësisht në rënie në prodhimin total të kulturave bimore.

Figura 1.1. Prirjet në nivelet e prodhimit të kulturave bimore në vendet e BP-së për periudhën 2010-2015 (përqindjet ndaj niveleve në 2010)



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore.

Prodhimi blegtoral përgjithësisht është më pak i luhatshëm sesa prodhimi bimor, edhe pse, veçanërisht në Kosovë*, po gjithashtu edhe në Malin e Zi dhe IRJ të Maqedonisë, luhatjet nga viti në vit në numrin e blegtorisë dhe niveleve të prodhimit të qumështit ishin të mëdha (rreth 10% në disa vite) (Figura 1.2).

Në periudhën 2010-2015, zhvillimet në prodhimet blegtorale ishin kryesisht pozitive në Shqipëri, Malin e Zi dhe Serbi; kryesisht negative në IRJ të Maqedonisë dhe Kosovë*, dhe pa një tendencë të përgjithshme të qartë në Bosnje dhe Hercegovinë (Figura 1.2).

Në Shqipëri, tendencat pozitive shihen në të gjithë nën-sektorët e rëndësishëm të blegtorisë, veçanërisht në numrin e bagëtive të imëta (dele dhe dhi). Një përfundim i ngjashëm mund të nxirret edhe për Malin e Zi, ku vetëm numrat e gjedhëve nuk treguan një tendencë të qartë, ndërsa numrat e deleve dhe dhive, si edhe nivelet e prodhimit të qumështit, kanë qenë në rritje.

Në Serbi, rritja në prodhimin blegtoral kryesisht u ndikua nga nivelet në rritje të prodhimit të qumështit; sektori i rritjes së shpendëve dhe derrit treguan tendenca negative.

Në Kosovë* dhe IRJ të Maqedonisë, tendenca e përgjithshme në prodhimin blegtoral ishte negative dhe kjo u ndikua nga tendenca në rënie në të gjithë sektorët kryesorë të blegtorisë, me përjashtim të sektorit të rritjes së shpendëve në Kosovë* dhe qumështit në IRJ të Maqedonisë.

Në Bosnje dhe Hercegovinë, nuk mund të identifikohet qartë asnjë tendencë e veçantë në prodhimin blegtoral. Numri e gjedhëve, të leshtave dhe të dhirtave, si dhe nivelet e prodhimit të qumështit, ishte i qëndrueshëm, ndërkohë që sektori i rritjes së shpendëve tregoi një tendencë në rritje dhe sektori i rritjes së derrit tregoi një tendencë në rënie.

Figura 1.2. Prirjet në numrin e krerëve të blegtorisë dhe niveleve të prodhimit të qumështit në vendet e BP-së, 2010 – 2015 (Perqindja ndaj niveleve në 2010)



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore.

Duke marrë parasysh zhvillimet në prodhimin bimor dhe shtazor, vlerësojmë se tendencat në prodhimin bujqësor total për periudhën 2010 – 2015 ishin pozitive në Shqipëri, Malin e Zi dhe IRJ të Maqedonisë, nuk shfaqën ndryshime në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë* dhe ishin lehtësisht negative në Serbi (Figura 1.3).

Figura 1.3. Prirjet në nivelet e prodhimit bujqësor agregat në disa prej vendeve të BP-së, 2010-2015 (perqindja ndaj nivelit në vitin 2010) ([a])



(a) Të dhënat e prodhimit bujqësor agregat nuk janë të disponueshme për Shqipërinë, Malin e Zi dhe Bosnje dhe Hercegovinën.

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore.

Duke qenë se prodhimi bimor mbizotëron prodhimin bujqësor, themi se zhvillimet në Kosovë*, IRJ të Maqedonisë dhe Serbi (Figura 1.3), kryesisht kanë ardhur si pasoje e ndryshimeve të po këtij prodhimi. Që prej vitit 2010, mesatarisht, prodhimi bimor në Kosovë*, në IRJ të Maqedonisë dhe Serbi ka përfaqësuar respektivisht 56%, 75% dhe 65% të prodhimit bujqësor.

Tregtia në rritje e sektorit agro-ushqimor

Në të gjashtë vendet e BP-së, sektori i agro-ushqimit është një kontribues i rëndësishëm për tregtinë e jashtme totale të vendit si për eksportet, ashtu edhe për importet, si edhe për bilancin e përgjithshëm tregtar të vendeve. Në vitin 2015 pjesa e eksporteve të produkteve agro-ushqimore ndaj eksporteve në total ndryshonte midis 9% në Shqipëri dhe Bosnje dhe Hercegovinë, në 21 % në Serbi (Tabela 1.6). Pjesa e importeve është midis 8 % në Serbi dhe 25 % në Malin e Zi. Që prej vitit 2010 pjesa e eksporteve të produkteve agro-ushqimore ndaj eksporteve në total është rritur ndjeshëm në pjesën më të madhe të vendeve të BP-së (me përjashtim të IRJ të Maqedonisë dhe Serbisë), ndërkohë që pjesa e importeve të produkteve agro-ushqimore ka qënë e qëndrueshme.

Tabela 1.6. Rëndësia e sektorit agro-ushqimor në tregtinë e jashtme në vendet e BP-së.

	AL		BA		XK		MK		ME		RS	
	2010	2015	2010	2015	2010	2015	2010	2015	2010	2015	2010	2015
Eksportet e produkteve agro-ushqimore (% ndaj eksporteve totale)	5.9	8.7	7.9	9.4	8.3	12.8	16.5	11.9	14.1	17.0	22.6	21.3
Importet e produkteve agro-ushqimore (% ndaj importeve totale)	18.2	17.8	18.1	18.1	22.4	23.9	12.8	12.0	24.5	25.2	7.2	8.1

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (të dhënat për vitin 2015 janë paraprake)

Tregtia e produkteve agro-ushqimore ka patur një tendencë në rritje në të gjashtë vendet e BP-së, e dukshme kjo tek normat më të larta të rritjes, të regjistruara për

eksportet përgjithësisht dhe jo për importet (Figura 1.4). Në vitin 2015, eksportet e produkteve agro-ushqimore treguan rritjet më të larta në Shqipëri dhe Bosnje e Hercegovinë (me 28 % dhe 27 % respektivisht, krahasuar me vitin 2014), ndjekur nga Serbia (12 %) dhe Kosova* (6 %). Në IRJ të Maqedonisë eksportet e produkteve agro-ushqimore vazhdojnë të jenë në nivele të ngjashme me ato të vitit 2014 (dhe 2013), ndërkohë që në Malin e Zi ranë ndjeshëm krahasuar me vitin 2014 dhe u kthyen në nivelet e viteve 2010 – 2013.

Figura 1.4. Tregtia e produkteve agro-ushqimore në vendet e BP-së (milionë euro),2010-2015



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (të dhënat për vitin 2015 janë paraprake).

Serbia në mënyrë tradicionale ka pasur një bilanc pozitiv të tregtisë së produkteve agro-ushqimore dhe teprica e saj në përgjithësi tregon një tendencë në rritje (u rrit me 22 % në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014). Të gjitha vendet e tjera të BP-së janë importues neto të të mirave agro-ushqimore. Në Shqipëri dhe Bosnje e Hercegovinë, deficitet e tregtisë agro-ushqimore janë të qëndrueshme, ndërsa në Kosovë*, Malin e Zi dhe veçanërisht në IRJ të Maqedonisë, bilancet tregtare po përkeqësohen (rritje e deficiteve). Në vitin 2015 deficitet në këto tre vende u ngritën me 2 %, 5 % dhe 32 % respektivisht, krahasuar me vitin 2014.

Eksportet, si një pjesë e importeve, ndryshojnë ndjeshëm sipas vendit. Në vitin 2015 kjo pjesë varionte nga 7 % në Kosovë*, në 60 % në IRJ të Maqedonisë dhe 193 % në Serbi, me një tendencë pozitive që prej vitit 2010 në të gjitha vendet e BP-së, me përjashtim të IRJ të Maqedonisë (Figura 1.5).

Figura 1.5. Eksportet e produkteve agro-ushqimore si një pjesë e importeve të produkteve agro-ushqimore në vendet e BP-së, 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (të dhënat për vitin 2015 janë paraprake).

Produktet kryesore të eksportuara (sipas grupeve tarifore) në vitin 2015 ishin farërat vajore, perimet dhe mishi i përpunuar në Shqipëri; yndyrat shtazore dhe vajrat, frutat dhe mishi në Bosnje e Hercegovinë; pijet, produktet e industrisë së blojes dhe perimet në Kosovë*; duhani, perimet dhe prodhimet e drithërave në IRJ të Maqedonisë; pijet, mishi dhe duhani në Malin e Zi; dhe frutat, drithërat dhe duhani në Serbi (Tabela 1.7)

Tabela 1.7. Përbërja e eksporteve agro-ushqimore sipas grupeve më të rëndësishme tarifore në shtetet e BP-së (%)

		AL		**BA**		**XK**		**MK**		**ME**		**RS**	
		2010	**2015**	**2010**	**2015**	**2010**	**2015**	**2010**	**2015**	**2010**	**2015**	**2010**	**2015**
02	Mish, Prodhime qumështi, veze	1.5	0.6	2.4	**11.9**	0.2	0.4	4.1	2.7	**7.6**	**13.3**	1.2	1.8
07	Perime të ngrënshme	4.9	**19.5**	5.4	3.6	**14.9**	**7.7**	**15.8**	**13.7**	7.4	6.7	3.4	3.1
08	Fruta të ngrënshme, arra	4.2	9.4	**8.1**	**12.3**	2.7	7.0	9.5	11.0	**10.2**	6.0	**16.1**	**20.5**
10	Drithërat	0.1	0.0	5.0	4.1	0.6	1.7	0.7	0.8	0.0	0.0	**19.3**	**17.1**
11	Prodhime të industrisë së blojës	0.0	0.0	0.4	1.2	**25.0**	**10.0**	0.0	0.2	1.3	3.4	2.5	2.2
12	Farërat vajore	**23.1**	**19.5**	1.0	0.9	2.0	3.1	0.9	0.7	0.3	0.2	3.0	4.6
15	Yndyrna dhe vajra	1.1	0.6	**9.8**	**14.1**	0.4	0.1	2.0	3.9	1.9	0.4	6.9	5.8
16	Nënprodukte mishi	**27.6**	**17.0**	**7.7**	5.9	0.0	1.2	4.1	2.3	5.1	5.3	1.6	1.7
19	Prodhime drithërash	0.6	5.3	6.7	7.7	1.6	5.0	8.0	**12.3**	4.1	6.0	4.8	3.9
22	Lëngje, pije alkoolike, uthull	2.0	2.6	6.1	5.2	**21.5**	**38.4**	**14.5**	10.2	**45.1**	**39.3**	**8.2**	6.7
24	Duhan	**5.7**	2.3	3.7	2.8	0.3	0.0	**22.4**	**20.1**	0.3	**10.3**	2.5	**8.8**

Shifrat për tre grupet më të mëdha tarifore eksportese për secilin vend janë theksuar me **të zeza**.

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (të dhënat për vitin 2015 janë paraprake).

Për produktet më të rëndësishme të eksportuara, një rritje në eksporte si një përqindje ndaj totalit të eksporteve, krahasuar me vitin 2010, u regjistrua për frutat dhe prodhimet e drithërave në pjesën më të madhe të vendeve të BP-së, duhanin në Malin e Zi dhe Serbi, mishin në Malin e Zi dhe Bosnje e Hercegovinë, ndërkohë që pjesa e perimeve u rrit vetëm në Shqipëri dhe pjesa e pijeve u rrit vetëm në Kosovë*.

Destinacioni më i rëndësishëm i eksporteve në 2015-ën për Shqipërinë, IRJ e Maqedonisë dhe Serbinë ishte BE. Pjesa më e madhe eksporteve të Kosovës* dhe Malit të Zi, shkonte drejt vendeve të tjera të BP-së dhe pjesa më e madhe e Bosnjes e Hercegovinës u shkonte vendeve të treta (jashtë BE-së dhe rajonit të BP-së) (Figura 1.6).

Pjesa e eksporteve me destinacion BE-në në përgjithësi ka rënë në të gjitha vendet e BP-së që prej vitit 2013, kur Kroacia u pranua në BE, ndërkohë që pjesa e eksporteve drejt vendeve të treta është rritur.

Figura 1.6.Përbërja rajonale e eksporteve të produkteve agro-ushqimore në vendet e BP-së, 2010-2015



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (të dhënat për vitin 2015 janë paraprake).

CEFTA, Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë

Për sa i përket importeve, BE është partneri më i rëndësishëm tregtar për produktet agro-ushqimore për shumicën e vendeve të BP-së dhe rëndësia e saj vazhdon në rritje që prej vitit 2010.

Përjashtim bën Mali i Zi, ku importet që vijnë nga vendet e BP-së përfaqësojnë pjesën më të madhe të importeve të produkteve agro-ushqimore totale, dhe Shqipëria gjithashtu, ku pjesa e importeve nga BE është e qëndrueshme (pothuajse 60 %, Figura 1.7).

Figura 1.7.Përbërja rajonale e importeve të produkteve agro-ushqimore në vendet e BP-së, 2010-2015



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (të dhënat për vitin 2015 janë paraprake).

CEFTA, Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë

1.4 Kuadri i politikave bujqësore

Sikundër përshkruar në një raport të mëparshëm (Volk et al. 2016), të gjitha vendet e BP-së kanë bërë një progres të konsiderueshëm përgjatë viteve të fundit në për-afrimin me kërkesat e BE-së te dokumenteve të tyre programuese afatgjata dhe infrastrukturave administrative. Midis viteve 2013 dhe 2015, u adoptuan dokumente të reja strategjike për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të cilët kryesisht mbulojnë periudhën deri në vitin 2020 (deri në vitin 2019 për Federatën e Bosnje e Hercegovinës (FBH) dhe deri në 2024 për Serbinë) (Tabela 1.8).

Objektivat afatmesme e afatgjata dhe prioritetet e politikave bujqësore të shprehura në këto dokumente ndryshojnë pak nga vendi në vend, por që të gjithë adresojnë (1) rritjen e qëndrueshmërisë së fermave dhe konkurueshmërisë së sektorit agro-ushqimor; (2) menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike; (3) përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillimin e balancuar territorial dhe ekonomik të zonave rurale.

Në disa vende, prioritetet kryesore gjithashtu përfshijnë stabilizimin e të ardhurave të fermerit (Bosnja e Hercegovina, Kosova* dhe Serbia), organizimin e zinxhirit ushqimor (IRJ e Maqedonisë dhe Kosova*), promovimin e standardeve të cilësisë dhe sigurisë së ushqimit (IRJ e Maqedonisë) dhe investimin në kapitalin njerëzor, transferimin e njohurive dhe inovacionin (Shqipëria, IRJ e Maqedonisë dhe Kosova*). Synimet bazë të politikës bujqësore përputhen me ato të PPB-së së BE-së për të njëjtën periudhë.

Në shumicën e vendeve, dokumenti kryesor strategjik është plotësuar nga një program zbatimi shumëvjeçar. Paralelisht, gjithashtu u përgatitën programet e Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi për Zhvillimin Rural (IPARD) për të siguruar dokumente kryesore për sa i përket mbështetjes së para-anëtarësimit në BE në fushën e bujqësisë, kryesisht me qëllimin e ndërtimit të institucioneve dhe përmirësimit të sektorit bujqësor (Tabela 1.8). Megjithatë, krijimi i institucioneve të nevojshme për zbatimin e programit IPARD nuk është përfunduar në asnjë nga vendet e BP-së, me përjashtim të IRJ të Maqedonisë, e cila ka rezultuar në vonesa në përdorimin e fondeve të BE-së.

Tabela 1.8. Pamje e përgjithshme e dokumenteve të programimit afatmesëm dhe afatgjatë në vendet e BP-së.

	Strategjia për zhvillimin bujqësor dhe rural	Programet kombëtare/planet e veprimit	IPARD II
AL	Strategjia Kombëtarë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (ISARD/SKZHBR) 2014-2020 (2014)	Plani i veprimit për zbatimin e ISARD 2014-2020 (2014) Plani i veprimit për zbatimin e ISARD 2016-2018 (2016)	Përgatitur dhe miratuar nga KE (2015)
BA	Strategjia Afatmesme për Zhvillimin e Sektorit Bujqësor në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës 2015-2019 (2014) Plani Strategjik për Zhvillimin Bujqësor dhe Zonave Rurale në Republikën Serbe të Bosnjës (RSR) 2016-2020 (2015)	Programi i Zhvillimit Rural për Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës 2015-2020 (2014, i pa adoptuar)	Në proces përgatitjeje (që prej 2014)
XK	Programi për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural 2014-2020 (2013)	Kuadri Afatmesëm i Shpenzimeve 2016-2018 (2015) Programi i Reformimit Ekonomik 2016-2018 (2016)	Përgatitur
MK	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (SKZHBR) 2014-2020 (2014)	Programi Kombëtar për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural 2013-2017 (2013)	Përgatitur dhe miratuar nga KE (2015)
ME	Strategjia për Zhvillimin Bujqësor dhe Zonave Rurale 2015-2020 (2015)	Plan veprimi për përafrimin *acquis*, Kapitulli 11 –Zhvillimi Bujqesor dhe Rural 2015-2020 (2015)	Përgatitur dhe miratuar nga KE (2015)
RS	Strategjia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural 2014-2024 (2014)		Përgatitur dhe miratuar nga KE (2016)

Burimi: Raportet e vendeve të BP.

Bazuar në informacionin e siguruar nga ekspertët kombëtarë në raportet e vendeve, dokumentet strategjike dhe programuese vënë në dukje nevojën për të harmonizuar kuadrin institucional dhe ligjor me standardet e BE-së, ndërkohë që harmonizimi i masave me PPB-në, veçanërisht për sa i përket mbështetjes direkte për prodhuesit, nuk adresohet qartë dhe kjo është planifikuar për në fund të periudhës së programimit ose datës së pranimit.

Malit të Zi iu desh të përgatiste një plan veprimi special në fushën e bujqësisë për përshtatjen e politikës bujqësore si parakusht për fillimin e negociatave të pranimit në BE. Kuadri i programimit të këtij vendi parashikon futjen graduale të pagesave njeherëshe për siperfaqe (a single area payment) për kulturat e arave, kulturat e përhershme dhe kullotat, përkrah reduktimit të pagesave të lidhura në sektorin e blegtorisë (dhe për duhanin), i cili duhet të fillojë në vitin 2016 dhe të bëhet plotësisht operativ në vitin 2020.

Reduktimi në numrin e skemave direkte të pagesave si një hap i parë drejt "ndarjes" së pagesave direkte gjithashtu parashikohet për Bosnje e Hercegovinë. Në FBH dokumenti i ri strategjik parashikon unifikimin e pagesave për sipërfaqe për shumicën e kulturave bimore dhe heqjen e mbështetjes për sektorin e rritjes së shpendëve, ndërkohë që në Republikën Serbe të Bosnjës (RSR), pagesat aktuale, të cilat bazohen në prodhimin e të mirave, do të transformohen në pagesa për sipërfaqe (me përjashtim të grurit). Në të dy njësitë administrative, gjithashtu parashikohet një reduktim gradual i pagesës për qumësht të prodhuar (për litër) dhe rritja e njëkohshme e pagesave për lopë qumështi (për krerë).

Të gjitha dokumentet e programimit e vënë në dukje rëndësinë e politikave të zhvillimit rural dhe e formojnë/hartojnë atë në përputhje me parimet dhe direktivat strategjike të politikave të zhvillimit rural të BE-së. Karakteristikat kryesore të kuadrove të reja strategjike në të gjitha vendet e BP-së janë: forcimi i masave të lidhura me zhvillimin rural dhe rritja e alokimeve buxhetore për zbatimin e tyre.

Masat e propozuara të zhvillimit rural janë kryesisht të krahasueshme me direktivat e programimit të BE-së për periudhat 2007 – 2013 dhe 2014 – 2020. Masat kryesisht synojnë:

— mbështetjen e investimeve në fermë, zhvillimin e infrastrukturës bujqësore (menaxhimin e ujit, transferimin e tokës dhe konsolidimin e tokës), investimin në përpunimin ushqimor, marketingun dhe promovimin, përmirësimin e cilësisë së produktit dhe sigurimin e standardeve të sigurisë së ushqimit, krijimin dhe forcimin e kooperimit horizontal (grupet e prodhuesve, kooperativat e fermave dhe shoqatat e fermave);

— mbështetjen dhe zbatimin e praktikave të mira bujqësore, skemat për mirëqenien e krerëve dhe agro-mjedisore, zbutjen e ndryshimit të klimës, ruajtjen e burimeve gjenetike të bimëve dhe krerëve dhe mbrojtjen e pyjeve dhe bujqësisë organike;

— mbështetjen e diversifikimit të aktiviteteve të fermave, zhvillimin e biznesit dhe zhvillimin e infrastrukturës rurale;

— mbështetjen e përgatitjes dhe zbatimit të strategjive lokale të zhvillimit rural (Qasja Liaison Entre Actions de Développement del'Économie Rurale (LEADER);

— forcimin e transferimit të njohurive në bujqësi nëpërmjet trajnimeve të përmirësuara, këshillimit bujqësor dhe shërbimeve të ekstensionit.

Pavarësisht ndryshimeve në dokumentet e programimit, politikat aktuale në vitet e para të zbatimit të tyre kanë të njëjtat karakteristika kryesore si ato të mëparshmet dhe rrallëherë kanë pësuar ndryshime reale (shikoni seksionin 1.5). Politikat afatshkurtra janë të bazuara kryesisht në programet dhe buxhetimin vjetor, të cilat, nga ana tjetër, ndikohen gjerësisht nga situata politike dhe ekonomike në vend. Raportet nga ekspertët e vendeve tregojnë një progres të kufizuar në zhvillimin e mbështetjes analitike për vendimmarrjen e politikave bujqësore; ka disa përmirësime në monitorim, por asnjë ndryshim të rëndësishëm në elementet e tjera të politikave të bazuara në evidenca.

1.5 Mbështetja buxhetore për bujqësinë

1.5.1 Shpenzimet totale buxhetore për bujqësinë

Në të gjitha vendet e BP-së tendencat në nivelet e mbështetjes totale për bujqësinë janë të paqëndrueshme, edhe pse pati një tendencë në rritje në periudhën 2010 – 2015 (Tabela 1.9). Vetëm në Bosnje e Hercegovinë ka pasur një tendencë të konsiderueshme rënëse në mbështetjen totale buxhetore që prej vitit 2010. Rritja më konstante, dhe më e theksuar në mbështetjen totale buxhetore, në 2015 u regjistrua në Kosovë*, ndërsa rritjet më të vogla u regjistruan në Shqipëri dhe në Mal të Zi. Në IRJ të Maqedonisë dhe Serbi, u pa një tendencë rritjeje e qartë deri në vitin 2014, ndërkohë që në vitin 2015 mbështetja totale ra ndjeshëm krahasuar me vitin 2014, kryesisht si rezultat i rënies së fondeve të disbursuara për masat e mbështetjes direkte për prodhuesin (shiko seksionin 1.5.2).

Tabela 1.9. Mbështetja buxhetore totale për bujqësinë në vendet e BP-së (milionë euro), 2010-2015

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	19.0	26.8	23.6	20.1	27.8	35.0
Bosnja dhe Hercegovina	82.2	71.2	82.7	71.0	67.4	63.2
Kosova*	11.0	16.7	22.7	24.0	27.0	59.1
IRJ e Maqedonisë	83.9	72.6	102.3	82.5	128.9	73.3
Mali i Zi	14.6	18.1	17.5	17.6	17.4	20.0
Serbia	191.1	197.5	257.1	268.3	315.4	212.0

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore

Niveli relativ i mbështetjes i matur për hektarë të SBSH-së ndryshon shumë midis vendeve (Figura 1.8). Në vitin 2015 mbështetja totale buxhetore për bujqësinë për hektarë të SBSH-së shkonte në 37 euro në Shqipëri (29 euro në vitin 2014), 55 euro në Bosnje e Hercegovinë (59 euro në vitin 2014), 62 euro në Serbi (92 euro në vitin 2014),

90 euro në Malin e Zi (79 euro në vitin 2014), 101 euro në IRJ të Maqedonisë (178 euro në vitin 2014) dhe 143 euro në Kosovë* (65 euro në vitin 2014).

Figura 1.8. Niveli relativ i mbështetjes totale buxhetore për bujqësinë në vendet e BP-së (euro/ha SBSH)



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore.

Përbërja e mbështetjes totale për bujqësinë ndryshon ndjeshëm sipas vendeve (Figura 1.9). Pjesa e masave të tregut dhe të mbështetjes direkte për prodhuesin (masat e shtyllës së parë) është e lartë në Bosnje e Hercegovinë (rreth 90 %), Serbi (rreth 80 % mesatarisht në 2010-2015) dhe IRJ e Maqedonisë (rreth 70 % mesatarisht), është e ulët në Kosovë* dhe Malin e Zi dhe shumë e ulët në Shqipëri, në të cilën niveli relativ i mbështetjes për bujqësinë gjithashtu është më i ulëti në vendet e BP-së.

Figura 1.9.Përbërja e mbështetjes totale buxhetore për bujqësinë sipas shtyllave të MPB-së në vendet e BP-së, 2010 – 2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore.

Masat e zhvillimit strukturor dhe rural (shtylla e dytë) dhe masat e mbështetjes së përgjithshme të bujqësisë (shtylla e tretë) janë të rëndësishme në Shqipëri (së bashku përfaqësojnë më shumë se 80% të buxhetit total), në Malin e Zi (rreth 70 %) dhe në Kosovë* (rreth 50% në 3 vitet e fundit). Në këto tre vende, një pjesë e konsiderueshme e fondeve për masat e mbështetjes bujqësore vijnë nga donatorë të huaj, të cilat kryesisht janë të fokusuara në zhvillimin rural (shtylla e dytë) dhe asistencën teknike (shtylla e tretë).

Ndërkohë që përgjatë viteve të fundit ka pasur ndryshime në mbështetjen buxhetore totale për bujqësinë, nuk janë vënë re ndryshime të ndjeshme në përbërjen e saj në vendet e BP-së. Megjithatë, në shumicën e vendeve pjesa e fondeve të shtyllës së parë është rritur lehtësisht.

1.5.2 Masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte për prodhuesin

Në kontekstin e shtyllës së parë të politikave bujqësore, pjesa më e madhe e fondeve është fokusuar drejt masave të mbështetjes direkte për prodhuesin. Në periudhën e studimit disa masa në mbështetje të tregut (ndërhyrjet e tregut) ekzistonin vetëm në Bosnje e Hercegovinë dhe Malin e Zi (listuar në dokumentet e programit). Rrjedhimisht, analiza e detajuar është e fokusuar vetëm në pjesën e shtyllës së parë që është e lidhur me masat e mbështetjes direkte për prodhuesin.

Shumica e vendeve në rajon tregojnë një tendencë në rritje për fondet e disbursuara për masat e mbështetjes direkte për prodhuesin. Që prej vitit 2010, rritja më e fortë dhe konstante e financimit për mbështetjen direkte për prodhuesin është regjistruar në Kosovë* dhe Serbi deri në vitin 2014. Në vitin 2015 mbështetja direkte për prodhuesin në Serbi ra ndjeshëm, kryesisht si rezultat i kritereve të ndryshuara për përzgjedhjen e disa masave të mbështetjes direkte (pagesë maksimale më e ulët për përfituesit; shikoni seksionin 1.6). Në Bosnje e Hercegovinë dhe Malin e Zi, buxheti për mbështetjen direkte për prodhuesin është i qëndrueshëm, ndërsa ndryshon ndjeshëm në IRJ të Maqedonisë midis viteve (Tabela 1.10). Luhatjet vjetore në mbështetjen direkte për prodhuesin në IRJ të Maqedonisë kryesisht shkaktohen nga vonesat në pagesat për masat e zbatuara në vitet e mëparshme. Në vitin 2015 vetëm një pjesë e vogël e detyrimeve të pagesave direkte për këtë vit iu paguan fermerëve.

Tabela 1.10. Mbështetja direkte për prodhuesin në vendet e BP-së (milionë euro), 2010-2015.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	0.9	0.4	1.6	2.0	3.0	5.3
Bosnja dhe Hercegovina	41.7	58.8	48.7	56.9	52.6	56.6
Kosova*	3.5	5.7	8.7	11.9	15.3	27.8
IRJ e Maqedonisë	66.1	51.3	75.7	61.4	103.6	43.6
Mali i Zi	4.0	4.4	5.3	5.3	4.9	5.0
Serbia	141.9	138.1	210.8	229.1	278.9	172.5

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore

Në terma relativë, mbështetja direkte për hektarë të SBSH-së në vitin 2015 përbënte më pak se 6 euro në Shqipëri, 23 euro në Malin e Zi, rreth 50 euro në Bosnje e Hercegovinë dhe Serbi (zbriti nga 81 euro në vitin 2014 në Serbi), 60 euro në IRJ të Maqedonisë (zbriti nga 143 euro në vitin 2014) dhe 67 euro në Kosovë* (u rrit nga 37 euro në vitin 2014; Figura 1.10). Niveli i mbështetjes direkte për prodhuesin është ende ndjeshëm më i ulët sesa ai në BE, ku vlera mesatare e mbështetjes direkte në vitin 2015 ishte 236 euro/ha, me një variancë midis 83 euro/ha në Letoni dhe 451 euro/ha në Maltë([4]).

([4]) Vlera për hektarë e mbështetjes direkte në Vendet Anëtare të BE-së përllogaritet duke pjesëtuar vlerën totale të shpenzimeve të mbështetjes direkte (shumat e planifikuara) me SBSH , të dyja për 2015. Shpenzimet e mbështetjes direkte në nivelin e Shteteve Anëtare u morën nga BE (2016), ndërsa SBSH u mor nga Eurostat.

Në shumicën e vendeve të BP-së, përbërja e mbështetjes direkte për prodhuesin nuk ka ndryshuar shumë që prej vitit 2010. Pagesat direkte për prodhimin (shtesë ndaj çmimit) ende kryhen në të gjitha vendet. Pjesa e kësaj lloj mbështetjeje është veçanërisht e lartë në Bosnje e Hercegovinë dhe në IRJ të Maqedonisë (rreth 60 % e mbështetjes direkte totale për prodhuesit në vitin 2015). Në vendet e tjera të BP-së pagesat e bazuara në sipërfaqe apo numrin e krerëve, përfaqësojnë formën më të rëndësishme të mbështetjes direkte për prodhuesin. Në Kosovë*, praktikisht e gjithë mbështetja direkte për prodhuesin është e këtij lloji (Figura 1.11).

Subvencionet për input variabël ekzistonin në të gjitha vendet, të paktën për disa vite, por kjo lloj mbështetjeje është e konsiderueshme vetëm në Serbi, megjithëse ka pasur një riorientim të qartë nga subvencionet për inputin drejt formave të tjera të mbështetjes direkte që prej vitit 2010 (shikoni seksionin 1.6).

Figura 1.10. Niveli relativ i mbështetjes direkte për prodhuesin në vendet e BP-së (euro/ha të SBSH), 2010 - 2015



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore

Figura 1.11.Përbërja e masave të mbështetjes direkte për prodhuesin në vendet e BP-së, 2010 – 2015



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore

1.5.3 Masat e zhvillimit strukturor dhe rural

Fondet për masat e zhvillimit strukturor dhe rural përgjithësisht janë në nivele të ulëta në të gjitha vendet e BP-së dhe mund të luhaten ndjeshëm në vite. Në periudhën 2010 – 2015 pati një tendencë rritjeje të ndjeshme në nivelet e këtyre fondeve në IRJ të Maqedonisë, Kosovë* dhe Malin e Zi; në Shqipëri në vitin 2015 buxheti u dyfishua krahasuar me vitin 2014; ndërsa në Bosnje e Hercegovinë dhe Serbi pati një tendencë të fortë rënieje në nivelet e këtyre fondeve (Tabela 1.11).

Tabela 1.11. Mbështetja e zhvillimit strukturor dhe rural në vendet e BP-së (milionë euro), 2010–2015.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	15.0	20.4	16.6	9.9	10.7	21.3
Bosnja dhe Hercegovina	30.4	8.2	29.6	6.8	9.2	2.9
Kosova*	4.3	8.6	11.2	9.2	8.3	27.8
IRJ e Maqedonisë	10.6	14.0	19.2	13.0	15.9	20.8
Mali i Zi	4.5	6.5	5.7	5.6	6.4	8.5
Serbia	22.2	19.0	24.5	15.8	12.6	15.6

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore

Në vitin 2015 mbështetja e zhvillimit strukturor dhe rural për hektarë të SBSH-së shkoi në 3 euro në Bosnje e Hercegovinë, 5 euro në Serbi, 22 euro në Shqipëri, 29 euro në IRJ të Maqedonisë, 39 euro në Malin e Zi dhe 67 euro në Kosovë* (në rritje nga 20 euro në vitin 2014; Figura 1.12).

Figura 1.12. Nivelet relative të mbështetjes së zhvillimit strukturor dhe rural në vendet e BP-së (euro/ha, SBSH), 2010 - 2015



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore

Pjesa më e madhe e fondeve nga kjo shtyllë politikash i është ndarë grupit të masave që synojnë përmirësimin e konkurencës së bujqësisë, ndërsa dy aspektet e tjera të politikes së zhvillimit rural (d.m.th. mjedisi, ekonomia rurale dhe popullsia) marrin më pak vëmendje (Figura 1.13).

Përgjatë gjithë periudhës së studimit, u aplikuan masa të ndryshme të mbështetjes që synonin përmirësimin e konkurencës së bujqësisë në secilin vend. Në Bosnje e Hercegovinë, Malin e Zi, Serbi, në IRJ të Maqedonisë dhe Kosovë* në vitin 2015, shumica e fondeve shkuan për mbështetjen e investimeve në fermë. Në Shqipëri dhe IRJ të Maqedonisë (në vitet 2011-2013), mbështetja në lidhje me infrastrukturën bujqësore në

formën e investimeve në infrastrukturën e ujitjes e kullimit dhe menaxhimit të ujërave morën shumicën e fondeve (kjo lloj mbështetjeje gjithashtu ekzistonte në Serbi, por fondet ishin të ulëta). Të gjitha vendet e BP-së alokuan disa fonde në mbështetje të përpunimit të ushqimit, si dhe për marketingun dhe promovimin, gjatë një periudhe të paktën 1 vjeçare, por me përjashtim të Kosovës* në disa vite ku shifrat ishin relativisht të ulëta.

Në Kosovë* në vitin 2015, buxheti për mbështetjen e investimeve në fermë u rrit më shumë se trefishi i vitit të mëparshëm. Në vitin 2014 nisi një program gjithëpërfshirës për mbështetjen e investimeve me synim kryesisht sektorët specifikë. Më shumë se 35% e totalit të mbështetjes për investime u shpërnda për rritjen e shpendëve (prodhimin e vezëve: 7,5 milionë euro), më shumë se 25 % në prodhimin e frutave-perimeve dhe më shumë se 11 % në prodhimin e qumështit. Vëzhgimi i ndikimit të këtyre masave tek prodhimi përgjatë viteve që do të vijnë do të shihej me interes.

Figura 1.13. Përbërja e mbështetjes së zhvillimit strukturor dhe rural në vendet e BP-së, 2010-2015



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore

Mbështetja për përmirësimin e mjedisit dhe zonave rurale është i rëndësishëm në vendet e BP-së (Figura 1.13). Skemat mbi agro-mjedisin nuk po zhvillohen në shkallë të gjerë në asnjë vend. Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina nuk i kanë zbatuar këto masa, ndërkohë që në Kosovë* masa e tillë e parë u prezantua në vitin 2016 në mbështetje të praktikave të bujqësisë organike. Bujqësia organike gjithashtu mbështetet financiarisht në IRJ të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbi. Në IRJ të Maqedonisë dhe Serbi, mbështetja për bujqësinë organike nuk është e përcaktuar në shuma absolute për hektarë apo për njësi të blegtorisë si kompensim për kosto më të larta, por si shtesë ndaj pagesave për prodhimin konvencional (në përqindje). Masa të tjera për mbështetjen e agro-mjedisit

janë kryesisht të lidhura me racat e blegtorisë në rrezik (IRJ e Maqedonisë dhe Serbi), kullotat malore (Malin e Zi) dhe plehun organik (IRJ e Maqedonisë).

Pagesat për ZVN alokohen rregullisht vetëm në IRJ të Maqedonisë. Megjithatë, këto pagesa janë përcaktuar si një suplement (në përqindje) përkundrejt pagesave direkte të rregullta dhe nuk marrin parasysh vështirësitë natyrore aktuale me të cilat përballen këto zona. Që prej vitit 2010, pjesa tashmë e ulët e fondeve të synuara për përmirësimin e mjedisit dhe zonave rurale ka qenë në rënie.

Fondet për mbështetjen e ekonomisë dhe popullsisë rurale, gjithashtu janë modeste. Ky grup masash përfaqësonte një pjesë të rëndësishme të mbështetjes totale të zhvillimit strukturor dhe rural (më shumë se 50 %) vetëm në IRJ të Maqedonisë në vitin 2014, kur filloi një program i ri mbështetjeje 'Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale' (në vitin 2015 nuk u bënë pagesa brenda këtij programi).

1.5.4 Masat e mbështetjes së përgjithshme

Fondet buxhetore për masat e mbështetjes së përgjithshme, me përjashtim të Malit të Zi, janë relativisht të ulëta në të gjitha vendet. Në periudhën 2010 – 2015, pati një tendencë në rritje në nivelet e fondeve në Shqipëri, IRJ të Maqedonisë, Kosovë* dhe Malin e Zi. Në Serbi nivelet e të gjitha këtyre fondeve ishin të qëndrueshëm, ndërkohë që pati një tendencë në rënie në Bosnje e Hercegovinë (Tabela 1.12).

Tabela 1.12 Mbështetja e përgjithshme për bujqësinë në vendet e BP-së (milionë euro), 2010 - 2015

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	3.1	6.0	5.5	8.1	14.0	8.5
Bosnja dhe Hercegovina	5.1	2.2	3.0	3.6	3.0	3.1
Kosova*	3.2	2.4	2.8	2.9	3.4	3.5
IRJ e Maqedonisë	7.3	7.3	7.4	8.0	9.4	8.8
Mali i Zi	5.2	6.1	5.5	5.8	5.7	6.1
Serbia	6.2	22.7	21.5	23.4	24.0	23.9

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore

Në vitin 2015 mbështetja për masat e përgjithshme për hektarë të SBSH-së arriti në 3 euro në Bosnje e Hercegovinë, 7 euro në Serbi, 9 euro në Shqipëri e Kosovë*, 12 euro në IRJ të Maqedonisë dhe 27 euro në Malin e Zi (Figura 1.14).

Figura 1.14.. Niveli relativ i mbështetjes së përgjithshme për bujqësinë në vendet e BP-së (euro/ha e SBSH)



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore

Përbërja e fondeve për mbështetjen e përgjithshme në vitet e fundit nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme (me përjashtim të Shqipërisë). Në shumicën e vendeve kontrolli i sigurisë dhe cilësisë së ushqimit merr pjesën më të madhe të fondeve në këtë shtyllë të politikave (Figura 1.15). Këto pjesë janë veçanërisht të larta në IRJ të Maqedonisë, Kosovë* dhe Serbi.

Në Bosnje e Hercegovinë pjesa e buxhetit për kërkim, zhvillim dhe shërbime këshillimi e eksperti është relativisht e lartë, por shumat absolute të këtyre aktiviteteve mbeten të ulëta për shkak të buxhetit të përgjithshëm të ulët në këtë shtyllë të politikave.

Në periudhën 2014-2015 në Shqipëri, IRJ të Maqedonisë dhe Malin e Zi disa fonde gjithashtu u alokuan për masa të tjera të mbështetjes së përgjithshme, përfshirë mbështetjen teknike, ndërtimin e institucioneve dhe zhvillimin e sistemeve të informimit. Në Malin e Zi dhe Shqipëri disa prej këtyre projekteve u bashkë-financuan nga burime të huaja.

Figura 1.15.Përbërja e mbështetjes së përgjithshme për bujqësinë në vendet e BP-së, 2010-2015



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore

1.6 Analiza e mbështetjes direkte ndaj prodhuesit

Numri i madh i llojeve të ndryshme të skemave mbështetëse

Rishikimi i mbështetjes direkte të fermave e zbatuar në vendet e BP-së përgjatë viteve të fundit (2010-2015) tregon që ky instrument përfaqësohet gjerësisht, dhe në shumicën e vendeve ka një rritje të llojit të tyre. Mbështetja direkte për fermën ndryshon ndjeshëm midis vendeve në: numrin e skemave, llojin e pagesave (për prodhim, për hektarë, për krerë apo për input), mallrat e mbuluara (sektor, nën-sektor dhe të mira të veçanta), kriteret e përzgjedhjes (minimumi për sa i përket sasive të prodhuara, hektarët në kultivim apo numrin e blegtorisë) dhe kështet e pagesës (për njësi apo për përfitues).

Shumica e vendeve të BP-së implementojnë të gjitha llojet e mbështetjes direkte, me përjashtim të Shqipërisë e cila nuk implementon pagesat për sipërfaqe, dhe Kosovës* ku nuk ka pasur pagesa të bazuara në përdorimin e inputit në vitet e fundit. Në të gjitha vendet e BP-së mbështetja e drejtpërdrejtë lidhet me prodhimin (lidhur me një mall specifik apo grup mallrash). Me përjashtim të Shqipërisë, kushti i përgjithshëm që fermerët të përzgjidhen për mbështetje direkte është regjistrimi në regjistrin e fermave. Për më tepër, fermerët duhet të regjistrojnë krerët apo kosheret në bazën qendrore të të dhënave për të qenë kandidatë për mbështetje të lidhur me gjënë e gjallë (me përjashtim të shpendëve). Në IRJ të Maqedonisë pagesat direkte janë të kushtëzuara nga disa kërkesa ndër-pajtueshmërie të ngjashme me Politikat e Përbashkëta të Bujqësisë (PPB).

Të gjitha llojet e mbështetjes direkte për të gjithë sektorët kryesorë

Pagesat për prodhimin (shtesat ndaj çmimit) përdoren gjerësisht vetëm në Bosnje e Hercegovinë (në RSR) dhe IRJ të Maqedonisë. Në vitin 2015, IRJ e Maqedonisë dha pagesa për prodhimin e qumështit të dërguar në baxho, zogj për rritje dhe disa produkte të kulturave bimore (si: duhan, fruta dhe perime për përpunim, farëra dhe fidanë). Në vende të tjera të BP-së kjo lloj mbështetjeje kryesisht është e kufizuar me qumështin në Mali të Zi dhe Serbi; ose qumështin dhe disa sektorë të tjerë specifikë (fruta dhe perime) në Shqipëri, dhe fidanët në Kosovë* dhe FBH.

Me përjashtim të Shqipërisë, sektori i kulturave bimore mbështetet gjerësisht nga pagesat për sipërfaqe që mbulojnë të gjitha kulturat bimore kryesore. Megjithatë, mënyra e zbatimit të këtyre pagesave ndryshon ndjeshëm sipas vendit. Në Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë* pagesat për sipërfaqe për bimët e arave janë të përcaktuara nga malli (për shembull grurë apo misër) dhe në Malin e Zi përcaktohen pjesërisht nga malli (për shembull duhani) dhe pjesërisht nga grupi i mallrave (për shembull foragjeret). IRJ e Maqedonisë implementon pagesën njëherëshe për siperfaqe (a single area payment) për të gjitha bimët e arave (pa përfshirë perimet dhe duhanin) si një skemë pagese bazë e lidhur me prodhimin, me disa pagesa shtesë që përcaktohen nga grupi i mallrave (për shembull drithëra, farëra vajore ose foragjere). Serbia zbaton një pagesë të lidhur të vetme për sipërfaqe për prodhimin e të gjitha bimëve të arave e ato të përhershme (pa përfshirë perimet) dhe e shoqëron me subvencione për inpute për karburantin dhe plehun.

Pagesat direkte për krerë implementohen në të gjitha vendet e BP-së. Në Shqipëri pagesat për krerë jepen rregullisht për delet dhe dhitë dhe për kosheret, ndërsa në Malin e Zi jepen për gjedhët (lopët dhe gjedhët meshkuj që theren) dhe të imtat. Vende të tjera implementojnë një gamë të gjerë të pagesave për krerë duke mbuluar sektorë dhe kategori të ndryshme të blegtorisë, përfshirë derrat dhe shpendët. Në IRJ të Maqedonisë ashtu si në sektorin e kulturave bimore, pagesat direkte konsistojnë në skemat bazë të pagesave dhe disa pagesa të ndryshme shtesë (ndër të tjera për viçat e lindur me mbjellje artificiale, mëshqerra mbarështimi për prodhimin e mishit, gjedhët e therur, qengjat dhe kecat).

Subvencionet për inputin nuk kanë qenë një lloj skeme mbështetjeje e përdorur gjerësisht apo rregullisht në vendet e BP-së gjatë viteve të fundit. Në vitin 2015, kjo lloj mbështetjeje direkte e fermës jepet për sigurimin (për të gjitha vendet me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës*), karburantin (RSR dhe Serbia) dhe për disa inpute të tjera (plehu në Serbi dhe pesticidet për ullishtet në Shqipëri).

Normat e larta të pagesave

Vlera e njësisë së pagesave në skemat e mbështetjes individuale kryesisht vendoset në terma absolutë, vetëm me disa përjashtime. Në Shqipëri dhe në një pjesë të Bosnje e Hercegovinës, disa pagesa direkte të bazuara në prodhim (për frutat dhe perimet e dërguara në qendrat e grumbullimit ose përpunimit në Shqipëri dhe për shumicën e çmimeve të kulturave bimore në RSR) janë vendosur si një përqindje e çmimit të shitjes. Në RSR, pagesat direkte bazuar në numrin e krerëve janë vendosur në formën e një

pakete totale për skemë pagese; pagesa aktuale për njësi blegtorie varet nga numri i miratuar i krerëve të përshtatshëm në secilin vit.

Në Kosovë* vlerat e ndryshme të njësisë vendosen për disa skema pagesash në varësi të vëllimit të prodhimit (pagesat për fidanët) apo sipërfaqes së kultivuar (pagesat për vreshtat dhe shpendët për vezë). Në IRJ të Maqedonisë vlera e njësisë për skemat e pagesave të kulturave bimore bazë dhe blegtorisë vendoset për një numër të kufizuar hektarësh apo numër krerësh dhe kështet e pagesave mbi këto kufinj reduktohen gradualisht me disa pjesë (deri në 90 % të kulturave bimore dhe deri në 80 % të skemave të blegtorisë).

Nivelet absolute të pagesave për njësi janë të vështira të krahasohen midis vendeve për shkak të aplikimit të skemave të ndryshme në aspektet e mallrave (apo kategorive të blegtorisë) dhe kritereve të ndryshme të zbatimit. Në vitin 2015 kështet e pagesës nën skema të ndryshme të lidhura me sipërfaqen varionin midis 50 euro/ha (Serbi) në 256 euro/ha (FBH) për kulturat bimore të kultivuara; nga 97 euro/ha (IRJ e Maqedonisë) në 1 023 euro/ (BA-QB) për bimët e arave dhe 7 699 euro/ha për perimet nën serra xhami (BA-QB); dhe nga 50 euro/ha (Serbia) në 536 euro/ha (IRJ e Maqedonisë) për frutat dhe 1 000 euro/ha për vreshtat (Kosovë*). Gama e vlerave të njësive për pagesa të ndryshme të lidhura me blegtorinë ishte midis 24 euro/krerë (IRJ e Maqedonisë) dhe 230 euro/krerë (FBH) për gjedhët; midis 5 euro/krerë dhe 58 euro/krerë për delet dhe dhitë; midis 8 euro/krerë dhe 77 euro/krerë për derrat; midis 2 euro/koshere dhe 26 euro/koshere për bletët; midis 0,04 euro/krerë dhe 2,5 euro/krerë për kategoritë e ndryshme të shpendëve; dhe midis 0,02 euro/litër (Kosovë*) në 0,15 euro/litër (Bosnja e Hercegovina) për qumështin e dërguar në baxho (Tabela 1.13).

Tabela 1.13. Skemat e pagesve direkte dhe subvencionet e inputit në vendet e BP-së sipas shumës së pagesës për njësi dhe mall/produkt, 2015.

	AL	BA-FBH	BA-RSR	BA-QB	XK	MK	ME	RS
Për Prodhim (euro/kg)								
Qumësht (euro/l)	0.07	0.15	0.05+0.10 ([a])	-	0.06 ([a])	0.06	0.06+0.03([a])+ 0.01 ([b])	0.06
Gruri	-	-	0.03	-	-	-	-	-
Rrepa	-	-	15 %	-	-	-	-	-
Farëra([c])	-	-	15 %; 50 %	-	-	0.13; 0.32	-	-
Duhani	-	-	15 %	-	-	0.97	-	-
Perimet	15 %	-	15 %	-	-	0.02-0.11	-	-
Fruta		-	15 %	-	-	0.03	-	-
Fidanë (euro/copë)	-	0.18; 0.23	15 %	-	0.20 ([e])	0.08-1.14	-	-
Të tjera([d])	-	-	15 %	-	-	0.03; 0.06	-	-
Për Sipërfaqe (euro/ha)								
Të gjitha kulturat bimore	-	-	-	-	-	-	-	50
Bimët e arave	-	-	-	-	-	130 ([e])	160	
Drithëra	-	-	-	-	-	130 ([e]) + 65 ([e])	-	-
Gruri	-	256	128	153	150		-	-
Misri	-	153	-	128	150		-	-
Elbi	-	179	-	128	-		-	-
Farëra vajore	-	205	-	205; 230	150	130 ([e]) + 49 ([e])	-	-
Farëra ([f])	-	409-869	-	-	250	243 ([e]); 975 ([e])	300; 700	-
Foragjere	-	-	-	128	-	130 ([e]) + 16	100; 150	-
Duhani	-	767	-	511	-	-	1 000	-
Perimet	-	523	-	358-1 023; 7 669	300	97-487; (+ 1 761)	-	-
Frutat	-	460	-	256-409	400	243 ([e])-536 ([e])	-	-
Vreshtat	-		-	-	1 000 ([e])	649 ([e])	-	-

Të tjera ([g])	-	205	-	-	-	1 461	-	-
Për Krerë (euro/krerë)								
Gjedhët	-	-	-	-	-	45 ([e])	-	-
Lopët	-	-	-	205 ([h])	70 ([h])	-	70	207
Mëshqerrat për mbarështim	-	230	102	153	-	45 ([e]) + 24		-
Viçat e qumështit	-	230	118	102	-	-	-	166
Viçat	-	-	-	-	-	45 ([e]) + 19	-	-
Gjedhë të therura	-	230	61	153	30	24; 24 + 49	120 ([i]); 140 ([i])	83 ([i])
Dele, dhi	9	18	5	26	15 ([h])	16; 16 + 11	8	58
Qengja të therur	-	-	-	15	-	-	-	17
Dosa mbarështimi	-	77	20	51	20	16	-	58
Derra të therur	-	31	8	26	-	16 ([e])	-	8
Shpendë të rritur me shtim natyror	-	0.18;0.61	0.10; 0.26	-	-	-	-	0.5-2.5
Shpendë të therur	-	-	0.28	0.10	-	0.04; 0.05	-	-
Shpendë për veze	-	-	-	0.80	0.50 ([e])	-	-	-
Bletë (euro/koshere)	7	8	2	10	10	10; 26	-	4
Të tjera ([j])	-	-	-	-	-	28	-	-
Input								
Sigurimi (maks)	-	50 %	-	70 %	-	60 %	50 %	40 %
Karburanti	-	-	0.31 euro/l	-	-	-	-	2-5 euro/ha ([k])
Plehu	-	-	-	-	-	-	-	25 euro/ha ([k])
Të tjera ([j])	250	-	-	-	-	-	-	-

([a])Pagesë shtesë/premium për cilësinë e qumështit (sasia maksimale).
([b]) Pagesë shtesë për prodhuesit e mëdhenj.
([c])Të gjitha farërat nga prodhuesit e regjistruar në RSR; farërat e drithërave në IRJ të Maqedonisë.
([d])Bimët mjekësore në RSR dhe zogjtë për rritje në IRJ të Maqedonisë.
([e])Sasia maksimale për njësi; vlera e reduktuar e njësisë për sasitë (hektarë, krerë) mbi kufirin e vendosur.
([f])Drithërat, bimët vajore dhe patatet në FBH, gruri në Kosovë*, të gjitha në IRJ të Maqedonisë, drithërat dhe patatja në Malin e Zi.
([g])Bimët mjekësore në FBH; kërmijtë në IRJ të Maqedonisë.
([h]) Vetëm për prodhimin e qumështit.
([i])Vetëm për gjedhët meshkuj të rinj.
([j])Mbarështimi i strucit në IRJ të Maqedonisë (për krerë), mbrojtja e ullishtave në Shqipëri (për hektarë).
([k])Sasia maksimale për hektarë; subvencionet e vendosura në 0,41 euro/l për karburantin dhe 0,08 euro/kg për plehun.

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore.

Kritere të ndryshme të përzgjedhjes

Kriteret specifike të përzgjedhjes të lidhura me sasitë e prodhuara, hektarët nën kultivim dhe numrin e krerëve të blegtorisë ndryshojnë ndjeshëm sipas vendeve dhe skemës së mbështetjes (Tabela 1.14). Sipërfaqja minimale që nevojitet në skemat e pagesave individuale të lidhura me kulturat bimore varion midis 0,3 ha (të gjitha bimët e arave në IRJ të Maqedonisë) dhe 5 ha (farërat e grurit në Kosovë*); për bimët e arave, për perimet varion midis 0,2 ha (IRJ e Maqedonisë) dhe 0,5 ha (FBH, Kosovë*) ndërsa për për kulturat e përhershme varion midis 0,1 ha (vreshtat në Kosovë*) dhe 2 ha (drufrutorëtnë FBH)..

Tabela 1.14.. Kërkesat minimale për sa i përket sasive të shitura, hektarëve nën kultivim dhe numrit të krerëve në vendet e BP-së sipas skemave kryesore të pagesave direkte, 2015.

	AL	BA-FBH	BA-RSR	BA-QB	XK	MK	ME	RS
Sasia Minimale								
Qumështi i lopës ([a])	1 500 l/m	500 l/m	pavendosur	-	500 l/m	pavendosur	400 l/m	1 000 l/m
Fruta	pavendosur	-	0.5 t ([b])	-	-	pavendosur	-	-
Fidanë	-	pavendosur	pavendosur	-	5 000 copë	pavendosur	-	-
Sip. min. e përzgje.								
Të gjitha kulturat	-	-	-	-	-	-	-	pavendosur ([c])
Bimët e arave	-	-	-	-	-	0.3 ha	0.5 ha	-
Drithërat	-	-	-	-	-	0.3 ha	1 ha	-
Gruri	-	1 ha ([d])	1.5 ha ([d])	1.5 ha	2 ha	-	-	-
Misri	-	2 ha	-	1.5 ha	1 ha	-	-	-
Elbi	-	1 ha ([d])	-	1.5 ha	-	-	-	-
Farërat vajore	-	1 ha ([d])	-	1.5 ha	1 ha	0.3 ha	-	-
Farërat	-	Not set ([d])	-	-	5 ha	0.3 ha	0.5 ha	-
Foragjeret	-	-	-	1.5 ha	-	0.3 ha	0.5 ha	-
Duhani	-	0.5 ha	-	1.5; 0.5 ha	-	-	Not set	-
Perimet	-	0.5 ha ([d])	-	0.3 ha	0.5 ha	0.2 ha	-	-
Fruta (fruta të buta)	-	2 ha ([d])	-	pavendosur	0.5(0.2) ha	0.2 ha	-	-
Vreshta	-	1 ha ([d])	-	-	0.1 ha	0.2 ha	-	-
Numri minimal								
Gjedhët	-	-	-	-	-	pavendosur	-	-
Lopë	-	-	-	2 ([d])	5	-	4 ([e])	2
Mëshqerrat për mbarështim	-	2	-	2	-	30		-
Lopët e qumështit	-	15	5	pavendosur	-	-	-	2
Viçat	-	-	-	-	-	pavendosur	-	-
Gjedhët e therur	-	3	4	5	pavendosur	pavendosur	pavendosur	pavendosur
Delet (dhitë)	100 (100)	50(25)	10(5)	20(10)	30(20)	30(30)	40(30) ([e])	10(5)
Dosat për mbarështim	-	5	20	5	2	2	-	3
Derrat e therur	-	10	60	20	-	5	-	10
Shpendët e rritur me shtim natyror	-	10 000	2 000	-	-	-	-	-
Zogjtë e therur	-	-	5 000	5 000	-	1 000	-	-
Shpendë për veze	-	-	-	1 500	2 000	-	-	-
Kosheret	50	20 ([d])	50	30	30	35	-	10

([a]) Sasitë e nevojshme të qumështit të lopës dërguar në baxho në muaj; pagesa shtesë/premium për prodhuesit e mëdhenj në Malin e Zi garantohet për sasitë mbi 5 000 l/muaj.
([b]) Sasia e shitur e nevojshme për çdo varietet fruti.
([c]) Paguar deri në 20 ha.
([d]) Sipërfaqja minimale e plotësuar nga sasitë minimale të nevojshme shitur për njësi (gruri; 3,5 t/ha; elbi: 3,0 t/ha; rrepa: 2,5 t/ha; soja dhe lulet e diellit: 2,0 t/ha; domate; 15 t/ha; specat, kastraveci dhe qepa: 10 t/ha; patëllxhani; 2 t/ha; rrushi: 8 t/ha; fruta: 5 t/ha; ullinjtë: 2 t/ha; qumështi: 2 000 l/lopë; mjalti: 10 kg/koshere).
([e]) Paguar vetëm për numrin e krerëve mbi pragun e vendosur.
([c]) Paguar deri në 20 ha.

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore.

Për pagesat e lidhura me blegtorinë numri minimal i krerëve të nevojshëm ndryshon sipas llojit dhe kategorisë së blegtorisë; për gjedhët kjo varion midis minimumit një krerë (të gjitha skemat në IRJ të Maqedonisë me përjashtim të mëshqerrave) dhe 30 krerëve (mëshqerrat për prodhim mishi në IRJ të Maqedonisë). Për delet dhe dhitë, numri minimal është nga 10 dele ose 5 dhi (RSR, Serbi) në 100 në total (Shqipëri), për dosat e mbarështimit, nga 2 (Kosovë*, IRJ e Maqedonisë) në 20 (RSR), për derrat nga 5 (IRJ e

Maqedonisë) në 60 krerë (RSR), për shpendët nga 1 000 (zogjtë e pulës në IRJ të Maqedonisë) në 10 000 krerë (rritja e shpendëve me shtim natyror në FBH) dhe nga 10 (Serbi) në 50 koshere (Shqipëri, RSR),

Për çmimin e bulmetit zakonisht kërkohet një sasi minimale e qumështit të dërguar në baxho (e vendosur për muaj apo tremujor), varion midis 400 litrave (Mal i Zi) dhe 1 500 litrave në muaj (Shqipëri).

Në Malin e Zi pagesat për disa skema të lidhura me blegtorinë (pagesë shtesë/premium për qumështin, pagesa për lopët dhe mëshqerrat, pagesa për delet e dhitë) jepen vetëm për sasi mbi pragun ose kufirin minimal.

Në Bosnje e Hercegovinë (FBH dhe RSR), shumica e pagesave të lidhura me kulturat bimore, si dhe pagesat për lopët me orientim prodhim qumështi dhe për koshere blete, janë të kombinuara me kërkesat (relativisht të larta) të sasive minimale të produkteve që duhen shitur për njësi (për hektarë, për krerë apo për koshere; shikoni shënimin([d]) në Tabelën 1.14).

Në Shqipëri, Bosnje e Hercegovinë dhe Serbi, disa pagesa direkte jepen vetëm deri në një farë limiti, i cili vendoset për skemë në kushtet e vëllimit (sasi, hektarë apo numër krerësh blegtorie maksimale) apo në vlera absolute për përfitues (RSR).

Në Shqipëri pagesat jepen kur bëhet fjalë për sasi deri në 300 dele dhe dhi (rreth 2 600 euro/përfitues); deri në 300 koshere (rreth 2 200 euro/përfitues) dhe deri në 15 000 litra qumësht të dërguar në baxho në muaj (rreth 13 000 euro/përfitues).

Në Bosnje e Hercegovinë pagesa maksimale për përfitues në skemat e mbështetjes direkte individuale për kulturat bimore në vitin 2015 ishte midis 5 000 euro (farërat vajore dhe bimët mjekësore në RSR) dhe 115 000 euro (kulturat bimore të përhershme në FBH); ndërsa për blegtorinë ishte midis 2 500 euro (kosheret e bletëve në RSR) dhe 27 000 euro (pagesa për therjen e derrave në FBH).

Në Serbi, zakonisht nuk vendoset një prag maksimal për skemat e pagesave të lidhura me blegtorinë, ndërsa sipërfaqja e përzgjedhur për pagesën e kulturave bimore për hektarë (dhe subvencionet e sigurimit) ishte e kufizuar në një maksimum prej 20 ha në vitin 2015 (maksimumi 1 000 euro për përfitues) (për më shumë detaje shikoni: http://app.seerural.org/agricultural-statistics/).

Numri në rritje i skemave të pagesës përballë asnjë ndryshimi në politikë

Në të gjitha vendet e BP-së, që prej vitit 2010, ndryshimet që kanë ndodhur në numrat totalin dhe llojet e skemave të pagesave direkte, kështet e pagesës për njësi dhe kriteret e perzgjedhjes së përfituesve, kanë ndikuar nivelin e përgjithshëm të mbështetjes direkte. Megjithatë, karakteristikat kryesore të politikave të mbështetjes direkte nuk kanë ndryshuar shumë në vitet e fundit në shumicën e vendeve të BP-së.

Shqipëria

Shqipëria rregullisht implementon vetëm një numër shumë të kufizuar të skemave direkte të mbështetjes (për qumështin e lopës, delet dhe dhitë, kosheret e bletëve dhe ullinjtë), ndërkohë që shumë skema janë aplikuar vetëm në mënyrë sporadike (skema të zbatuara për vetëm 1 ose 2 vjet). Kështet e pagesave janë të krahasueshme me vendet e tjera të BP-së, por nivelet relative të mbështetjes direkte që aktualisht u paguhen prodhuesve janë ende të ulëta (më pak se 6 euro/ha të SBSH-së në vitin 2015), edhe pse buxheti total për masat e mbështetjes direkte është rritur ndjeshëm që prej vitit 2010 (Figura 1.16).

Në vitin 2015, pothuajse 80 % e mbështetjes direkte totale shkoi për sektorin e blegtorisë, kryesisht për delet dhe dhitë (64 % e totalit). Kriteret e përzgjedhjes për pagesat direkte për sektorin e blegtorisë janë vendosur në një gamë relativisht të ngushtë (100 deri në 300 dele dhe dhi; 100 deri në 300 koshere dhe 1 500 deri në 15 000 litra qumësht në muaj) dhe rrjedhimisht vetëm një numër i kufizuar krerësh apo sasi prodhimi aktualisht mbështetet nga pagesat direkte.

Figura 1.16.Pagesat direkte dhe subvencionet e inputit në Shqipëri sipas mallrave, 2010-2015



%	Mes 10-15	2015
Kuaj	0,0	
Gjedhë	1,9	
Bletërritës	5,9	7,8
Qumësht	14,6	6,9
Dele, dhi	60,1	64,4
Fruta	0,5	
Vaj ulliri	0,9	
Perime	3,1	
Fruta, perime	3,1	6,0
Ullinj	9,9	14,8
Kultura total	17,4	20,8

Burimi: baza e të dhënave të MPB-së

Bosnja e Hercegovina

Bosnja e Hercegovina karakterizohet nga një numër shumë i madh skemash të ndryshme pagese për të mira specifike si në sektorin e kulturave bimore ashtu edhe në atë të blegtorisë, të cilët nuk kanë ndryshuar shumë që prej viteve 2011-2012, kur shumica e pagesave të bazuara në prodhim për kulturat bimore u zëvendësua me pagesa për sipërfaqe në FBH. Megjithatë, në të gjithë vitet e analizuar, nën-sektori i bulmetit morri rreth gjysmën e totalit të mbështetjes direkte (57 % në vitin 2015), ndërkohë që pjesa tjetër u nda midis mallrave të tjera, ku secila mori një pjesë të vogël (kryesisht më pak se 5 %; Figura 1.17)

Figura 1.17. Pagesat direkte dhe subvencionet për input në Bosnje e Hercegovinë sipas mallrave, 2010-2015.



%	Mes 10-15	2015
Të gjitha produktet	6.5	4.9
Krerë blegtorie të tjera	2.1	0.8
Shpendët	2.2	2.2
Derrat	4.0	2.8
Dele, dhi	4.8	5.2
Gjedhë	10.2	8.9
Qumësht	48.2	56.9
Kultura bimore të tjera	8.2	7.0
Perime	2.9	1.8
Fruta	3.2	4.6
Të gjitha bimët e arave	3.6	
Grurë	4.0	4.9
Totali i kulturave bimore	21.9	18.4

Burimi: baza e të dhënave të MPB-së

Në vitin 2015, të gjitha pagesat e lidhura me kulturat bimore përbënin më pak se 20 % të buxhetit total të shpenzuar në mbështetjen direkte. Mbështetja direkte totale e ekzekutuar ndryshon nga viti në vit, me një tendencë në rritje që prej vitit 2010 e cila është kryesisht rezultat i kësteve të pagesës në rritje në sektorin e bulmetit. Kështet e pagesës gjithashtu janë relativisht të larta në shumicën e skemave të tjera të pagesës

krahasuar me ato të vendeve të tjera të BP-së. Megjithatë, niveli relativ i mbështetjes direkte i matur për hektarë të SBSH-së që aktualisht paguhet është e treta më e ulëta ndër vendet e BP-së.

Llojet e pagesave direkte (në RSR bëhet ende një numër i konsiderueshëm i pagesave të bazuara në prodhim) dhe kriteret e përzgjedhjes (shumica e skemave të bazuara në sipërfaqe dhe krerë kërkojnë shitjen e produkteve në treg) tregojnë që politikat e mbështetjes direkte në Bosnje e Hercegovinë në mënyrë dominuese është drejtuar tek prodhuesit e orientuar drejt tregut, të cilët nuk përfaqësohen gjerësisht në prodhimin total, veçanërisht në sektorin e kulturave bimore.

Kosova*

Mbështetja direkte ndaj prodhuesit është rritur kryesisht në Kosovë*, e cila vetëm së fundmi ka filluar të zbatojë një politikë të tillë në një shkallë të gjerë. Në vitin 2010, vetëm katër skema të mbështetjes direkte ishin aktive (për vreshtat, lopëtme orientim prodhim qumështi, delet dhe dhitë për bulmet dhe karburantin) dhe, me futjen graduale të skemave të reja për të mira specifike si për sektorin e kulturave bimore ashtu edhe për atë të blegtorisë, ky numër u rrit në 15 në vitin 2015.

Disa pagesa për njësi gjithashtu janë rritur (për drithërat në vitet 2013 dhe 2015 dhe për lopët me orientim prodhim qumështi dhe për të imtat në vitet 2012 dhe 2015) të cilat kanë rezultuar në një rritje të vazhdueshme të fondeve të përgjithshme për këto masa, duke arritur një nivel relativ (për SBSH) të krahasueshëm me atë të IRJ të Maqedonisë në vitin 2015 (më e larta ndërmjet vendeve të BP-së; Figura 1.18).

Figura 1.18. Pagesat direkte dhe subvencionet e inputit në Kosovë* sipas mallrave, 2010-2015.



%	Mes 10-15	2015
Kafshë të tjera	0,0	0,1
Vezët	1,3	1,6
Bletërritës	4,8	6,6
Dele, dhi	12,6	12,9
Qumësht	20,7	22,6
Kultura të tjera	0,7	0,7
Fruta	0,9	2,3
Perime	5,1	9,7
Misri	8,3	11,7
Rrushi	8,9	6,6
Grurë	36,8	25,2
Kultura total	60,7	56,2

Burimi: baza e të dhënave të MPB-së

Në vitin 2015 pagesat direkte ishin të shpërndara në mënyrë të barabartë midis sektorëve të kulturave bimore dhe blegtorisë (56 % në 44%), me drithërat (gruri dhe misri) dhe nën-sektorin e bulmetit (qumështi, lopët me orientim prodhim qumështi, dhe i deleve e dhive) që kanë pjesët më të mëdha në mbështetjen direkte totale (37 % dhe 36 % respektivisht). Duke marrë parasysh kriteret e përzgjedhjes, pagesat direkte në Kosovë* synojnë kryesisht rritjen e prodhimit bujqësor në fermat e mëdha (kryesisht ka kërkesa minimale të larta, por jo kufi tavan për pagesat).

IRJ e Maqedonisë

Në IRJ të Maqedonisë karakteristikat kryesore të politikave mbi pagesat direkte kanë mbetur kryesisht të pandryshuara që prej vitit 2010. Mbështetja direkte u jepet të gjithë nën-sektorëve nëpërmjet disa pagesave të grup-mallrave e ndërthurur me një numër në rritje të pagesave shtesë për mallra specifikë, veçanërisht në sektorin e kulturave

bimore. Pagesat kryesisht synojnë të gjithë prodhuesit (kërkesa minimale të ulëta dhe nuk ka prag/kufi maksimal absolut). Pavarësisht mungesës së ndryshimeve të rëndësishme në politika, mbështetja direkte totale e disbursuar është luhatur ndjeshëm ndër vite (Figura 1.19). Arsyeja kryesore për këtë është hapësira kohore e pabarabartë midis pagesave të miratuara dhe ekzekutimit të tyre në skema individuale, e cila mund të shkojë deri në disa vite.

Në përgjithësi në vitin 2015 vetëm angazhimet në disa skema të lidhura me kulturat bimore dhe disa pagesa për sektorin e bulmetit u ekzekutuan, duke rezultuar në një rënie të mprehtë në nivelin e mbështetjes direkte totale krahasuar me vitin 2014 dhe vitet e mëparshëm. Në të gjitha vitet, me përjashtim të vitit 2015, niveli relativ i mbështetjes direkte që aktualisht ju pagua prodhuesve (euro/ha të SBSH-së) ishte më i larti ndër vendet e BP-së.

Në periudhën 2010-2015, një mesatare prej rreth dy të tretave të mbështetjes direkte totale i shkoi sektorit të kulturave bimore, kryesisht duhanit (rreth 30%) dhe vreshtave e bimëve të arave (rreth 13 % secila). Midis nën-sektorëve të lidhur me blegtorinë, pjesa më e madhe e fondeve të ekzekutuara për mbështetjen direkte i shkoi deleve dhe dhive (rreth 12 %), ndjekur nga pagesat për qumështin e gjedhët (rreth 8 % secili).

Figura 1.19. Pagesat direkte dhe subvencionet e inputit në IRJ të Maqedonisë sipas mallrave, 2010 – 2015.



%	Mes 10-15	2015
Të gjitha produktet	0.3	
Krerë blegtorie të tjera	0.5	
Bletërritës	1.7	
Derrat	2.2	
Gjedhë	7.6	
Qumësht	7.7	3.2
Dele, dhi	12.4	
Kultura bimore të tjera	3.8	2.1
Fruta	2.3	0.1
Perime	4.0	
Të gjitha bimët e arave	12.7	11.9
Rrushi	13.0	18.3
Duhani	31.8	64.5
Totali i kulturave bimore	67.7	96.8

Burimi: baza e të dhënave të MPB-së

Mali i Zi

Në Malin e Zi, numri i total i skemave për sektorët e kulturave bimore dhe blegtorisë është diku më i vogël sesa në shumicën e vendeve të BP-së, edhe pse është rritur lehtësisht që prej vitit 2010 si një rezultat i shumëllojshmërisë së skemës bazë për bimët e arave sipas mallrave (sasi të ndryshme për bimët foragjere dhe farërat e patates) dhe futjen e disa shtesave ndaj mbështetjes në cmime për produktet bulmetore. Disa këste pagesash gjithashtu janë rritur (për kulturat bimore në vitin 2012 dhe për qumështin në vitin 2014); megjithatë, nuk ndikojnë ndjeshëm nivelin total dhe përbërjen e mbështetjes sipas sektorit (Figura 1.20)

Mbështetja direkte kryesisht fokusohet drejt nën-sektorit të bulmetit, duke përbërë 56 % të fondeve totale të planifikuara për këto masa në vitin 2015. Së bashku me mbështetjen për gjedhët dhe bagëtitë e imëta (12 % secila), pagesat direkte të lidhura me blegtorinë përfaqësojnë shumicën e gjerë të mbështetjes direkte totale (80 % në vitin 2015).

Vetëm rreth 16 % e fondeve totale është ruajtur për mbështetje direkte për bimët e arave dhe duhanin, ndërsa pjesa tjetër (4 %) përbëhet nga subvencionet e inputit për sigurimin e kulturave bimore dhe shtazore (të gjitha produktet).

Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve për pagesa direkte kryesisht janë në favor të prodhuesve të mëdhenj (kërkesa minimale relativisht të larta dhe pa kufij të sipërm), të cilët nuk janë të përfaqësuar mjaftueshëm në strukturën e fermës së Malit të Zi. Kjo ndoshta është një nga arsyet se përse, pavarësisht faktit që këstet e pagesave direkte në Malin e Zi janë të krahasueshme me ato në vendet e tjera të BP-së, nivelet relative të përgjithshme të mbështetjes direkte (për SBSH) janë të dytat më të ulëta midis të gjitha vendeve të BP-së (Figura 1.10).

Figura 1.20. Pagesa direkte dhe subvencionet e inputit në Malin e Zi sipas mallrave, 2010 – 2015.



%	Mes 10-15	2015
Të gjitha produktet	5.3	4.1
Gjedhë	8.9	12.0
Dele, dhi	17.4	12.4
Qumësht	53.7	55.6
Duhani	1.4	1.0
Patate	2.1	2.0
Të gjitha bimët e arave	11.3	12.8
Totali i kulturave bimore	14.7	15.9

Burimi: baza e të dhënave të MPB-së

Serbia

Ndryshime të konsiderueshme në mbështetjen direkte janë regjistruar në Serbi, ku numri i skemave të pagesave, kësteve të pagesave dhe kritereve specifike të përzgjedhjes për pagesat ka ndryshuar shpesh që prej vitit 2010. Në vitin 2010 dhe 2011 shumica dërrmuese e mbështetjes direkte u dha në formën e subvencioneve të inputit për prodhimin e kulturave bimore (farërat, karburanti dhe plehu). Sektori i blegtorisë u mbështet vetëm nga një shtesë në çmimin (premium) e produkteve të bulmetit dhe disa pagesa për krerë për krerë mbarështimi të një cilësie të lartë.

Në vitin 2012 u prezantua pagesa njeherëshe për siperfaqe (a single area payment) për kulturat bimore, dhe numri i subvencioneve për inputin; ku këstet e pagesave të tyre ranë në vitet në vijim (për karburantin me pothuajse 40 % dhe për plehun me rreth 60 % midis viteve 2010 dhe 2015). Në vitet 2012 dhe 2013 u prezantuan skemat e reja të pagesave për sektorin e blegtorisë (pagesat për krerët e therura, pagesa për rritjen e shpendëve me shtim natyror dhe për kosheret e bletëve), duke rezultuar në një rritje të konsiderueshme në mbështetjen direkte totale të lidhur me sektorin e blegtorisë në vitet në vijim (Figura 1.21).

Figura 1.21. Pagesat direkte dhe subvencionet e inputit në Serbi sipas grup-mallrave, 2010-2015



%	Mes 10-15	2015
Të gjitha produktet	1,5	1,0
Kafshë të tjera	0,5	1,3
Dele, dhi	1,0	4,2
Derrat	2,4	8,3
Të gjithë kafshët	4,4	
Gjedhë	9,2	22,4
Qumësht	14,7	21,5
Të gjitha kulturat	25,6	13,1
Input për kultura	40,6	28,2
Kultura total	66,2	41,3

Burimi: baza e të dhënave të MPB-së

Në vitin 2015 kriteret për pagesat direkte për kulturat bimore ndryshuan, duke e bërë maksimumin e sipërfaqes së përzgjedhur për përfitues në 20 ha (nga 100 ha në periudhën 2013 – 2014). Rrjedhimisht, mbështetja totale për sektorin e kulturave bimore më shumë se u përgjysmua krahasuar me mesataren e periudhës 2010-2014. Në vitin 2015, mbështetja direkte për sektorin e kulturave bimore përbënte 41 % të mbështetjes direkte totale, nga 64 % në vitin 2014 dhe 92 % në vitin 2010. Midis nën-sektorëve të blegtorisë, gjedhi dhe bulmeti morën pjesën më të madhe të mbështetjes direkte totale (rreth 22 % secili), ndjekur nga nën-sektori i rritjes së derrit (8 %).

Ndryshimet e fundit në kriteret e përzgjedhjes në sektorin e kulturave bimore mund të tregojnë një ri-orientim të politikave lidhur me mbështetjen direkte (rishpërndarjen e fondeve) në Serbi drejt sektorit të blegtorisë dhe prodhuesve më të vegjël. Kështet e pagesave në sektorin e kulturave bimore përgjithësisht janë më të ulëtat midis vendeve të BP-së, ndërsa niveli relativ i mbështetjes direkte për prodhuesit (euro/ha e SBSH-së) është mbi mesataren e vendeve të BP-së, gjë e cila tregon që subvencionet ndoshta mbulojnë një pjesë më të madhe të prodhimit sesa në vendet e tjera, por me pagesa më të ulëta për përfitues.

Vëzhgime përfundimtare mbi masat e mbështetjes direkte në Ballkanin Perëndimor

Programet vjetore dhe rregulloret që qeverisin zbatimin e masave të mbështetjes direkte tregojnë që politikat aktuale po vazhdojnë në vitin 2016. Disa ndryshime konceptuale në perputhje me dokumentet e programimit afatgjatë mund të vëzhgohen vetëm në Malin e Zi, ku kulturat bimore të përhershme përfshihen në skemat e pagesave direkte për kulturat bimore, dhe në Bosnje e Hercegovinë (FBH), ku u fut një pagesë për krerë për lopët me orientim prodhim qumështi dhe u reduktua kësti i pagesës për qumështin (për litër).

Numri i skemave të pagesave të zbatuara gjithashtu u rrit në Kosovë* (pagesa të reja për sipërfaqe për elbin dhe tërshërën dhe pagesa të reja për-krerë për shkurtëzat), Shqipëri (pagesa të reja për-krerë për lopët) dhe IRJ të Maqedonisë (pagesa të reja shtesë për sipërfaqe për farërat vajore, shtesa të reja për pagesat për sipërfaqe për perimet, drufrutorët dhe vreshtat dhe pagesa të reja për-krerë për rritjen e shpendëve me shtim natyror), por këto nuk ndikojnë ndjeshëm orientimin e politikave të pagesës direkte.

1.7 Konkluzionet dhe rekomandimet mbi politikat

Analizat e gjera sasiore dhe cilësore të fakteve dhe të dhënave që i përkasin vendeve të BP-së na kanë mundësuar formimin e disa përfundimeve dhe rekomandimeve për sa i përket zhvillimit të bujqësisë dhe politikave bujqësore. Kjo është bërë në nivel rajonal, duke u bazuar në këtë kapitull dhe në raportet individuale të vendeve, të cilët paraqiten në kapitujt në vijim.

1.7.1 Fokusi rajonal

Eksportet po rriten, po ka ende potenciale të pashfrytëzuara

Në vitet e kaluara rajoni dëshmoi përsëri rritje ekonomike, e cila gjithsesi ende nuk është shoqëruar nga ndryshime të dukshme strukturore. Bujqësia mbetet një sektor i rëndësishëm ekonomik dhe me një rol te rëndësishëm shoqëror në këtë rajon. Prodhimi bujqësor karakterizohet nga një paqëndrueshmëri e lartë në prodhimin e kulturave bimore, edhe pse tendencat janë kryesisht pozitive, veçanërisht në disa nën-sektorë (perime, patate dhe fruta). Sektori i blegtorisë përgjithësisht është më i qëndrueshëm, por ndjek modele të ndryshme, nga tendenca negative në IRJ të Maqedonisë dhe Kosovë*, në asnjë ndryshim në Bosnje e Hercegovinë dhe tendenca pozitive në vendet e tjera të BP-së. Pavarësisht rritjes së pronave individuale (individë dhe korporata), përgjithësisht mund të themi që burimet rajonale të prodhimit bujqësor janë të pashfrytëzuara, sepse prodhimet janë relativisht të ulëta dhe fermat janë të vogla e të shpërndara.

Tregtia e produkteve agro-ushqimore përfaqëson një pjesë të rëndësishme të tregtisë së jashtme të vendeve. Eksportet në përgjithësi po rriten, por bilancet tregtare të vendeve individuale janë shumë të ndryshueshëm. Vetëm Serbia është një eksportuese e përgjithshme dhe po bëhet një lojtar i rëndësishëm tregtar për drithërat, farërat vajore dhe manaferrat. Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova* dhe Mali i i Zi kanë nivele modeste eksportesh dhe deficite të larta të tregtisë së produkteve agro-ushqimore, ndërsa IRJ e Maqedonisë ka një bilanc më të favorshëm tregtar, edhe pse është negativ. Partnerët tregtarë po ndryshojnë ngadalë në një mënyrë interesante. Eksportet drejt vendeve brenda rajonit dhe drejt BE-së janë ende mbizotëruese, por eksportet drejt vendeve të treta po rriten; kjo ka gjasa të jetë pasojë e ndalesës në produktet perëndimore e vendosur nga Rusia, e cila ka hapur mundësi të reja eksporti për disa vende.

Pavarësisht disa ndryshimeve pozitive në prodhim dhe tregti, ende ka potencial të madh në përdorimin e burimeve natyrore dhe njerëzore dhe mundësitë e lidhura me to për të zhvilluar bujqësinë dhe mjedisin rural. Megjithatë, kjo do të kërkonte rishikim radikal të strukturës, cilësisë dhe shtrirjes së politikave bujqësore.

Hendeqet midis strategjive të politikave dhe zbatimit të tyre

Të gjitha vendet e diskutuara këtu kanë adoptuar dokumente programimi të politikave bujqësore afatmesme dhe, si edhe përshkruar në (Volk et al. 2016), këto dokumente janë të shkruara në mënyrë solide dhe kanë logjikë strategjike të fortë. Ato përshkruajnë ndryshimet pozitive në kuadrin e politikave dhe një orientim më të gjerë drejt BE-së, të cilat pasqyrohen në përkufizimin e qëllimeve dhe masave të politikave specifike, veçanërisht për sa i përket zhvillimit rural. Megjithatë, shumicës së vendeve u mungon një qëllim i qartë për të reformuar politikat e tyre lidhur me mbështetjen direkte në përputhje me PPB-në e BE-së dhe kjo gjithashtu është e vlefshme edhe për masat bujqësore-mjedisore, për mbështetjen e ZVN-ve dhe masat LEADER. Gjithashtu ka një mungesë të angazhimit për të krijuar politika të bazuara në evidenca në kuptimin e prezantimit të monitorimit të detyrueshëm dhe elementeve të tjerë për të arritur një reformë politikash efektive.

Dokumentet e programimit (të cilat janë moderne dhe të mirë-konceptuara që janë hartuar, ende nuk kanë çuar në ndryshime të ndjeshme në shtrirjen dhe ne strukturën e

instrumenteve dhe masave të politikave, veçanërisht në adaptimin e tyre me sistemet e mbështetjes sipas PPB-së. Shuma e buxheteve të politikave bujqësore luhatet ndjeshëm nga viti në vit dhe është rritur që prej vitit 2010 vetëm në Kosovë* dhe Shqipëri – dy vendet që filluan me shumat relative më të ulëta të mbështetjes bujqësore. Kosova* gjithashtu përfiton nga fonde të konsiderueshme donatorësh, duke ndihmuar në këtë mënyrë arritjen e buxheteve më të mëdha relative në vitin 2015([5]). Disa vende, nga ana tjetër, kanë reduktuar buxhetet e tyre bujqësore si rezultat i krizës ekonomike (p.sh. Bosnja e Hercegovina që prej vitit 2010 dhe Serbia në 2015).

Struktura e mbështetjes totale për bujqësinë ndryshon ndjeshëm. Përpjesat e fondeve për grupe të ndryshme të masave në buxhetin e përgjithshëm të bujqësisë nuk mund të krahasohen pa marrë parasysh shumën e vetë buxhetit total. Përmasa e mbështetjes direkte për prodhuesin është e lartë në Bosnje e Hercegovinë, IRJ të Maqedonisë dhe Serbi (mbi 70 % mesatarisht). Fondet për masat e zhvillimit strukturor dhe rural janë kryesisht të fokusuara për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe kanë përmasat më të mëdha në Shqipëri, Kosovë* dhe Malin e Zi; megjithatë, këto fonde janë të kufizuara dhe ndikimi i tyre real në zhvillimin e bujqësisë nuk duhet mbivlerësuar. Mbështetja për të mirat publike bujqësore (masat agro-mjedisore dhe mbështetja për ZVN-të) dhe cilësia e jetës në zonat rurale është pothuajse e neglizhuar në të gjitha vendet e BP-së.

Politikat e zhvillimit rural nuk po zënë vend në rajon, pavarësisht adoptimit rastësor të projekteve apo programeve përfituese. Ky është një problem jo vetëm i niveleve modeste të financimit, por gjithashtu i masave të programimit: themi se kanë një orientim të ngushtë drejt investimit në ferma. Absorbimi i ulët i fondeve të mbështetjes së para-anëtarësimit IPARD, është një problem i rëndësishëm, sic tregohet dhe në analizat tona të mëparshme (Volk et al. 2016). Shkaqet janë të ndryshme, dhe variojnë nga mungesa në kapacitetet njerëzore në administrim dhe në prioritetet e politikave në nivel vendi, deri në mungesën e adaptimit të mbështetjes me kushtet reale.

Në mënyrë të ngjashme, nivelet e fondeve për shërbimet e përgjithshme janë të ulëta në terma absolutë dhe janë shumë poshtë përmbushjes së nevojave të vendit për zhvillim, veçanërisht në kuptimin e arritjes së krijimit efikas dhe transferimit të njohurive.

Në shumicën e vendeve të BP-së fondet për mbështetjen direkte për prodhuesin po rriten në madhësi dhe shumica e rritjeve në buxhetet bujqësore janë rrjedhimisht të drejtuara në këtë grup masash. E shprehur për hektarë të SBSH-së, këto fonde janë shumë poshtë vlerave të këtij tipi pagesash në BE. Kjo përfshin vende që kanë filluar zyrtarisht negociatat e pranimit në fushën e bujqësisë (p.sh. Mali i Zi) ose janë gati duke filluar (p.sh. Serbia). Struktura e mbështetjes direkte nuk ndryshon ndjeshëm me kalimin e kohës. Mbështetja bashkohet me prodhimin dhe jepen kryesisht si pagesa për sipërfaqe dhe për sipërfaqe ose krerë, por gjithashtu mund të paguhet në formën e shtesave ndaj çmimit dhe subvencioneve të inputit.

Një orientim i diskutueshëm për mbeshtetjen direkte ndaj prodhuesit

Fokusi kryesor i analizës sonë ka qenë një ekzaminim i detajuar i llojeve dhe sasive të mbështetjes dhe kushteve të përzgjedhjes për masat e mbështetjes direkte për prodhuesin. Vendet e BP-së përdorin shumë forma të ndryshme të mbështetjes direkte dhe ato ndryshojnë shumë nga vendi në vend, në numra, lloje dhe shuma të mbështetjes, si dhe në produktet e përzgjedhura dhe kriteret e tjera të përzgjedhjes. Numri i skemave të pagesës po rritet në shumicën e vendeve të diskutuar këtu, ndërsa ndryshimet drejt skemave të ngjashme me BE-në janë të rralla, duke reflektuar një ndikim të qartë të politikave të bazuara në interes dhe pragmatizmit të vendimmarrësve në kuadrin politiko-ekonomik të politikave bujqësore.

Në vendet e BP-së ekzistojnë pothuajse të gjitha format e mbështetjes së lidhur me prodhimin (coupled). Pagesat e bazuara në prodhim (shtesë ndaj çmimit) mbizotërojnë

([5]) Krahasimet relative, shprehur për hektarë të SBSH-së, janë shumë të përafërta, sepse ndikohen fuqishëm nga të dhënat për përdorimin e tokës bujqësore, të cilat nuk janë të besueshme për të gjitha vendet e BP-së.

në Bosnje e Hercegovinë dhe përfaqësojnë pjesë të mëdha të mbështetjes direkte totale; i njëjtë është rasti edhe në IRJ të Maqedonisë dhe Malin e Zi. Në të gjitha vendet e BP-së, pagesat mbi prodhimin jepen për prodhimet bulmetore të orientuara nga tregu . Këto pagesa rezultojnë, në një shkallë të gjerë, në çmime më të ulëta inputi për përpunuesit e bulmetit, të cilët, si rezultat, duken konkurues. Në të kaluarën rajoni karakterizohej nga subvencione inputi njësoj shtrembëruese (Volk 2010), të cilat mund të shkaktojnë rrjedhje të fondeve publike drejt industrive të sipërme (up-stream industries). Megjithatë, këto lloje pagesash janë në rënie: për shembull, Serbia po fut pagesat për sipërfaqe në vend të subvencioneve për input për karburantin apo plehun.

Rrjedhimisht, shtesat ndaj çmimit mbeten elementët më shtrembërues në politikat bujqësore të BP-së. Konsiderata serioze për sa i përket transformimit të tyre në forma të tjera të mbështetjes janë te dëshirueshme, për shembull në forma që do të çojnë në shtrembërime më të pakta të tregut dhe do të lehtësojnë përshtatjen e tyre në sisteme mbështetjeje të ngjashme me PPB-në. Kjo është veçanërisht e vërtetë për pagesat për sipërfaqe dhe për krerë, të cilat janë format e mbështetjes që përdoren më shpesh në shumicën e vendeve. Megjithatë, ka një kleçkë të bashkangjitur me përdorimin e këtyre formave të mbështetjes. Shumica e vendeve të BP-së u japin pagesa sektorëve që nuk janë përfitues të kësaj lloj mbështetjeje në BE, p.sh. derrat dhe shpendët. Përfundimisht, procesi i anëtarësimit do të çojë në heqjen e kësaj mbështetjeje, e cila ka gjasa të rezultojë në ndikime të ashpra për këta sektorë kur të përballen me konkurencën e sektorëve të tjerë që nuk kanë marrë mbështetje në të kaluarën.

Është e vështirë të krahasohen skemat e mbështetjes direkte për prodhuesin për shkak të ndryshimeve të përkufizimeve dhe kritereve të përzgjedhjes. Vlerësimi ynë është që pagesat janë relativisht të larta, veçanërisht duke pasur parasysh shtesat ndaj çmimit për produktet e bulmetit, e cila mund të përbëjë një pjesë të konsiderueshme të çmimit të prodhuesit (p.sh. në Bosnje e Hercegovinë dhe Malin e Zi).

Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve meritojnë vëmendje të veçantë. Qasje shumë të ndryshme mund të gjenden në këtë fushë dhe disa prej tyre diskriminojnë prodhuesit e vegjël të cilët nuk janë të orientuar drejt tregut. Për shkak të qasjeve të ndryshme, është e vështirë të jepet një vlerësim uniform, por ka një tendencë të qartë në favor të prodhuesve tregtarë më të mëdhenj dhe një disfavor drejt fermave të vogla të subsitencës nga përfitimi i mbështetjes në shumicën e vendeve të BP-së. Arsyet për këtë ndryshojnë, duke nisur nga një vizion politik aktual (i cili gjithashtu mund të drejtohet nga interesa vetjake), në mungesën e fondeve dhe problemeve të zbatimit. Kjo gjithashtu është një largim nga praktikat e BE-së dhe ka gjasa të rezultojë në vështirësi kur njehsimi i politikave të PPB-së të intensifikohet. Mos-diskriminimi midis prodhuesve është një nga parimet e politikave të bujqësisë moderne dhe është diçka që duhet të merret në konsideratë më seriozisht në rajon.

Shumica e vendeve të BP-së kanë tentuar të fusin elementë të ndryshëm të zbatimit të pagesave direkte që janë karakteristike për BE-në. Ka pasur përmirësime në regjistrat e fermave dhe identifikimin e krerëve, por më pak në sistemet e identifikimit të përdorimit të tokës, e cila përfaqëson një pengesë serioze në zbatimin e masave të politikave të ngjashme me PPB-në. Me përjashtim të IRJ së Maqedonisë, asnjë vend nuk ka vënë ende në jetë kërkesa të ndër-pajtueshmërisë me PPB-në.

1.7.2 Komente përfundimtare dhe detyrat për të ardhmen

Gjetjet e këtij raporti lejojnë që të bëhen një sërë rekomandimesh për politika. Duke qenë se nuk ndryshojnë ndjeshëm nga ato të publikimeve të mëparshme (Volk et al. 2014, 2016) nuk do t'i përsërisim këtu. Do të theksojmë vetëm disa çështje që dalin direkt nga vlerësimi aktual i politikave bujqësore.

Zbatimi i dokumenteve të politikave tashmë të adoptuara. Dokumentet strategjikë janë themeli për politika bujqësore racionale. Mos zbatimi i tyre pasqyron rëndësinë e pragmatizmit afatshkurtër dhe një mbeshtetje të koordinuar mes palëve (*ad-hoc)* të politikave. Politika të tilla ndihmojnë shumë pak në zgjidhjen e problemeve kryesore të

bujqësisë së rajonit, që janë: potencialet dhe burimet e prodhimit të pashfrytëzuara, rënia e ekonomisë së zonave rurale dhe shpopullimi/eksodi rural (largimi i popullsisë). Bujqësia kërkon investime dhe, mbi të gjitha, politika duhet të nxisë shpërndarjen efikase të burimeve.

Forcimi i logjikës zhvilluese të politikave bujqësore. Kjo do të thotë që nevojitet theks më i fortë mbi zhvillimin dhe rritjen e ekonomisë rurale, duke kërkuar, nga ana tjetër, politika bujqësore më aktive. Ne parashikojmë që kjo të përfshijë zgjedhjen e instrumenteve të duhura për të adresuar prapambetjet në zhvillim, prodhimin e përmirësuar, përdorimin e përmirësuar të burimeve natyrore dhe integrimin e përmirësuar vertikal dhe horizontal të sektorit bujqësor. Logjika e zhvillimit duhet të zëvendësohet me logjikën e rishpërndarjes, e cila duket qartë që nuk po jep rezultate të kënaqshme.

Integrimi evropian është një mundësi për të modernizuar dhe zhvilluar bujqësinë dhe zonat rurale. Adoptimi i prioriteteve dhe objektivave të politikave bujqësore të BE-së është një mundësi për rajonin në kuptimin e përmbushjes së prioriteteve të zhvillimit, krijimin e një shteti modern, marrjen e fondeve shtesë dhe gjetjen e roleve të reja për bujqësinë dhe zonat rurale. Rrjedhimisht, periudha e para-anëtarësimit duhet të jetë një kohë gjatë së cilës ndiqen praktikat e mira dhe përshtaten veprimet me ekonominë lokale dhe realitetin social. Kjo gjithashtu do të thotë që sistemet e ndihmës së para-anëtarësimit në BE duhet të përshtaten, deri në një farë mase, me potencialet dhe kërkesat rajonale reale, dhe investimi në kapitalin njerëzor duhet të rritet ndjeshëm.

Modeli i zinxhirit ushqimor duhet të përmirësohet. Evidenca tregon që zhvillimi i një sektori të fortë bujqësor kërkon krijimin e zinxhirëve të fortë agro-ushqimorë. Kjo do të thotë që organizatat e prodhuesve duhet të mbështeten dhe të lidhen me përpunimin dhe tregtinë, mundësisht duke formuar zinxhirë furnizimi të shkurtër dhe të mesëm. Përpunimi efikas i ushqimit dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit janë po aq të rëndësishëm sa prodhimi primar efikas; megjithatë, masat e politikave në rajon (dhe në disa pjesë të BE-së) janë përshtatur keq me këtë logjikë të zinxhirit të furnizimit.

Mos harroni zonat marxhinale dhe zonat rurale në përgjithësi. Ka shumë zona të BP-së që po pësojnë shpopullim/ një largim të popullsisë dhe braktisje të prodhimit. Çfarë mbeten janë fermat e vogla me popullsi të moshuar dhe prodhim i gjerë që ekzistojnë në një mjedis të dobësuar socio-ekonomik. Varfëria e zonave rurale është një problem i rëndë në të gjitha vendet e BP-së, sepse sistemet e fermave po zhvillohen vetëm në zonat më të favorshme dhe në afërsi të zonave urbane. Politikat bujqësore po dështojnë të adresojnë këto çështje si një rezultat i pazotësisë dhe mungesës së vullnetit të politikë-bërësve. Hapi i parë është krijimi i qasjeve pozitive drejt zonave rurale dhe kjo duhet të ndiqet nga zbatimi aktiv i politikave dhe mbështetjeve për iniciativat e reja lokale dhe projektet e zhvillimit.

Mjedisi dhe burimet natyrore duhet të bëhen një fokus i politikave. Vendet e BP-së janë një thesar i vërtetë i biodiversitetit, burimeve natyrore, peisazheve kulturore dhe ujit të bollshëm. Politikat bujqësore në përdorim ende nuk kanë njohur nevojën e gjetjes së lidhjeve dhe sinergjive midis bujqësisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Kjo përfaqëson një potencial të pashfrytëzuar në rajon dhe është adresuar vetëm nga disa masa marxhinale të politikave.

Puna me fermerët dhe me grupet e tjera të interesit të zonave rurale. Ka një deficit demokratik të theksuar në rajon që kontribuon në efikasitetin në rënie të politikave. Fermerëve ruralë u mungon organizimi apo bashkëpunimi, duke pasur në këtë mënyrë një përfaqësim të ulët të interesave të tyre. Duhet të zhvillohet një qasje partneriteti, të shkëmbehen eksperienca dhe informacione, të merren reagime dhe të ndërtohen platforma për krijimin e vizioneve, strategjive dhe projekteve lokale.

Të gjitha fushat kërkojnë investime në institucionet bujqësore dhe në administratën bujqësore. Një nga mësimet kryesore të shqyrtimeve dhe analizave tona për sa i përket situatës në bujqësi, është që çelësi drejt zhvillimit bujqësor dhe rural

nuk ndodhet vetëm në fondet publike, iniciativat private dhe strategjitë të mira, por gjithashtu ndodhet fuqishëm tek njerëzit dhe institucionet që formojnë sistemin e politikave bujqësore. Institucionet bujqësore në rajon nuk janë në një gjendje të mirë. Ka një mungesë të fondeve dhe personelit të aftë dhe shpesh nuk ka një koncept apo kuptim se çfarë do të thotë të jesh një institucion që funksionon në mënyrën e përshtatshme. Vetëm arsimimi më i mirë, studimi i përshtatshëm dhe shkëmbimi efikas i njohurive mund të çojnë në zhvillim dhe këto janë fushat që kërkojnë investim. Vëmendje e veçantë duhet t'i jepet profesionalizmit të administratës bujqësore. Luhatjet në numrin e punëtorëve, mungesa e motivimit dhe udhëheqja e keqe çojnë në ministri që funksionojnë në mënyrë jo optimale, dhe rrjedhimisht produkte politikash bujqësore jo optimale.

Qasja e politikave bujqësore të bazuara në evidenca duhet të forcohet. Politikat bujqësore kryesisht koordinohen mes palëve në komisione të ngritura enkas (*ad hoc)* dhe shpesh drejtohen më tepër nga interesa vetjake sesa nga konsiderata serioze, monitorim, vlerësim dhe adaptime të bazuara në evidenca. Njohuria, institucionet dhe rregullat duhet të ndërtohen për të arritur këto synime. Modernizimi i qasjeve të programimit dhe monitorimit të politikave bujqësore është i nevojshëm, por jo kushti i vetëm për politika moderne, efikase dhe efektive. Vendet e BP-së duhet ta kuptojnë këtë dhe të zhvillojnë një plan veprimi që të zbatojë këtë koncept.

Ka nevojë që të mirë-mbahet dhe përmirësohet puna analitike për politikat bujqësore rajonale. Eksperienca tregon që platforma rajonale e ekonomistëve bujqësorë të cilët merren me politikat bujqësore dhe punojnë për ministritë kombëtare ka pika të forta të ndryshme. Ajo jep një platformë për programimin e politikave kombëtare, një bazë për modernizimin e politikave, mbështetje për negociatat me BE-në dhe promovon integrimin e rajonit në komunitetin ndërkombëtar. Deri më tani, ky projekt është bazuar në projekte specifike që varen në masë të gjerë nga puna vullnetare dhe entuziazmi i shkencëtarëve dhe ekspertëve të politikave që janë përfshirë. Profesionalizimi i punës në SWG (pjesë e sekretariatit) mund të mbajë njohurinë, bazat e të dhënave dhe rrjetet që janë përftuar dhe mund të drejtojë përmirësimin e analizave të vlerësimit të ndikimit. Monitorimi dhe studimet vjetore mund të japin mbështetje të mëtejshme për qeveritë kombëtare dhe i sigurojnë komunitetit ndërkombëtar informacionin e duhur për sa i përket bujqësisë dhe politikave bujqësore në vendet e BP-së.

2 Shqipëria: zhvillimi dhe vlerësimi i politikave bujqësore

Edvin Zhllima*dhe Grigor Gjeci**

* Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit
** Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë (MBZhRAU)

2.1 Hyrje dhe qasje

Shqipëria, si një vend kandidat për anëtarësimin në BE, po përpiqet të përmbushë objektivat e saj afatgjatë të zhvillimit dhe të njehsojë politikat e saj me *acquis communautaire* si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE. Që prej vitit 2014, kur ju dha statusi si vend kandidat, Qeveria e Shqipërisë ka bërë përpjekje për të reformuar politikat e saj të bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe të përditësojë kuadrin e saj institucional për ta sjellë në përputhje me PPB-në.

Politikat bujqësore, me një rëndësi shumë-dimensionale për Shqipërinë, adresojnë çështje të tilla si përmbushja e standardeve të BE-së në lidhje me sigurinë ushqimore dhe qëndrueshmërinë e prodhimit bujqësor, promovimi i zhvillimit rural dhe përgatitja e sektorit bujqësor që të përballojë presionet konkurruese të tregut të vetëm pasi të pranohet në BE. Kjo nënkupton që politikat bujqësore të Shqipërisë duhet t'i nënshtrohen reformave për të siguruar përputhjen e tyre me PPB-në e BE-së dhe të arrihet një sektor bujqësor ekonomikisht i suksesshëm, siguri ushqimore e përmirësuar dhe jetesë rurale të qëndrueshme. Si i tillë, ky kuadër politik në rritje kërkon një vizion të ri politikë-bërje, si dhe një qasje të re për të përpiluar masat mbështetëse për sektorin bujqësor.

Objektivat e këtij kapitulli konsistojnë në paraqitjen e zhvillimeve kryesore të mbështetjes bujqësore në Shqipëri, të diskutojë zbatimin e tyre bazuar në dokumente strategjike dhe programuese, dhe të vlerësojë përputhshmërinë e tyre me PPB-në. Në mënyrë specifike, objektivat kryesore të kapitullit janë (1) të paraqesë tendencat kryesore në transfertat buxhetore bujqësore në Shqipëri bazuar në metodologjinë e MPB-së; (2) të përmbledhë dokumentet e reja strategjike dhe programuese të politikave bujqësore, me një fokus në planifikimin buxhetor dhe zbatimin e politikave; (3) të vlerësojë zbatimin e dokumenteve strategjikë dhe programues duke përdorur metodologjinë e MPB-së; dhe (4) të japë rekomandime mbi politikat.

Për realizimin e kësaj analize krahasuese, u përdor versioni zyrtar i MPB-së për matjen dhe klasifikimin e mbështetjes buxhetore bujqësore. Periudha e mbuluar në këtë analizë është nga viti 2010 në vitin 2015. Të dhënat e përdorura në MPB u morën nga Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), duke përfshirë Agjencinë Paguese. Procesi i mbledhjes së të dhënave u vijua nga një vlerësim dhe harmonizim i detajuar i informacionit të mbledhur për të siguruar konsistencën dhe përputhshmërinë e tij midis burimeve të ndryshme të përdorura në këtë kapitull.

Vëmendje e veçantë ju dha edhe ekzaminimit të lidhjes midis masave të deklaruara të politikave dhe zbatimit *de facto* në kushtet e ekzekutimit të transfertave buxhetore në Shqipëri. Krahasimi midis planifikimit dhe zbatimit të politikave bujqësore u krye bazuar në dokumentet kryesore zyrtare të cilat janë: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 (QSH 2013), Programi i Qeverisë së Shqipërisë për periudhën 2013-2017, Strategjia Ndër-Sektoriale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (SNBZHR) 2014 – 2020 (MBZHRAU 2014a), Plani i Veprimit për SNBZHR 2014 – 2020 (MBZHRAU 2014b) dhe Plani i Veprimit i përditësuar për periudhën 2016 – 2018 (MBZHRAU 2016a). Raportet e përgatitura nga Qeveria e Shqipërisë për Departamentet e Këshillit të Ministrave për Monitorimin e Legjislacionit dhe Programeve (MBZHRAU 2016b) gjithashtu u shqyrtuan dhe u krahasuan. Megjithatë, për shkak të mungesës së dokumenteve zyrtare, jo gjithmonë ishte i mundur një krahasim i drejtpërdrejtë i politikave në nivel masash.

Kapitulli paraqitet në gjashtë seksione. Seksioni i dytë paraqet një analizë krahasuese të strategjive dhe dokumenteve të programimit për politikat bujqësore në Shqipëri. Seksioni i tretë tregon një pasqyrë të zhvillimit të politikave bujqësore për periudhën 2010 – 2015. Në seksionin e katërt përshkruhen evoluimi i mbështetjes direkte për prodhuesin dhe kufizimet kryesore që hasen në aspektin e njehsimit me PPB-në. Seksioni i pestë shqyrton tendencat kryesore dhe divergjencat e zbatimit të politikave bujqësore në raport me planet e shprehura në dokumentet strategjike. Seksioni i fundit nxjerr përfundime dhe jep rekomandime mbi politikat.

2.2 Strategjitë dhe dokumentet e programimit për politikat bujqësore

Pasi ju dha statusi i vendit kandidat në BE në Qershor të vitit 2014, Shqipëria ka përparuar në për-afrimin e politikave të saj bujqësore me *acquis* e BE-së. SNBZHR-ja për periudhën 2010 – 2020, e cila kërkohet nga procesi i pranimit në BE, u miratua në vitin 2014 (MBZHRAU 2014a). Kuadri ligjor kryesor që rregullon programimin e politikave bujqësore përkufizohet në Ligjin mbi Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, miratuar në 2007.

SNBZHR-ja 2014-2020 është zhvendosur në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 – 2017, i cili vë në dukje objektivat afatmesëm për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale në Shqipëri (MBZHRAU 2016a). Së fundmi është duke u përgatitur një përditësim i planit të veprimit kombëtar që implementon SNBZHR-in 2014-2020 (tashmë për 2016-2018). Zbatimi i prioriteteve afatmesëm të SNBZHR 2014-2020 janë të detajuara në planet vjetore të veprimit. Plani vjetor i veprimit raportohet nga MBZHRAU tek Këshilli i Ministrave, për tu trajtuar nga Departamentit të Monitorimit të Legjislacionit dhe Programeve të këtij istitucioni. Çdo aktivitet i përshkruar në planin vjetor të veprimit të MBZHRAU kodohet, i caktohet një organi përgjegjës dhe vihet në linjë me një paragraf specifik në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2016-2020.

Plani vjetor i veprimit, në perputhje me SNBZHR 2014-2020, përcakton bazën ligjore për ngritjen e skemave kombëtare të mbështetjes. Ai vendos masat specifike të disponueshme për sektorin bujqësor në vitin e dhënë. Alokimi financiar për skemat e mbështetjes, përkufizuar në planin vjetor të veprimit jepet nga programi vjetor i buxhetimit dhe zbatohet nga vendimet e Këshillit të Ministrave.

Për sa i përket programit të para-antarësimit IPARD (në vijim të planit SNBZHR 2014-2020), Programi IPARD II u adoptua nga Qeveria e Shqipërisë dhe miratua nga KE në Korrik të vitit 2015 dhe në vijim u ratifikua nga Parlamenti Shqiptar në Mars të vitit 2016. Në këtë fazë, struktura që operon IPARD-in (autoriteti menaxhues) dhe Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor (Agjencia Paguese) janë subjekt i akreditimit nga BE. Pritet që zbatimi i programit IPARD të fillojë në gjysmën e parë të vitit 2017.

SNBZHR 2014-2020 është nën adaptim dhe përshtatje të vazhdueshme për t'ju përgjigjur sfidave që lindin në zbatimin e politikave dhe për të reaguar ndaj zhvillimit në vazhdimësi të sektorit bujqësor. Një sërë prioritete politikash, të cilat vihen në dukje në SNBZHR 2014-2020, janë në rishikim të vazhdueshëm në kushtet e datës së futjes së tyre dhe strategjisë së zbatimit. Disa prej prioriteteve që janë realizuar pjesërisht apo plotësisht, janë lënë për zbatimin gjatë periudhës 2016-2018 (p.sh. futja e masave të mbështetjes në diversifikimin e prodhimit) dhe masa të tjera janë planifikuar për t'u aplikuar pas vitit 2018, kur pritet të përmbushen kushtet për futjen e tyre (p.sh. hartimi i politikave lidhur me cilësinë e ushqimit e tillë si treguesi gjeografik).

2.3 Zhvillimi i politikave bujqësore

Gjatë viteve 2010-2015 (Figura 2.1), niveli i mbështetjes buxhetore për bujqësinë u lëkund, por nivelet kanë treguar një tendencë në rritje. Në vitin 2015, mbështetja e përgjithshme buxhetore shkoi në 35 milionë euro nga 19 milionë euro në vitin 2010.

Figura 2.1. Mbështetja buxhetore për bujqësinë sipas shtyllave të MPB-së në Shqipëri, 2010-2015



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Shqipëri)

Mbështetja buxhetore për bujqësinë në Shqipëri është modeste krahasuar me kontributin e sektorit të bujqësisë në ekonominë kombëtare dhe me nivelin e mbështetjes që i jepet në vendet e tjera të BP-së dhe në BE (Volk et al., 2014). Edhe pse mbështetja buxhetore në vitin 2015 ishte më e lartë se në vitet e mëparshme, ende ishte vetëm 1,7 % e vlerës së shtuar bruto (VSHB-së) prej bujqësisë (Tabela 2.1). Kjo shifër është e ulët duke konsideruar kontributin e sektorit bujqësor në VSHB-në e përgjithshme, e cila ka qenë rreth 20 % në vitet e fundit (21,7 % në vitin 2015; baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Shqipëri)).

Table 2.1. Niveli relativ i mbështetjes buxhetore për bujqësinë në Shqipëri, 2010 – 2015.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Mbështetja buxhetore për bujqësinë (milionë euro)	19.0	26.8	23.6	20.1	27.8	35.0
VSHB-ja në bujqësi (milionë euro)	1.535	1.612	1.765	1.914	2.024	2.052
Pjesa e mbështetjes për bujqësinë ndaj VSHB në bujqësi (%)	1.2	1.6	1.3	1.1	1.4	1.7

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Shqipëri)

Viti 2015 shënoi jo vetëm një rritje të konsiderueshme në mbështetjen e përgjithshme buxhetore, por gjithashtu dhe një ndryshim në përbërjen e saj krahasuar me vitet e mëparshme. Pjesa e masave të zhvillimit strukturor dhe rural (shtylla e dytë) në mbështetjen totale të bujqësisë u rrit në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 (nga 39 % në 2014 në 61,7 % në vitin 2015), por mbetet e tkurrur krahasuar me vitin 2010 (kur ishte 80 % e mbështetjes totale). Vlera e saj u rrit nga 15 milionë euro në vitin 2010 në 21,3 milionë euro në vitin 2015. Masat e përgjithshme të lidhura me bujqësinë (shtylla e tretë) morën nivelin e dytë më të lartë të fondeve në vitin 2015, duke marrë 24,2 % të mbështetjes totale (në rënie nga 50 % në vitin 2014 dhe lehtësisht në rritje krahasuar me 16,3 në vitin 2010), ndërsa vlera e saj u rrit me më shumë se 174 % në vitin 2015 krahasuar me vitin 2010 (nga 3,1 milionë euro në vitin 2010 në 8,5 milionë euro në vitin 2015). Mbështetja direkte për prodhuesin mori nivelin e tretë më të lartë të fondeve, duke përbërë 15,1 % të totalit të mbështetjes bujqësore në vitin 2015 (në rritje nga 11 % në vitin 2014 dhe 4,7 % në vitin 2010). Vlera e saj përfaqësoi 0,9 milionë euro në vitin 2010 dhe 5,3 milionë euro në vitin 2015. Rëndësia e mbështetjes direkte për prodhuesin është rritur përgjatë viteve të fundit në Shqipëri. Megjithatë, niveli relativ është ende i ulët krahasuar me vendet e tjera të BP-së (Volk et al., 2016). Masat e mbështetjes së tregut nuk janë zbatuar në Shqipëri (Figura 2.1).

Nivelet totale të fondeve për masat e zhvillimit strukturor dhe rural, me një vlerë prej 21,3 milionë euro në vitin 2015, janë të orientuara për të përmirësuar konkurrueshmërinë e sektorit agro-ushqimor (Tabela 2.2). Në Shqipëri gjithashtu mungon alokimi i fondeve të zhvillimit rural drejt mbështetjes së ekonomisë rurale dhe punësimit apo dhe drejt ruajtjes së mjedisit dhe sigurimit të shërbimeve për ekosistemin([6]).

Tabela 2.2. Shpenzimet buxhetore për masat e zhvillimit strukturor dhe rural në Shqipëri (milionë euro), 2010-2015.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Mbështetje për investimet në fermë	6.6	4.9	4.8	4.2	1.0	1.1
Modernizimi i njësive ekonomike bujqësore	0.3	0.5	0.7	1.4	0.7	0.7
Ristrukturimi i plantacioneve të kulturave bimore të përhershme	5.2	4.2	3.7	2.4	0.0	0.2
Sistemet e vaditjes	1.1	0.3	0.5	0.5	0.3	0.1
Infrastruktura e kullimit, vaditjes dhe menaxhimit të ujërave	7.6	15.1	11.3	5.2	5.1	14.7
Përpunimi, marketingu dhe promovimi i ushqimit	0.8	0.4	0.4	0.5	4.6	5.5
Masat e zhvillimit strukturor dhe rural, totali	**15.0**	**20.4**	**16.6**	**9.9**	**10.7**	**21.3**

Burimi: baza e të dhënave të MPB-së (Shqipëri).

Midis masave specifike, pjesa më e madhe e totalit të mbështetjes për zhvillimin rural, e cila është rritur me kalimin e kohës, shkoi në financimin e infrastruktures kulluese, infrastrukturës së menaxhimit të sistemit vaditës dhe menaxhimit të burimeve ujore. Vlera e saj u rrit nga 7,6 milionë euro në vitin 2010 në 14,7 milionë euro në vitin 2015, duke përfaqësuar mesatarisht 60 % të mbështetjes totale të zhvillimit rural për periudhën 2010–2015.

Në kontrast, mbështetja e investimeve në fermë ra ndjeshëm gjatë periudhës së studimit: nga 6,6 milionë euro në vitin 2010, në 1,1 milionë euro në vitin 2015 (Tabela 2.2). Kjo tendencë rënieje në nivelet e mbështetjes së investimeve në fermë kryesisht u shkaktua nga reduktimi i mbështetjes për plantacionet e kulturave bimore të përhershme (veçanërisht ullinjve), ndërsa mbështetja për investimet në fermë që synon përmirësimet teknologjike (vaditja me pika, puset dhe ngrohja me biomasë), plantacionet e bimëve mjekësore, zgjerimin e serrave dhe modernizimin e fermave (pajisje të reja, ndërtesa me konstruksione të lehta) është rritur gjatë viteve të fundit. Megjithatë, kjo nuk ka kompensuar reduktimin e mbështetjes me investime në fushat e tjera.

Në Shqipëri, sektori i serave dhe frutave është konsoliduar si pasojë e zgjerimit të sipërfaqeve të mbjella dhe arritjes së vetë-përmbushjes për llojet kryesore të frutave dhe perimeve, arritje këto të një dekade a më shumë. Ky zhvillim kryesisht u promovua me anë të mbështetjes në investime që synonte promovimin e integrimeve më të forta midis prodhimit kryesor dhe segmenteve të zinxhirëve të vlerës të fazës së përpunimit dhe tregtimit. Mbështetja e industrisë përpunuese të ushqimit filloi të rritej në rëndësi, veçanërisht në vitin 2014 me futjen e dy masave kryesore: mbështetje në investime për infrastrukturë magazinimi, pas-vjeljeje dhe përpunimi (me 50 % të mbështetjes) dhe mbështetje të normës së interesit për investimet e reja në sektorin e industrisë agro-ushqimore (me 70 % të mbështetjes).

Masa të përgjithshme të mbështetjes konsistojnë në mbështetje për kërkimin dhe zhvillimin në bujqësi, shërbimet e këshillimit dhe ekstensionit për bujqësinë, financimin publik të masave në fushën e sigurisë ushqimore dhe cilësisë së ushqimit (masat veterinare dhe fitosanitare) dhe masa të tjera të përgjithshme (kryesisht asistencë teknike).

Me kalimin e kohës, mbështetja e përgjithshme ka treguar tendenca pozitive, duke u rritur nga 3,1 milionë euro në vitin 2010, në 8,5 milionë euro në vitin 2015. Niveli më i

([6]) Masat për rikthimin, ruajtjen dhe përmirësimin e shërbimeve të ekosistemit të lidhura me bujqësinë dhe pyjet janë planifikuar të implementohen në periudhën 2018-2020.

lartë u vëzhgua në vitin 2014, kur arriti 14 milionë euro, e cila ndodhi sepse Shqipëria mori një shumë të rëndësishme ndihme lidhur me sigurinë ushqimore dhe asistencë teknike nga projekte të BE-së dhe Bankës Botërore. Megjithatë, në vitin 2015, niveli i masave të përgjithshme të mbështetjes ra ndjeshëm krahasuar me vitin 2014. Ky reduktim kryesisht ishte pasojë e reduktimit të ndihmës ndërkombëtare (Figura 2.2).

Figura 2.2. Shpenzimet buxhetore për masat e përgjithshme të lidhura me bujqësinë në Shqipëri, 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Shqipëri)

Nivelet e fondeve buxhetore për kërkim dhe zhvillim dhe transferim njohurish tek fermerët janë të qëndrueshme; megjithatë, në vitet e fundit kanë përfaqësuar vetëm 25 % të totalit të mbështetjes për shërbime të përgjithshme, duke treguar një ndërgjegjësim të ulët të rëndësisë së njohurive për zhvillimin e bujqësisë. Nga MBZHRAU po formulohet një reformë e re që do të rezultojë në riorientimin e Qendrave të Transferimit të Teknologjisë Bujqësore në perputhje me axhendën afatgjatë të kërkimit.

2.4 Masat e mbështetjes direkte ndaj prodhuesit

Mbështetja direkte ndaj prodhuesit ishte relativisht modeste por tregoi një tendencë pozitive në Shqipëri në periudhën 2010-2015. Vlera e saj u rrit nga 0,9 milionë euro në vitin 2010, në 5,3 milionë euro në vitin 2015. Në terma relativë, u rrit nga 4,7 % në rreth 15,1% e mbështetjes totale të bujqësisë gjatë së njëjtës periudhë. Pjesa më e madhe e mbështetjes direkte ka shkuar për pagesat direkte (85% në 2015). Subvencionet e inputit përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të mbështetjes direkte totale, por po rriten me kalimin e kohës (Tabela 2.3).

Tabla 2.3. Mbështetja direkte për prodhuesin në Shqipëri (milionë euro), 2010-2015.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Pagesa direkte ndaj prodhuesit	0.885	0.418	1.519	1.948	2.247	4.507
Dele dhe dhi (për krerë)	0.499	0.153	1.089	1.210	1.602	3.409
Qumështi i lopës (për lopë me orientim prodhim qumështi, për litër qumështi)	0.352	0.212	0.271	0.316	0.411	0.367
Mjaltë (për koshere)	-	-	0.089	0.137	0.143	0.414
Pagesa direkte të tjera	0.034	0.052	0.070	0.285	0.091	0.317
Subvencione për inpute variabël	-	-	0.035	0.100	0.798	0.782
Mbështetja direkte për prodhuesin, totali	**0.885**	**0.418**	**1.554**	**2.048**	**3.045**	**5.289**

Burimi: baza e të dhënave të MPB-së (Shqipëri).

Pjesa më e madhe e pagesave direkte shkon për sektorin e blegtorisë, kryesisht në formën e pagesave për krerë për të imtat, të cilat mesatarisht, përbënin më shumë se 60

% të fondeve totale për pagesat direkte në periudhën 2010 – 2015 (76 % në vitin 2015). Pagesat direkte gjithashtu jepen rregullisht për prodhimin e qumështit të lopës dhe gjatë viteve të fundit edhe për bletërritësit.

Skema të tjera të pagesave direkte janë zbatuar vetëm gjatë disa periudhave të shkurtra. Mbështetje për grumbullimin dhe dërgimin e frutave me vlerë të lartë (p.sh. gështenjat, shegë dhe boronica) dhe, së fundmi, për perimet dhe për mbarështimin e krerëve të blegtorisë (kuajt, lepujt dhe mëshqerrat e racës së pastër) zgjatën jo më shumë se 3 vjet dhe, në disa raste, mbështetja u dha vetëm për 1 vit (p.sh. mbështetje për mishin dhe lëkurën e dërguar në thertore).

Dy vitet e fundit kanë dëshmuar një rritje në subvencionet për prodhim (pagesat direkte bazuar në prodhim) në Shqipëri. Subvencionet e prodhimit u prezantuan me qëllimin për të intensifikuar dhe formalizuar marrëdhëniet vertikale të zinxhirit të vlerave. Në të kaluarën, subvencionet e prodhimit u përdorën për të rritur oferten e vajit të ulliri ekstra të virgjër, por u ndërprenë në vitin 2013. Në periudhën 2013-2014, pagesat e lidhura me prodhimin (coupled) u prezantuan për të mbështetur mbledhjen dhe dorëzimin e frutave të pyllit. Në 2 vitet e fundit, subvencionet e prodhimit u zgjeruan nëpërmjet futjes së shpërblesave në cmim për qumeshtin e dërguar në industrinë e përpunimit të qumështit si dhe për fruta-perimet që ishin të destinuara për qendrat e grumbullimit dhe përpunimit.

Ka pasur një rritje të lehtë në nivelet e subvencioneve të inputit në vitet e fundit (nga 0,03 milionë euro në 2012, në 0,8 milionë euro në 2015), edhe pse ende përfaqësojnë një pjesë relativisht të vogël të mbështetjes bujqësore totale (2 % në vitin 2015) apo të mbështetjes direkte për prodhuesin (15 % në 2015). Subvencionet e inputit janë të vogla në Shqipëri sepse politikë-bërësit kanë qenë të kujdesshëm në aplikimin e tyre për të evituar shtrembërimet e tregut dhe janë dekurajuar nga një sistemi i dobët zbatimi dhe monitorimi. Rregullat e përforcimit dhe zbatimit për subvencionet e inputeve janë karakterizuar nga ndryshime të shpeshta që kanë qenë të motivuar nga shqetësimet për "rrjedhjen" e tyre për përdorime të tjera (jo bujqësore). Për shembull, subvencionet e karburantit për industrinë e serave ishin të disponueshme për fermerët para vitit 2006 dhe u shfaqën përsëri vetëm në vitin 2014 pas debateve të gjata politike; megjithatë, u anulluan përsëri në vitin 2015. Faktori kryesor që e bën zbatimin e subvencionit të karburantit të vështirë në Shqipëri është mungesa e një sistemi efektiv për monitorimin e përdorimit të karburantit të ndarë për qëllime bujqësore dhe jo-bujqësore (me fjalë të tjera, mungesa e depozitave të veçanta në ferma, sistemeve të ngjyrimit të karburantit, kontrollit të doganave për kodet e caktuara të karburantit, etj.). E njëjta gjë ndodhi për subvencionet e plastmasëve që u jepeshin fermerëve në sektorin e perimeve. Një subvencion më i suksesshëm i inputit ka qenë mbështetja e dhënë për mbrojtjen e ullishtave nga insektet, e cila paguhet në formën e pagesave fikse për sipërfaqe. Kjo është zbatuar që prej vitit 2008 dhe shuma totale rritet me kalimin e kohës.

Pagesat direkte të ndara nga prodhimi (decoupled) nuk janë zbatuar në Shqipëri, edhe pse janë sistemi më i rëndësishëm i mbështetjes nën PPB-në. Infrastruktura institucionale bazë që nevojitet për zbatimin e pagesave direkte të ndara nga prodhimi, të tilla si Regjistri i Fermës, Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës (SIPT) dhe Sistemi i Integruar i Administrimit dhe Kontrollit (SIAK), akoma nuk janë të mundësuar dhe ky është faktori kryesor që kufizon futjen e këtyre pagesave në Shqipëri. Dokumentet strategjike që përcaktojnë zhvillimin e politikave të bujqësisë për 2014 – 2020 parashikojnë krijimin e infrastrukturës së nevojshme institucionale në vitin 2020, gjë e cila implikon që pagesat direkte të ndara nga prodhimi (decoupled) mund të futen në Shqipëri në vitin 2020.

2.5 Zbatimi i dokumenteve të politikave bujqësore

Planet afatmesme për mbështetjen buxhetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri janë të përcaktuara në SNBZHR 2014-2020. Kjo vë në dukje prioritetet e politikave dhe shpërndarjen e fondeve sipas skemave mbështetëse deri në vitin 2020. Në

vijim të programimit të vendosur në SNBZHR 2014-2020, mbështetja e përgjithshme bujqësore pritet të rritet pesëfish në periudhën 2014-2020 (QSH 2013). Kjo rritje në nivelin e mbështetjes totale është planifikuar të financohet nga buxheti kombëtar si dhe nga fonde të BE-së nëpërmjet Programit IPARD II. IPARD mendohet të kontribuojë 71 milionë euro gjatë periudhës 2014-2020, ndërsa kontributi i buxhetit kombëtar mendohet të rritet nga 20 milionë euro në vitin 2014, në EUR 23 milionë në vitin 2020.

Kur krahasohet mbështetja e planifikuar në SNBZHR 2014-2020 me zbatimin aktual, nuk vihen re pabarazi të rëndësishme për masat e mbështetjes. Në përgjithësi, diferenca midis mbështetjes së disbursuar dhe mbështetjes së planifikuar ishte më pak se 5% për pjesën më të madhe të masave gjatë 3 viteve të fundit. Pabarazitë shpesh u shkaktuan nga interesi i ulët për fermerët në disa skema mbështetëse. Në raste të tilla, fondet u transferuan midis skemave për të evituar mospërdorimin e fondeve të alokuara. Pra, nëse kishte një kërkesë të ulët për një skemë specifike në gjysmën e parë të vitit, fondet u alokuan në skemat e tjera gjatë gjysmës së dytë të atij viti.

Megjithatë, disa mospërputhje ekzistonin midis formulimit të politikave dhe zbatimit të politikave. Në veçanti, kjo ka të bëjë me pamundësinë në sigurimin e një koherence dhe koordinimi të plotë midis SNBZHR 2014-2020, IPARD II dhe planeve vjetore të veprimit. Pavarësisht angazhimit të MBZHRAU për të arritur përafrimin midis PPB-së dhe politikave bujqësore kombëtare, ka kufizime të ndryshme ligjore që pengojnë futjen e skemave të ngjashme me PPB-në sikundër është planifikuar në dokumentet strategjike. Tabela 2.4 përmbledh mospërputhjet midis planeve për futjen e reformave të ndryshme institucionale dhe bujqësore dhe realizimin e tyre aktual. Dy kolonat e para të Tabelës 2.4 listojnë masat kryesore të politikave dhe planin e veprimit sikundër është theksuar në Planin Kryesor të Veprimit; kolona e tretë raporton datën e prezantimit të masës dhe kolona e katërt raporton nëse planet u realizuan në lidhje me datën e synuar të objektivit. Objektivat e përdorur për të identifikuar nëse u zbatua ndonjë ndryshim i veçantë institucional apo politik, janë përcaktuar duke u bazuar në aktivitetet e përshkruara në Planin Kryesor të Veprimit 2014-2020 (MBZHRAU 2014b). Statusi i arritjes është bazuar në planin e veprimit të MBZHRAU-së për 2016-2018 (MBZHRAU 2016a).

Në vijim të rezultateve të raportuara në Tabelën 2.4, është e qartë që reformat e politikave ishin të suksesshme në përgatitjen e zbatimit të IPARD II për Shqipërinë. Kjo do të lejojë një rritje në nivelin e mbështetjes për investime për asetet fizike të njësive ekonomike bujqësore, përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe të peshkimit dhe diversifikimin e aktiviteteve të fermave dhe zhvillimin e biznesit. Këto masa, të shoqëruara nga asistenca teknike, janë hartuar dhe janë të gatshme për t'u zbatuar pas akreditimit të institucioneve të zbatimit. Megjithatë, aktivitete të tjera të planifikuara në Planin Kryesor të Veprimit 2014-2020 ende nuk janë të programuara për zbatim. Për shembull, mbështetja për zbatimin e veprimeve kolektive midis fermerëve dhe të interesuarve të tjerë, konsolidimin e tokës, përmirësimin e cilësisë së produkteve bujqësore, përmirësimin e mjedisit bujqësor dhe klimës dhe të bujqësisë organike, janë disa prej masave që ende nuk janë arritur apo nuk janë planifikuar për t'u prezantuar. Përgatitja e prezantimit të kuadrit të nevojshëm ligjor për zbatimin e këtyre masave (p.sh. ligji mbi fermat organike, baza ligjore e organizatave të tregut të përbashkët, ligji mbi kooperativat, ligji mbi konsolidimin e tokës, etj.) kufizohet nga limitet apo kufinjtë e kapaciteteve financiare dhe institucionale të administratës publike, edhe pse MBZHRAU po bën përpjekje për të arritur këtë synim duke koordinuar projektet në vazhdimësi të ngritjes së kapaciteteve dhe veprimet e brendshme të stafit.

Një grup i dytë masash i lidhur me mbështetjen e shërbimeve të këshillimit, përgatitjen dhe zbatimin të strategjive të zhvillimit rural duke përdorur qasjen LEADER, janë subjekt i ndryshimeve dhe shtyrjeve si një rezultat i reformave të reja territoriale që zbatohen në Shqipëri. Kjo reformë territoriale shoqërohet nga futja e një numri të madh ndryshimesh në administratën publike në nivel lokal dhe kombëtar, të cilat, midis të tjerash, pengojnë reformën e shërbimeve veterinare, shërbimeve këshilluese, menaxhimin e ujërave, sistemit të vaditjes dhe menaxhimin e tokës dhe pyjeve.

Një tjetër mangësi që i bën politikat bujqësore sfiduese për t'u zbatuar dhe vë në vështirësi institucionin përgjegjës, është numri i madh i skemave të mbështetjes që aplikohen në Shqipëri. Në vitin 2015 u aplikuan në total 10 skema, të cilat u ndanë në 17 nën-skema. Duke parë kufizimet institucionale në Shqipëri, ky numër skemash ende konsiderohet relativisht i lartë, pavarësisht reduktimit me kalimin e kohës. Në të njëjtën kohë, masat ndryshojnë shpesh pa u lidhur me një vizion politik apo pa u udhëhequr nga vendime të bazuara në evidenca. Për më tepër, disa skema mbijetojnë për vetëm 1 vit dhe më pas ndalen apo mëjanohen për të mos u përsëritur më në periudhën tjetër të programimit. Gjithashtu, shumica e skemave të mbështetjes që aplikohen në Shqipëri nuk janë plotësisht në përputhje me PPB-në. Rregullime të shpeshta që i bëhen sistemit të mbështetjes në Shqipëri gjenerojnë një mjedis të pasigurt politikash dhe strukturë nxitjeje e pasigurt për sektorin e bujqësisë. Si rezultat, operatorët bujqësorë mund të mos jenë në gjendje të lexojnë sinjalet e politikave që dëshirohen nga qeveritë, gjë e cila mund të rezultojë në dështimin e politikave për të arritur objektivat e tyre.

Tabela 2.4. Krahasimi midis planifikimit dhe zbatimit aktual të reformave të politikave institucionale dhe bujqësore në Shqipëri.

Masa e mbështetjes	Aktivitete të planit të veprimit	Data e prezantimit	Statusi
Investimet në asetet fizike të njësive ekonomike bujqësore, përpunimi dhe marketingu i produkteve bujqësore dhe të peshkimit, dhe diversikimi i aktiviteteve të fermës dhe zhvillimi i biznesit	Përfshirë në skemën kombëtare dhe IPARD II	2016	Planifikuar për t'u zbatuar me paketën e parë të masave të IPARD në vitin 2017
Mbështetje për komercializimin e fermerëve të vegjël (skema është pjesë e IPARD II)	Mbështetje nga donatorët (GIZ-DANIDA kontribuoi 13.1 milionë euro, nga të cilat 6.5 milionë euro ishin për grantet e investimeve)	2014	E kryer
Skemat e mbështetjes së agro-mjedisit dhe bujqësisë organike	Bujqësia organike dhe politikat e cilësisë së ushqimit duhet të hartohen	2016	Nuk është kryer ende, edhe pse janë bërë disa përgatitje nga projektet e FAO-s
Mbështetje për përmirësimin e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore	Adoptimi i legjislacionit mbi standardet e cilësisë së ushqimit dhe ngritja e strukturave implementuese për të siguruar përafrimin e kuadrit ligjor dhe zbatimit me *acquis*	2016	Nuk është kryer ende
Mbështetje për bashkëpunimin/kooperimin dhe shoqatat e fermerëve	Krijimi i grupeve prodhuese dhe shoqatave të prodhuesve bujqësorë	2016	Nuk është kryer ende dhe nuk është përfshirë në programin IPARD II sikundër planifikuar më parë
Krijimi/ ngritja dhe ruajtja e pyjeve	Rikthimi, ruajtja dhe përmirësimi i ekosistemeve që varen nga bujqësia dhe pyjet	2017	Nuk është kryer ende dhe nuk është përfshirë në programin IPARD II sikundër planifikuar më parë
Përgatitja dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit rural lokal (qasja LEADER)		2017	Nuk është kryer ende
Mbështetje për investimet për zhvillimin dhe infrastrukturën e zonave rurale	Mbështetja me investime e MBZHRAU-s dhënë për përmirësimin e infrastrukturës së vaditjes dhe kullimit	2017	Ende në vazhdimësi, përderisa Fondi Rajonal i Zhvillimit alokon fonde konkurruese për bashkitë
Trajnimi dhe ngritja e	Për tu kryer nëpërmjet	2017	Strategjia e zhvillimit

kapaciteteve për shërbimet e këshillimit	projekteve të ngritjes së kapaciteteve (mbështetje nga donatorët ndërkombëtarë)		territorial dhe ndryshimet institucionale duhet ende të merren në konsideratë
Ndryshimet e rregulloreve përkatëse për të siguruar regjistrimin e detyrueshëm të fermerëve që të përzgjidhen për mbështetje	Kryerja e regjistrimi të fermerëve në regjistrin e fermave dhe regjistra të tjerë përkatës (regjistri i krerëve të blegtorise, SIPT, etj.)	2016	Nuk është kryer ende, gjë e cila po pengon futjen e masave të mbështetjes për sipërfaqe
Masat e zhvilluara për të përmirësuar aksesin në kredi për fermerët	Mbështetje për ngritjen e Fondit të Garancisë për Kreditimin Rural nën Projektin IPA 2012	2016	E kryer (aktivizohet në 2017)
Mbështetje për transfertat e tregut të tokës dhe konsolidimit të tokës	Legjislacioni dhe projekti pilot përgatitur nga FAO	2016	Nuk është kryer ende

Burimi: analizë e autorëve, bazuar në Planin Kryesor të Veprimit 2014-2020 (MBZHRAU 2014b).

IPA, Instrumenti për Asistencë Para-anëtarësimi; SIPT, Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës

2.6 Përfundime dhe rekomandime për politikat

Si pasojë e marrjes së statusit të vendit kandidat, Shqipëria po përpiqet të ndërmarrë një reformë të shpejtë të politikave të saj bujqësore për të përmbushur kërkesat e integrimit në BE. Reforma bujqësore dhe e zhvillimit rural është një nga reformat thelbësore që duhet të kryhet në Shqipëri, sepse kërkon krijimin e një mjedisi kompleks politikash që do të promovojë prodhimin e qëndrueshëm bujqësor, përmirësimin e jetesës rurale dhe përmirësimin e konkurueshmërisë së sektorit bujqësor, ndërkohë që gradualisht e hap sektorin drejt konkurencës ndaj BE-së dhe vendeve të tjera të BP-së. Në mënyrë që të njehsojë politikat e saj bujqësore me kërkesat e PPB-së, Shqipëria ka adoptuar dokumente që nxjerrin në pah prioritetet e politikave bujqësore nëpërmjet SNBZHR-së 2014-2020, e cila ndërlidhet me strategjinë e integrimit të vendit në BE për periudhën 2014-2020 dhe vë në praktikë direktivat e zbatimit sic përcaktohen në Planin Kryesor të Veprimit për SNBZHR 2014-2020. Megjithatë, pavarësisht se kuadri ligjor i politikave bujqësore është relativisht i mirë-vendosur, implementimi i tij është ende prapa synimeve të planifikuara.

Në përgjithësi, mbështetja për sektorin bujqësor është rritur në Shqipëri gjatë periudhës 2010-2015 dhe përkon me nivelet e synuara të përshkruara nga qeveria në dokumentet e programimit për periudhën 2014-2020. Për më tepër, MBZHRAU parashikon reduktimin e kontributit të buxhetit kombëtar për mbështetjen e sektorit bujqësor dhe zëvendësimin e saj me fondet e IPARD të BE-së, të cilat do të jepen kryesisht për të përmirësuar konkurueshmërinë e sektorit bujqësor dhe diversifikimin e prodhimit në zonat rurale.

Mbështetja për sektorin bujqësor ka treguar një tendencë në rritje në Shqipëri gjatë periudhës 2010-2015. Në përgjithësi, kjo mbështetje u rrit nga 19 milionë euro në vitin 2010, në 35 milionë euro në vitin 2015. Mbështetja e zhvillimit strukturor dhe rural (shtylla e dytë) është skema më e rëndësishme e mbështetjes në Shqipëri, duke përbërë 60,7 % të mbështetjes bujqësore totale në vitin 2015, ndjekur nga mbështetja e shërbimeve të përgjithshme (24,2 % në 2015) dhe mbështetjes direkte për prodhuesin (15,1 % në 2015).

Mbështetja e zhvillimit rural përfaqëson pjesën më të madhe të mbështetjes bujqësore totale dhe përmbush nevojat strukturore të sektorit bujqësor në mënyrë të përshtatshme. Kjo lloj skeme gjatë periudhës së studimit, kryesisht mbështeti përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor. Në kontrast, nuk u shpërndanë fonde për mbështetjen e infrastrukturës rurale (me përjashtim të infrastrukturës së sistemit vaditës), punësimin rural, pyjet ose përmirësimin e mjedisit. Masat e përgjithshme të lidhura me bujqësinë – kryesisht të ndihmuara nga asistenca ndërkombëtare – adresuan aktivitete të ndryshme të një rëndësie publike, të tilla si kërkimi dhe zhvillimi bujqësor, shërbimet këshilluese dhe të ekstensionit, siguria e

ushqimit dhe cilësia e ushqimit, edhe pse ranë ndjeshëm në vitin 2015. Mbështetja direkte për prodhuesin ishte relativisht modeste por tregoi një tendencë pozitive në Shqipëri në periudhën 2010-2015. Pjesa më e madhe e mbështetjes direkte ka shkuar për pagesat direkte (85% në vitin 2015), shumica e të cilave është marrë nga sektori i blegtorisë.

Fushat e politikave që morën vëmendje më të pakët por që janë të rëndësishme në rritjen e sektorit të bujqësisë shqiptare dhe zhvillimin rural për procesin e pranimit në BE, përfshijnë mbështetjen për bashkëpunimin/kooperimin e fermerëve, konsolidimin e tokës, infrastrukturën rurale, fermat organike, shërbimet e bujqësisë, shërbimet e këshillimit, siguria e ushqimit dhe standardet e cilësisë. Mendohet që këto masa do të prezantohen në gradë të ndryshme nën IPARD II ose, në përgjithësi, nën SNBZHR 2014-2020. Futja e disa prej këtyre masave (p.sh. infrastruktura rurale) gjithashtu varet nga finalizimi me sukses i reformës territoriale dhe konsolidimit të administrimit lokal, të cilat po kalojnë që të dyja një riorganizim në Shqipëri.

Absorbimi/thithja e fondeve ekzistuese pengohet nga mundësimi i asistencës teknike dhe mbështetjes për produkte financiare dhe që kanë të bëjnë me kredinë (të tilla si skemat e garantimit të kredisë) për fermerët, e cila mund të pengojë futjen dhe marrjen e skemave të ardhshme të mbështetjes, sikundër planifikuar në dokumentet e programimit. Bashkëpunimi me donatorët ndërkombëtarë, të tillë si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Botërore, pritet të zhvillojë disa nga këto instrumente dhe mund të kontribuojë në përmirësimin e aksesit të fermerëve ndaj financave dhe përmirësimin e kapacitetit të tyre për të absorbuar/thithur mbështetje.

Ende nuk është e mundur që të futen pagesa direkte te ndara nga prodhimi (decoupled) në Shqipëri për shkak të pengesave ligjore dhe institucionale. Kapaciteti i nevojshëm administrativ dhe institucional për zbatimin e pagesave direkte te ndara nga prodhimi dhe pagesave për sipërfaqe dhe krerë (d.m.th. SIKA, SIPT, regjistrat, etj.) ende janë të pazhvilluara dhe po pengojnë futjen e skemave të ngjashme me PPB-në në Shqipëri. Për më tepër, ka mangësi të rëndësishme në futjen e sistemeve të informimit bujqësor, të tilla si sistemet e informimit të tregut apo mjete të tjera monitorimi, të tilla si Rrjeti i të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave (RRDHKF), i cili regjistroi një progres të ngadaltë në krijimin e një infrastrukture dhe kapaciteti administrativ për mbledhjen e të dhënave sistematike. Grumbullimi i të dhënave të RRDHKF-së gjithashtu u shty si rezultat i procesit të zgjatur të miratimit dhe verifikimit për rezultatet e Censusit të Bujqësisë 2012, e cili është një kërkesë thelbësore për ngritjen e një kampioni fermash të RRDHKF-së (MBZHRAU 2016c).

Në përgjithësi, përafrimi i legjislacionit kombëtar dhe instrumenteve të politikave me *acquis*-in e BE-së dhe zhvillimin e mëtejshëm institucional të infrastrukturës për zbatimin dhe forcimin e tij, janë sfidat kryesore për periudhën programuese që mbetet, 2016-2020, të cilat janë të nevojshme për ta përgatitur Shqipërinë për anëtarësimin në BE. Për më tepër, koordinimi ndër-institucional në Shqipëri duhet të akordohet për të siguruar që të ketë koherencë me reformat e politikave dhe ndryshimet institucionale që duhet të kryhen në sektorët e tjerë. Për të lehtësuar këto ndryshime, plani i veprimit për 2016-2018 duhet të rishikohet me kujdes dhe të shoqërohet me aktivitete të reja vjetore që duhet të planifikohen për periudhën e mbetur që mbulohet nga SNBZHR-ja (d.tm.th. 2017-2020). Koordinimi i asistencës së dhënë nga donatorët ndërkombëtarë gjithashtu është i dëshirueshëm për të mbajtur vrullin për përshpejtimin e reformave të nevojshme institucionale të cilat kërkohen nga SNBZHR-ja.

Falënderim

Autorët vlerësojnë shumë komentet e Dr. Drini Imami dhe Dr. Klodjan Rama mbi versionin e mëparshëm të këtij kapitulli, komente të cilat përmirësuan ndjeshëm cilësinë e dorëshkrimit.

3 Bosnja dhe Hercegovina: zhvillimi dhe vlerësimi i politikave bujqësore

Sabahudin Bajramović*, Željko Vaško, Dragana Ognjenović*dhe Jakub Butković*****

* Universiteti i Sarajevës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Shkencave Ushqimore
** Universiteti i Banja Lukës, Fakulteti i Bujqësisë
*** Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike të Bosnje e Hercegovinës, Zyra për Harmonizimin dhe Koordinimin e Sistemit të Pagesave në Bujqësi dhe Zhvillimin Ushqimor e Rural

3.1 Hyrja dhe qasja

Bujqësia në Bosnje dhe Hercegovinë është një sektor i rëndësishëm ekonomikisht ([7]) dhe politikisht i cili karakterizohet nga burime natyrore dhe potenciale prodhimi të nën-përdorura ([8]), produktivitet të ulët, kapacitete të ulëta teknike dhe teknologjike të fermave, vlerë e nën-zhvilluar e zinxhirit bujqësor dhe ushqimor, konkurueshmëri e ulët dhe varësi e konsiderueshme nga tregtia e jashtme. Përpos kësaj, marxhinalizimi shoqëror-ekonomik i zonave rurale i cili shoqërohet nga ulja e numrit apo largimit te popullsisë (emigrimi), e bën të qartë që politikat bujqësore të Bosnje dhe Hercegovinës përballen me sfida të shumta të cilat duhet të zgjidhen për të adresuar këto probleme në sektorin bujqësor dhe zonat rurale.

Edhe pse Bosnja dhe Hercegovina synon qartë integrimin evropian dhe harmonizimin e politikave të saj bujqësore me PPB-në e BE-së, ky proces po përparon ngadalë, pa asnjë shenjë të dukshme dhe pa asnjë gatishmëri politike për të avancuar me një ritëm më të shpejtë. Progresi i ngadaltë i procesit të integrimit në BE shkaktohet nga kriza ekonomike në vazhdim dhe, veçanërisht, nga mungesa e vullnetit politik për të zbatuar reformat e nevojshme. Kjo përforcohet nga fakti që Bosnja dhe Hercegovina nuk ka bërë progres në krijimin e strukturave të nevojshme institucionale për të zbatuar dhe përdorur IPARD-in dhe rrjedhimisht po humbet burime të konsiderueshme financiare të cilat mund të kontribuonin në ndërtimin e institucioneve dhe përmirësimin e sektorit bujqësor në Bosnje e Hercegovinë (MTJME 2016).

Politikat bujqësore në Bosnje dhe Hercegovinë tregojnë mos-përputhje të mëdha me objektivat e përshkruara dhe kanë ndryshuar shpesh me kalimin e kohës pa u udhëhequr nga objektiva zhvillimi të përcaktuar qartë dhe elementët e politikë-bërjes publike moderne që janë bazuar në monitorimin dhe vlerësimin e bazuar në evidenca (Bajramović et al. 2014, 2016). Si rezultat i mungesës së një mekanizmi financimi të qartë për politikat bujqësore, transfertat buxhetore vjetore varen gjerësisht nga strukturat politike qeverisëse dhe lobimin e grupeve të ndryshme të interesit.

Për veprimet e politikave afatmesme në sektorin bujqësor dhe zonat rurale janë krijuar kuadro të rinj në dy njësi administrative të Bosnje e Hercegovinës([9]). FBH adoptoi një strategji zhvillimi afatmesme për sektorin bujqësor për periudhën 2015-2019 (FBH 2014a), dhe RSR adoptoi një plan strategjik për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale për 2016-2020 (RSR 2015a). Të dyja dokumentet strategjike theksojnë vendosmërinë e tyre për integrimin evropian dhe konceptet e politikë-bërjes publike moderne. Megjithatë, evidencat paraprake për sa i përket zbatimit të tyre në këto dy njësi administrative nuk

([7]) Në vitin 2015 sektori bujqësor në Bosnje dhe Hercegovinë kontribuoi 7,1 % (838,1 milionë euro) të VSHB-së totale dhe 17,9 % (147 000 euro) të punësimit total. Bosnja dhe Hercegovina është një importuese neto e produkteve bujqësore. Në vitin 2015, eksportet totale të produkteve bujqësore dhe ushqimore përbënin 9,4 % (429,6 milionë euro) të totalit të eksporteve kombëtare, ndërkohë që importet përbënin 18,1 % (1,464 miliardë euro) të totalit të importeve (baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Bosnje e Hercegovinë)).

([8]) Nga 1,03 milionë hektarë të tokës bujqësore më produktive (d.m.th. tokë e punueshme), rreth vetëm gjysma e saj (49,5%) kultivohet në Bosnje dhe Hercegovinë, d.m.th. 510 000 ha (2015).

([9]) Ndarja administrative e Bosnje e Hercegovinës konsiston në dy entitete – Federata e Bosnje e Hercegovinës dhe Republika Serbe e Bosnjes dhe Hercegovinës – dhe Qarku Bërçko (QB)

zbulojnë asnjë ndryshim të rëndësishëm në procesin e politikë-bërjes dhe tregon aplikim të kufizuar të qasjes moderne në adresimin e nevojave të zhvillimit të sektorit bujqësor dhe zonave bujqësore. Qarku Bërçko (QB) nuk adoptoi një kuadër të ngjashëm me ato të dy njësive të tjera administrative dhe mbështetet në planifikimin afatshkurtër (vjetor) të politikave bujqësore (d.m.th. rregulloret vjetore).

Ky kapitull analizon politikat bujqësore në Bosnje dhe Hercegovinë për periudhën 2010-2015 nga perspektiva e programimit në lidhje me dokumentet strategjikë dhe nga perspektiva e përmasës dhe strukturës së mbështetjes që jepet. Duke pasur parasysh që politikat bujqësore në Bosnje dhe Hercegovinë nuk adoptohen dhe administrohen në nivel vendi por nga vetë njësitë administrative, analiza në këtë kapitull gjithashtu i referohet politikave që janë aplikuar në secilën nga tre njësitë administrative. Një fokus i veçantë i këtij kapitulli janë pagesat direkte, të cilat janë forma dominuese të transfertës së buxhetit drejt sektorit bujqësor në Bosnje dhe Hercegovinë.

Në mënyrë të ngjashme me vende të tjera, baza e të dhënave të MPB-së (baza e të dhënave të MPB-së (Bosnje dhe Hercegovinë)) përdoret në këtë kapitull për të nxjerrë të dhënat e politikave. Si edhe përmendur më sipër, baza e të dhënave përmban të gjithë informacionin e disponueshëm mbi transfertat bujqësore të bëra në një vit të caktuar nga ministritë përgjegjëse të FBH-së dhe RSR-së dhe Divizioni Bujqësor i Qeverisë së QB-së. Duhet të theksojmë që, në rastin e FBH-së, subvencionet e dhëna nga ministritë e kantoneve përgjegjëse për sektorin bujqësor janë përfshinë në bazën e të dhënave. Baza e të dhënave mbulon një periudhë më të gjatë (2002-2015), por për qëllimin e këtij kapitulli u përdorën të dhënat e periudhës 2010-2015.

Ky kapitull është i organizuar si vijon: seksioni vijues analizon dokumentet strategjike dhe programuese aktuale në Bosnje dhe Hercegovinë. Seksioni i tretë jep një analizë më të detajuar të zhvillimit të politikave bujqësore në Bosnje dhe Hercegovinë dhe ndryshimet më të mëdha në periudhën e studimit 2010-2015. Seksioni i katërt përshkruan mbështetjen direkte për prodhuesin më në detaje, e cila është skema mbështetëse më e rëndësishme në Bosnje dhe Hercegovinë. Seksioni i pestë jep një vlerësim të përgjithshëm të zbatimit të dokumenteve të reja strategjike. Në fund, seksioni i gjashtë nxjerr konkluzionet dhe thekson rekomandimet e politikave.

3.2 Strategjitë dhe dokumentet e programimit për politikat bujqësore

Analiza e strategjive dhe dokumenteve programuese për politikat bujqësore për tre njësitë administrative të Bosnje dhe Hercegovinës është bërë në mënyrë të ndarë sepse secila prej këtyre njësive ndjek politikat e saj bujqësore. Në përgjithësi, secila njësi administrative ka autoritetin të hartojë, përshtasë dhe zbatojë politika bujqësore në mënyrë të pavarur nga njësitë e tjera.

FBH-ja nuk pati një dokument strategjik për pjesën më të madhe të periudhës së studimit të përshkruar në këtë kapitull (2010-2015) e cila do të mund të përkufizonte objektivat afatmesme për zhvillimin e sektorit bujqësor. FBH-ja adoptoi një dokument strategjik në periudhën 2006-2010, ndërkohë që strategjia afatmesme e zhvillimit më e fundit e disponueshme për sektorin bujqësor u adoptua në vitin 2015 dhe mbulon periudhën 2015-2019 (FBH 2014a) ([10]). Ky dokument i ri strategjik thekson nevojën për të adoptuar teknologji të reja dhe risi në sektorin bujqësor, përdorim më efektiv të burimeve të disponueshme dhe përmirësim të cilësisë së jetës në zonat rurale. Për sa i përket integrimit evropian, ky dokument shpreh qartë nevojën për të harmonizuar kuadrin institucional dhe ligjor të FBH-së me legjislacionin e BE-së dhe *acquis communaitaire* të PPB-së. Në kontekstin e ndërtimit të institucioneve, kjo nënkupton krijimin e një sistemi modern informimi, menaxhimi administrativ dhe monitorimi të politikave bujqësore. Dokumenti i ri strategjik thekson nevojën për përafrimin gradual të

([10]) Vini re që strategjia thekson politikat bujqësore që janë të zakonshme për FBH-në si edhe politika specifike të qeverive te kantoneve. Kantonet në FBH kanë autoritetin të adoptojnë dhe zbatojnë masat e politikave të tyre specifike.

instrumenteve politike të politikave bujqësore të FBH-së me ato të zbatuara në PPB-në e BE-së. Për më tepër dokumenti i ri strategjik parashikon, për herë të parë, aplikimin e parimeve dhe elementëve të politikë-bërjes publike moderne në hartimin, adoptimin dhe zbatimin e politikave bujqësore, duke përfshirë një analizë bazë të detajuar, përkufizim objektivash, vendosjen e programimit të politikave, përkufizimin e një kuadri të qartë financiar (transferta buxhetore bazuar në parimet e konsistencës, transparencës dhe gjurmueshmërisë) dhe një sistem monitorimi dhe vlerësimi.

Strategjia e re parashikon zbatimin e 37 masave të shpërndara në tre shtylla të politikave bujqësore: 10 masa në shtyllën e parë të lidhura me ndërhyrjen në treg dhe mbështetjen direkte për prodhuesin, 17 masa në shtyllën e dytë të lidhura me ristrukturimin e sektorit dhe zhvillimin rural dhe 10 masa në shtyllën e tretë të lidhura me mbështetjen e shërbimeve të përgjithshme. Ndryshimet më të mëdha të prezantuara nga strategjia e re mbulojnë mbështetjen direkte për prodhuesin (d.m.th pagesat direkte). Propozohet reduktimi i një sërë pagesash direkte para-ekzistuese të lidhura me prodhimin (p.sh. subvencionet për prodhimin), ndërkohë që propozohet që të rriten pagesat për sipërfaqe dhe krerë. Barazimi i pagesave për sipërfaqe për shumicën e kulturave bimore mendohet ([11]) si hapi i parë drejt "ndarjes" së pagesave direkte, në perputhje me PPB-në e BE-së.

Për sa i përket pagesave direkte për fermat e orientuara për prodhim qumështi mendohet një kalim gradual nga pagesat e bazuara në prodhim (për litër) në pagesat për krerë (lopë). Strategjia e re parashikon heqjen e mbështetjes buxhetore për sektorin e rritjes së shpendëve. Për më tepër, njeh rëndësinë e politikave të zhvillimit rural, veçanërisht në pjesën e dytë të periudhës së zbatimit, ku propozohet një mbështetje e rëndësishme për zhvillimin rural. Strategjia gjithashtu adopton një qasje të re ndaj masave të përgjithshme në bujqësi. Forcimi i transferimit të njohurive, mbështetja për tregun dhe aktivitetet promovuese, menaxhimi i riskut dhe dispozita e sigurisë së ushqimit njihen si veprime të nevojshme që synojnë forcimin e shtyllës së tretë të politikave bujqësore në FBH.

Buxheti i parashikuar bujqësor në strategjinë për FBH-në, në nivelin e njësive administrative, varion midis 34,9 milionë euro (2015) dhe 47,7 milionë euro (2019), plotësuar nga mbështetje në nivel kantonesh me 7,7 milionë euro në 2015, duke u rritur në 11,8 milionë euro në vitin 2019. Raporti i shpërndarjes midis pagesave direkte dhe mbështetjes për zhvillimin rural është në favor të së parës në vitet e para të zbatimit të strategjisë (p.sh. një raport prej 67% me 33 % në vitin 2016), edhe pse në vitet e fundit raporti ka qenë lehtësisht në favor të mbështetjes për zhvillimin rural (45 % me 55 % në 2019). Burimet e planifikuara financiare për financimin e mbështetjes bujqësore në strategji përfshijnë buxhetet kombëtare dhe lokale (kantone), si dhe IPARD-in, Bankën Botërore dhe Bankën Evropiane të Investimeve.

Për sa i përket zhvillimit rural, është e rëndësishme të vihet re që FBH-ja ende nuk ka dokument programimi të miratuar të ligjshëm që do të lejonte një zbatim të detajuar të masave të zhvillimit rural. Propozimi për programin e zhvillimit rural për periudhën 2015-2020 (FBH 2014b) ende nuk është miratuar nga parlamenti. Ky propozim për programin e zhvillimit rural u krijua bazuar në parimet që përputhen me ato të IPARD-it në formatin e adoptuar për IPARD II ([12]). Propozimi konsideron gjashtë fusha mbështetjeje: (1) konkurueshmërinë e prodhimit bujqësor; (2) agro-mjedisin; (3) zbutje të ndryshimeve të klimës dhe prodhimin organik; (4) diversifikimin e aktiviteteve të fermave dhe zhvillimin

([11]) Përjashtim përbën prodhimi i misrit krerërr, prodhimi në zonat e mbrojtura, prodhimi i farërave dhe fidanëve dhe prodhimi i duhanit.

([12]) Nën IPA (Instrumentin për Asistencë Para-antarësimi) II, Bosnje dhe Hercegovinës ju alokua një total prej 165,8 milionë euro për periudhën 2014-2017. Megjithatë, nuk ka fonde të programuara për bujqësinë dhe zhvillimin rural (IPARD II) për periudhën 2014-2017 sepse Bosnja dhe Hercegovina nuk paraqiti strategjitë sektoriale në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe nuk ka krijuar strukturat e nevojshme institucionale për zbatimine tyre. Në vitin 2017 IPA II do të jetë subjekt i rishikimit dhe, nëse Bosnja dhe Hercegovina përmbush të gjitha kërkesat e nevojshme, pritet të jepen fonde shtesë për asistencën e para-anëtarësimit në BE.

e sipërmarrjes; (5) metodën LEADER të strategjive lokale të zhvillimit; dhe (6) asistencën teknike dhe masat në fushën e pyjeve (FBH 2014b).

RSR-ja adoptoi një plan të ri strategjik për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale në vitin 2015 për periudhën 2016-2020 (RSR 2015a) para afatit përmbyllës të dy dokumenteve të mëparshme strategjike (d.m.th. dokumenti strategjik për periudhën 2010-2015 dhe dokumenti strategjik për periudhën 2010-2015). Ndryshe nga dy strategjitë e mëparshme, dokumenti i ri strategjik në të njëjtën kohë mbulon si sektorin bujqësor ashtu edhe atë të zhvillimit rural. Në përgjithësi, strategjia e re përmban gjashtë qëllime strategjike dhe 16 qëllime specifike që propozohen për t'u zbatuar duke përdorur 52 masa të ndryshme.

Ndryshimet kryesore në masat e shtyllës së parë në dokumentin e ri strategjik parashikojnë reformën e mbështetjes direkte për prodhuesin, duke synuar reduktimin e numrit dhe llojit të instrumenteve. Pagesat direkte aktuale të disbursuara për njësi prodhimi (subvencionet për prodhimin) janë planifikuar për t'u ndryshuar në pagesa për sipërfaqe dhe për krerë ([13]), me përjashtim të qumështit dhe grurit. Për qumështin propozohet një periudhë kalimtare që do të zgjasë deri në vitin 2018, kohë në të cilën subvencionet për prodhimin do të jenë reduktuar në mënyrë graduale dhe do të jenë futur në të njëjtën kohë pagesat për krerë. Dokumenti i ri strategjik gjithashtu parashikon një nivel më të lartë mbështetjeje për investimet kapitale si për sektorin e kulturave bimore ashtu edhe atë të blegtorisë. Artikujt e rinj në shtyllën e dytë të politikave bujqësore në dokumentin e ri strategjik i referohen njohjes së rëndësisë së ZVN-së dhe prezantimit të pagesave shtesë për sipërfaqe për këto zona duke filluar nga viti 2018. Forcimi i masave të lidhura me shërbimet e përgjithshme në bujqësi dhe alokimet më të larta buxhetore për zbatimin e tyre, gjithashtu janë tipare të dokumentit të ri strategjik. Mbështetja për shërbimet këshilluese të bujqësisë, përmirësimi i standardeve të sigurisë së ushqimit, mbrojtja e treguesve gjeografikë dhe mbështetja për organizatat e prodhuesve në sektorin e fermave janë vetëm disa prej masave të shtyllës së tretë që merren në konsideratë në dokumentin e ri strategjik.

Adoptimi i instrumenteve politikë të parashikuar në dokumentin strategjik në RSR pritet të promovojnë rritjen e prodhimit bujqësor, stabilitetin e të ardhurave nga sektori bujqësor dhe konkurueshmërinë e këtij sektori nëpërmjet rritjes së investimeve, marketingut dhe finalizimit të produkteve bujqësore, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, zbutjes së ndikimeve të ndryshimit të klimës, zhvillimit rural të balancuar dhe të integruar dhe mbështetjes sistematike për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe zonave rurale. Buxheti i parashikuar i bujqësisë (nga qeveria e RSR-së) varion midis 48,4 milionë euro në vitin 2016 dhe 58,6 milionë euro në vitin 2020. Raporti i shpërndarjes së planifikuar midis pagesave direkte dhe mbështetjes së zhvillimit rural është në raportin 60 % me 40 %. Megjithatë, në vitin 2016, i cili është viti i parë i zbatimit të strategjisë së re, u mbajt modeli i vjetër i sistemit të mbështetjes dhe kalimi në modelin e ri u shty për një periudhë të mëvonshme.

Për sa i përket QB-së, politika aktuale e bujqësisë po implementohet në bazën e një dokumenti të përgjithshëm strategjik që adreson ekonominë në përgjithësi të kësaj njësie administrative. Megjithatë, strategjia e zhvillimit për sektorin bujqësor që ishte në përdorim deri në vitin 2013, nuk kishte një bazë ligjore ([14]).

Është e rëndësishme të vihet në dukje që në Bosnje dhe Hercegovinë nuk bëhet monitorimi dhe vlerësimii rregullt i politikave bujqësore si pjesë e një cikli modern politikash publike. Për shembull, parlamenti i FBH-së merr një raport të gjelbër vjetor me një përshkrim të detajuar të sektorit agro-ushqimor dhe politikave bujqësore të zbatuara. Një mangësi e rëndësishme e këtyre raporteve është niveli i tyre i pamjaftueshëm i objektivitetit, sepse nuk jep një vlerësim dhe analizë serioze të sektorit bujqësor apo të

([13]) Fillimisht, u parashikua mbështetje vetëm për të imtat në sektorin e blegtorisë; megjithatë, pas konsultimeve publike, edhe nen-sektorë të tjerë blegtorisë u shtuan, të tilla si rritja e dosave, shpendëve, kuajve dhe bletëve.

([14]) Strategjia për bujqësinë, ushqimin dhe zhvillimin rural në QB për periudhën 2008-2013 është zhvilluar, por nuk është dorëzuar për adoptimin zyrtar.

efektivitetit të politikave bujqësore. Raportet përgatiten nga administrata e ministrisë përgjegjëse për bujqësinë pa përfshirjen e komunitetit akademik apo institucioneve relevante të kërkimit. Në rastin e RSR-së, nuk ka asnjë raport vjetor të disponueshëm mbi situatën në bujqësi, dhe asnjë vlerësim të efektivitetit të masave të politikave të zbatuara. Në vend të kësaj, ministria përgjegjëse prodhon disa informacione për qeverinë dhe parlamentin. Komuniteti akademik gjithashtu bën disa analiza rastësore të efekteve të politikave bujqësore dhe rurale në Bosnje e Hercegovinë, por kjo kryesisht bëhet për qëllime akademike (Vaško et al. 2016).

3.3 Zhvillimi i politikave bujqësore

Niveli total i mbështetjes bujqësore tregoi një tendencë në rënie në Bosnje e Hercegovinë gjatë periudhës së studimit 2010-2015, e cila është pasojë e krizës ekonomike dhe e paqëndrueshmërisë politike. Transfertat totale bujqësore në nivel vendi shkuan në 82,2 milionë euro në 2010, ndërsa në vitin 2015 ra me pothuajse një të katërtën në 63,2 milionë euro (Tabela 3.1). Masa e shtyllës së parë (mbështetja për tregun dhe ajo direkte për prodhuesin) përfaqëson pjesën më të madhe të mbështetjes totale në 57 % në vitin 2010, duke u rritur në 91 % në vitin 2015. Pjesa e dytë më e madhe është ajo e mbështetjes për zhvillimin rural, e cila përbënte 37% të mbështetjes totale në vitin 2010 por ra ndjeshëm në 5 % në vitin 2015. Mbështetja për shërbimet e përgjithshme është e një rëndësie të vogël në Bosnje e Hercegovinë, duke përbërë më pak se 6,5 % në mbështetjen totale për periudhën 2010-2015 (Tabela 3.1).

Këto zhvillime të politikave bujqësore në Bosnje e Hercegovinë tregojnë që reduktimi në mbështetjen totale bujqësore nuk pati një efekt të rëndësishëm në mbështetjen direkte për prodhuesin (masa e shtyllës së parë). Në kontrast, mbështetja direkte për prodhuesin u rrit në periudhën 2010-2015. Kjo rritje ishte në kurriz të mbështetjeve të tjera të zhvillimit rural dhe asaj të shërbimeve të përgjithshme, e cila ra ndjeshëm në vitin 2015 krahasuar me vitin 2010. Këto rezultate sugjeruan që mbështetja direkte për prodhuesin është instrumenti i preferuar për të mbështetur sektorin bujqësor në Bosnje e Hercegovinë.

Tabela 3.1. Zhvillimi i mbështetjes buxhetore për bujqësinë në Bosnje e Hercegovinë (milionë euro) 2010-2015.

Niveli administrativ/grupi i masave	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Bosnja dhe Hercegovina						
Masat e mbësh. së tregut & asaj direkte për prodhuesin	46.66	60.76	50.06	60.65	55.2	57.25
Masat për zhvillimit strukturor dhe rural	30.44	8.20	29.62	6.81	9.20	2.88
Masa të përgjithshme të lidhura me bujqësinë	5.09	2.19	3.05	3.59	2.96	3.10
Totali BA	**82.18**	**71.15**	**82.73**	**71.05**	**67.36**	**63.23**
FBH						
Masat e mbësh. së tregut & asaj direkte për prodhuesin	28.71	32.36	24.99	35.54	31.05	33.68
Masa të zhvillimit strukturor dhe rural	9.82	3.98	18.07	0.87	5.71	1.20
Masa të përgjithshme të lidhura me bujqësinë	0.92	0.39	0.51	1.29	0.26	0.21
Totali FBH	**39.45**	**36.74**	**43.57**	**37.70**	**37.02**	**35.10**
RSR						
Masat e mbësh. së tregut & asaj direkte për prodhuesin	15.63	26.36	22.12	22.07	22.43	20.91
Masa të zhvillimit strukturor dhe rural	20.34	3.92	11.17	5.56	3.36	1.50
Masa të përgjithshme të lidhura me bujqësinë	4.17	1.80	2.54	2.30	2.70	2.88
Totali RSR	**40.14**	**32.08**	**35.83**	**29.94**	**28.49**	**25.30**
QB						
Masat e mbësh. së tregut & asaj direkte për prodhuesin	2.31	2.04	2.94	3.04	1.72	2.65
Masa të zhvillimit strukturor dhe rural	0.28	0.29	0.38	0.37	0.12	0.18

Masa të përgjithshme të lidhura me bujqësinë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Totali QB	**2.59**	**2.33**	**3.33**	**3.41**	**1.84**	**2.83**

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Bosnja e Hercegovina).

Në FBH alokimi mesatar vjetor për mbështetjen për sektorin e bujqësisë ishte 38,3 milionë euro në periudhën e studimit 2010-2015. Transferta më e madhe u krye në vitin 2012 (43,6 milionë euro) dhe më e vogla në vitin 2015 (35,1 milionë euro). Luhatjet e mëdha nga viti në vit në nivelin e mbështetjes pa një drejtim të qartë politik tregojnë një prezencë të një mjedisi të politikave bujqësore të papajtueshëm dhe të paqëndrueshëm në FBH.

Masat e shtyllës së parë, pra, masat e mbështetjes së tregut dhe direkte për prodhuesin, përfaqësojnë pjesën më të madhe të mbështetjes totale të buxhetit në FBH, duke variuar midis 25 milionë euro (2013) dhe 35 milionë euro (2014). Pjesa mesatare relative e këtij grupi masash në mbështetjen totale në periudhën 2010-2015 ishte 82 %. Megjithatë, në disa vite përbënte më shumë se 90 % të mbështetjes totale (p.sh. 94 % në vitin 2013; 96 % në vitin 2015). Shuma absolute dhe pjesa relative e mbështetjes së shtyllës së dytë në FBH (masat e zhvillimit strukturor dhe rural) tregojnë qartë që rëndësia e saj është sekondare në aspektin e adresimit të çështjeve të zhvillimit bujqësor. Në periudhën e studimit 2010-2015, mbështetja për shtyllën e dytë luhatej midis 18,1 milionë euro (2012) dhe 0,9 milionë euro (2013) dhe pjesa ndaj mbështetjes totale luhatej midis 41 % (2012) dhe 2 % (2013). Në përgjithësi, mbështetja e zhvillimit rural ka rënë në vitet e fundit, kryesisht si rezultat i krizës ekonomike në vazhdim e sipër. Në fund, mbështetja për shtyllën e tretë përbën pjesën më të vogël të mbështetjes totale, duke përfaqësuar më pak se 3,4 % të mbështetjes totale. Në vlerë absolute, lëvizte midis 0.2 milionë euro (2015) dhe 1,3 milionë euro (2013).

Tendenca negative në nivelet e mbështetjes totale bujqësore është e qartë në RSR në periudhën e studimit 2010-2015. Transfertat totale buxhetore në sektorin agro-ushqimor u reduktuan me pothuajse një të tretën, nga 40,1 milionë euro në vitin 2010 në 25,3 milionë euro në vitin 2015. Kriza ekonomike dhe politike në RSR, e cila u shoqërua me rritje të ngadaltë të PBB-së, dhe një mungesë kronike të fondeve për aktivitetet e zhvillimit janë disa nga arsyet kryesore për reduktimin e vazhdueshëm të mbështetjes drejt bujqësisë. Me përjashtim të vitit 2010, masat e mbështetjes së tregut dhe direkte për prodhuesin mbizotëruan në mbështetjen totale bujqësore. Vlera absolute e mbështetjes së tregut dhe asaj direkte për prodhuesin varion midis 15,6 milionë euro (2010) dhe 26,4 milionë euro (2011) dhe pjesa relative midis 39% (2010) dhe 83% (2015) ([15]). Mbështetja buxhetore për masat e zhvillimit rural ishte e konsiderueshme deri në vitin 2010 (20,3 milionë euro në vitin 2010; 11,2 milionë euro në vitin 2012) dhe përfaqësonte një pjesë të rëndësishme të mbështetjes totale bujqësore (51% në vitin 2010; 31% në vitin 2012). Pas vitit 2012, mbështetja e zhvillimit strukturor dhe rural ra vazhdimisht, duke arritur në 1,5 milionë euro në vitin 2015 (6% të mbështetjes totale bujqësore). Masa kryesore në mbështetjen e zhvillimit rural në RSR është mbështetja për investimet për projektet në fermë dhe për infrastrukturën, ndërkohë që nuk ka mbështetje të alokuar për përmirësimin e mjedisit. Alokimi buxhetor mesatar vjetor për mbështetjen e përgjithshme për bujqësinë në RSR në 2010-2015 shkoi në 2,7 milionë euro, e cila është më e konsiderueshme se në FBH. Pjesa më e madhe e mbështetjes së përgjithshme ishte shperndarë për të forcuar transferimin e njohurive dhe modernizimin e shërbimeve të sektorit bujqësor dhe luhatej midis 1,8 milionë euro (2011) dhe 4,2 milionë euro (2010), që do të thotë, midis 6 % (2011) dhe 11 % (2015) të mbështetjes totale bujqësore.

QB gjithashtu karakterizohet nga një zhvillim i paqëndrueshëm i politikave bujqësore përgjatë periudhës së studimit 2010-2015. Alokimi buxhetor për mbështetjen bujqësore ka lëvizur ndjeshëm çdo vit. Shuma më e madhe e mbështetjes totale bujqësore u

([15]) Për krahasim, studimi nga Mrdajl (2015) vlerësoi që shuma e mbështetjes direkte për prodhuesin për RSR ishte 19,3 milionë euro për periudhën 2000-2013. Analiza shfaqi një pjesë të lartë të pagesave direkte krahasuar me subvencionet e prodhimit, mbështetja direkte për qumështin përfaqësoi pjesën më të madhe (deri në 75 % të mbështetjes direkte totale për prodhuesin).

regjistrua në vitin 2013 (3,4 milionë euro) dhe më e vogla në vitin 2014 (1,8 milionë euro). Masat më të rëndësishme janë në shtyllën e parë të mbështetjes bujqësore (pagesat direkte), duke përfaqësuar më shumë se 85 % të mbështetjes bujqësore totale. Alokimi buxhetor vjetor për zhvillimin rural ishte relativisht i vogël, në më pak se 0,4 milionë euro, që do të thotë vetëm 6-12% të mbështetjes bujqësore totale. QB nuk jep mbështetje për shërbimet e përgjithshme në bujqësi.

3.4 Masat e mbështetjes direkte ndaj prodhuesit

Mbështetja direkte për prodhuesin përfaqëson formën më të rëndësishme të mbështetjes për prodhuesit bujqësorë në Bosnje e Hercegovinë. Përbëhet nga mbështetja direkte bazuar në prodhim, pagesat bazuar në sipërfaqe apo numrin e krerëve dhe pagesat për inpute variabël. Për shkak se njësitë administrative të Bosnje e Hercegovinës kanë autoritetin të adoptojnë dhe implementojnë politikat e tyre bujqësore, skemat e mbështetjes dirkte ndryshojnë midis njësive administrative. Në vitin 2015 kishte 23 skema në FBH([16]), 19 në RSR dhe 20 në QB. Krahasuar me vitin 2010, numri total i skemave të mbështetjes direkte për prodhuesin u rrit në të gjitha njësitë administrative në vitin 2015 (Tabela 3.2).

FBH-ja pësoi numrin më të madh të ndryshimeve në skemat e mbështetjes direkte ndaj prodhuesit në periudhën e studimit 2010-2015, krahasuar me RSR-në dhe QB-në. Një numër i konsiderueshëm i skemave të pagesave të bazuara në prodhimin (7) u zëvendësuan me pagesa për sipërfaqe në FBH; pra, në fakt, i gjithë prodhimi i kulturave bimore u mbështet nga pagesat për sipërfaqe në vitin 2015. Për më tepër, kishte tetë skema pagesash për krerë dhe një skemë për inpute variabël në FBH në vitin 2015. Ndryshe nga FBH-ja, RSR-ja ende kishte një numër të konsiderueshëm të skemave të pagesave bazuar në prodhim (7) dhe më shumë të llojit për krerë (10) në vitin 2015. RSR-ja gjithashtu implementoi një skemë pagese për sipërfaqe dhe një skemë subvencioni inputi. Në vitin 2015, nga një total prej 20 skemash të mbështetjes direkte për prodhuesin në QB, tetë (8) ishin pagesa për sipërfaqe, 11 pagesa për krerët dhe kishte një skemë subvencioni për inputin. Pagesat e këtij viti (2015) nuk ishin shumë të ndryshme krahasuar me vitin 2010. Më shumë detaje për pagesat direkte të zbatuara dhe skemat e subvencionit për inputet në tre njësitë administrative në vitin 2015, me përshkrimin e kritereve të përzgjedhjes për të marrë mbështetjen, paraqiten në Tabelën 3.3.

Tabela 3.2. Numri i pagesave direkte të zbatuara dhe skemat e subvencionit për inputin në Bosnje e Hercegovinë sipas njësive administrative, 2010 dhe 2015.

Lloji i skemave	FBH		RSR		QB	
	2010	2015	2010	2015	2010	2015
Pagesa për prodhim	9	2	7	7	0	0
Pagesa për sipërfaqe	3	12	1	1	6	8
Pagesa për krerë	8	8	9	10	10	11
Subvencione inputi	0	1	0	1	0	1
Totali	21	23	17	19	16	20

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Bosnje e Hercegovinë).

Zhvillimi i mbështetjes direkte totale për prodhuesin në Bosnje e Hercegovinë tregon një paqëndrueshmëri të lartë nga viti në vit, por pati një tendencë në rritje gjatë periudhës së studimit 2010-2015 (Figura 3.1).

Mbështetja direkte totale u rrit nga 41,7 milionë euro në vitin 2010 në 56,6 milionë euro në vitin 2015. Niveli më i lartë i mbështetjes direkte ishte në vitin 2011, kur arriti pothuajse 59 milionë euro. Pagesat direkte (pagesa për sipërfaqe, krerë dhe prodhim) dominuan strukturën e mbështetjes direkte, dukë përbërë rreth 68 % dhe 97 % të totalit. Subvencionet që mbeten u paguan në formën e inputit apo lloje të tjera subvencionesh (Figura 3.1).

([16]) Kjo nuk përfshin skemat e mbështetjes direkte në nivel kantonesh.

Pjesa e subvencioneve të prodhimit ndaj totalit ishte lehtësisht më e lartë sesa për pagesën për sipërfaqe dhe për krerë, ku përfaqësoi midis 51 % dhe 66 % të vlerës totale të pagesave direkte. Me kalimin e kohës, rëndësia e subvencioneve për prodhimin u rrit, që do të thotë, pjesa ndaj totalit të pagesave u rrit nga 53% në vitin 2010 në 66 % në vitin 2015 (Figura 3.2). Mbështetja direkte për prodhuesin lëviz ndjeshëm midis njësive administrative të Bosnje e Hercegovinës, me një diferencë veçanërisht të rëndësishme tek struktura e këtyre mbështetjeve (Figura 3.1 dhe Figura 3.2).

Në mënyrë të ngjashme me rezultatet agregate për Bosnje e Hercegovinën, zhvillimi i mbështetjes direkte totale për prodhuesin në FBH gjithashtu tregon një tendencë lehtësisht në rritje gjatë periudhës së studimit 2010-2015, por me paqëndrueshmëri të lartë nga viti në vit. Vlera varionte midis 23,6 milionë euro (2012) dhe 33,4 milionë euro (2015). Pagesat direkte janë, në fakt, e vetmja formë mbështetjeje për prodhuesit në nivelin e njësive administrative. Ndërsa nga qeveritë kantonale shohim një nivel të moderuar mbështetjeje për inpute variabel (Figura 3.1).

Në vitin 2011 nivelet e mbështetjes direkte për prodhuesin patën një rritje të fortë (me rreth 100%) në RSR. Në vitet në vijim nivelet e kësaj forme mbështetjeje treguan një tendencë negative. Mbështetja direkte u dyfishua nga 13 milionë euro në vitin 2010, në 26,4 milionë euro në vitin 2011, ndjekur nga një rënie në 20,5 milionë euro në vitin 2015. Ndryshe nga FBH, subvencionet për inpute variabël përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të mbështetjes direkte totale në RSR. Në disa vite (2011) subvencionet për inpute variabël përbënin pothuajse gjysmën e mbështetjes direkte totale, edhe pse në periudhën e mbuluar nga ky kapitull, pjesa e tyre ishte më e ulët, duke lëvizur nga 12% në 20 % (figura 3.1).

Tabela 3.3. Skemat e pagesave direkte dhe subvencioneve të inputit të zbatuara në Bosnje e Hercegovinë në vitin 2015 nga njësitë administrative.

Lloji i skemës	Produkti	FBH Vlera dhe kufinjtë e njësisë	RSR Vlera dhe kufinjtë e njësisë	QB Vlera dhe kufinjtë e njësisë
Pagesat për prodhim	Qumësht	0.153 euro/l; min 500 l/muaj (300 l qumësht deleje dhe dhie)	EUR 0.153 euro /l	-
	Grurë (pranverë)	-	EUR 0.026 euro/kg; maks 6 t/ha	-
	Rrepë	-	15 %; min 0.5 ha; maks EUR 5 000 euro/përfitues	-
	Duhan	-	20 %; maks EUR 12 500 euro/ përfitues	-
	Bimë mjekësore	-	15 %; min 0.3 ha; maks EUR 5 000 euro/ përfitues	-
	Farëra	-	15 % dhe 50 %; prodhues të regjistruar	-
	Fidanë	0.18-0.23 euro/copë; numër maksimal fidanësh	-	-
	Fruta	-	15 %; min 500 kg për varietet për shitje	-
Pagesat për sipërfaqe	Gruri	256 euro/ha; min 1 ha; min 3.5 t/ha; maks 200 ha	EUR 128 euro /ha; mbjellje vjeshte; min 1.5 ha dhe 4 t/ha	153 euro/ha; min 1.5 ha
	Misri	153 euro /ha; min 2 ha; maks 400 ha	-	128 euro /ha; min 1.5 ha
	Elbi	179 euro /ha; min 1 ha; min 3 t/ha; maks 100 ha	-	128 euro /ha; min 1.5 ha
	Farërat vajore	205 euro /ha; min 1 ha; min 2 t/ha; maks 250 ha	-	205 euro /ha; min 1.5 ha
	Foragjere mbjellë në vjeshtë	-	-	250 euro /ha; min 1.5 ha
	Farëra (drithëra, farëra vajore)	409 euro /ha; min t/ha; maks ha	-	-
	Farëra Patatesh	665-869 euro /ha; maks 50 ha	-	-
	Duhani	767 euro /ha; min 0.5 ha; maks 50 ha	-	511 euro /ha; min 1.5 ha
	Bimë mjekësore	205 euro /ha; min 1 ha (për treg); maks 50 ha	-	-
	Perime	1 023 euro /ha; min 0.5 ha; min t/ha; maks 20 ha	-	358-7.669 euro /ha; min 0.3 ha (0.02 ha serra)
	Fruta	460 euro /ha; min 2 ha; min 5 t/ha; maks 250 ha	-	256-409 euro /ha; min 1 ha (0.2 ha fryt i butë)
	Rrush	460 euro /ha; min 1 ha; min 8 t/ha; maks 250 ha	-	-
	Ullinj	460 euro /ha; min 1 ha; min 2 t/ha; max 250 ha	-	-
Pagesat për krerë	Lopët me orientim prodhim qumështi	-	-	205 euro / krerë; min 2 krerë; min 2 000 l/lopë
	Sisteme të rritjes natyrore (lopa e vica bashkë)	230 euro / krerë; min 15; maks 1 000 krerë	118 euro / krerë; min 5 krerë; maks 15 000 euro/përfitues	102 euro / krerë
	Mëshqerra mbarështimi	230 euro / krerë; min 2; maks 20 krerë	102 euro / krerë; maks 12 500 euro/ përfitues	153 euro / krerë; min 2 krerë
	Gjedh për mish	230 euro / krerë; min 3; maks 1 000 krerë	61 euro / krerë; min 4 krerë; maks 50 000 euro / përfitues	153 euro / krerë; min 5 krerë
	Dele dhe dhi mbarështimi	18 euro / krerë; min 50 dele (25 dhi); maks 750 krerë	4.60 euro/krerë; min 100 dele(50 dhi); maks 12 500 euro/përfitues	26 euro/ krerë; min 20 dele (10 dhi)
	Dele dhe dhi për mish	-	-	15 euro / krerë; min 20 dele (10 dhi)
	Dosa dhe derra mbarështimi	77 euro / krerë; min 5; maks 150 krerë	20 euro / krerë; min 20 krerë; maks 12 500 euro / përfitues	51 euro / krerë; min 5 krerë
	Derra për mish	31 euro / krerë; min 10; maks 8,700 krerë	7.70 euro / krerë; min 60 krerë; maks 50 000 euro / përfitues	26 euro / krerë; min 20 krerë
	Shpendë të rritur me shtim natyror	0.61 euro / krerë; min 10 000; maks 50 000 shpend	0.36 euro /shpend; min 2,000 shpend; maks 25 000 euro / përfitues	-
	Shpendë për vezë	-	-	0.77 euro /shpend; min 1 500 shpend
	Zogj pule	-	0.03 euro /shpend; 5 000 euro/shpend; maks 50 000 euro/ përfitues	0.10 euro /shpend; min 5 000 shpend
	Mëza mbarështimi	-	205 euro / krerë; racë e pastër	-
	Koshere blete	7.67 euro /koshere; min 20 koshere dhe 10 kg mjaltë/koshere; max 550 kg	2.30 euro /koshere; min 50 koshere; maks 2 500 euro / përfitues	10.23 euro /koshere; min 30 koshere
Subvencione inputi	Sigurim	Maksimumi 50 % e çmimit të sigurimit	-	Maks 70 % e çmimit të sigurimit
	Karburant	-	0.31 euro /l; maks 100 l/ha	-

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Bosnja e Hercegovina).
Maks, maksimum; Min, minimum.

Figura 3.1.Vështrim i përgjithshëm i mbështetjes direkte ndaj prodhuesit në Bosnje e Hercegovinë (milionë euro), 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Bosnja e Hercegovina).

Një variacion i konsiderueshëm nga viti në vit në mbështetjen direkte ndaj prodhuesit bujqësor u vëzhgua edhe në QB gjatë periudhës së studimit 2010-2015. QB aplikon vetëm pagesa direkte. Nuk ka subvencione për prodhim apo input në QB, si në rastin e FBH-së apo RSR-së (Figura 3.1). QB-ja bëri një kalim nga subvencione prodhimi/inputi drejt pagesave direkte bazuar në sipërfaqe/numrin e krerëve në vitin 2009.

Figura 3.2 tregon ndryshime të konsiderueshme në strukturën e pagesave direkte (pagesat për sipërfaqe, krerë dhe prodhim) midis njësive administrative të Bosnje e Hercegovinës. Pagesat e bazuara në prodhim dominojnë në RSR, duke përbërë, mesatarisht, 85 % të pagesave direkte totale gjatë periudhës së studimit 2010-2015. Shumica e subvencioneve për prodhimin kanë shkuar për prodhuesit e qumështit.

Ndryshe nga RSR-ja, FBH-ja ka një shpërndarje më të balancuar të pagesave direkte midis subvencioneve për prodhimin dhe subvencioneve për sipërfaqe/krerë, me një rritje të lehtë në të parën gjatë kalimit të kohës. FBH reformoi sistemin e saj të mbështetjes direkte në vitin 2011, si një rezultat i të cilës pothuajse i gjithë prodhimi i kulturave bimore mbështetet nga pagesat për sipërfaqe në vend të subvencioneve për prodhim. Megjithatë, kjo reformë nuk ka ndikuar strukturën e pagesave direkte në FBH sepse subvencionet e mëdha për prodhim u jepen prodhuesve të qumështit (bazuar në prodhim), e cila drejton strukturën e përgjithshme të pagesave direkte.

Figura 3.2.Përbërja e pagesave direkte për prodhuesit në Bosnje e Hercegovinë, 2010-2015



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Bosnja e Hercegovina).

Prodhimi i qumështit është deri më tani sektori më i mbështetur në Bosnje e Hercegovinë (Figura 3.3). Së bashku me duhanin, prodhimi i qumështit ka marrë mbështetje të vazhdueshme që prej vitit 1997.

Figura 3.3.Përbërja e pagesave direkte ndaj prodhuesit sipas grup-mallrave kryesore në Federatën e Bosnje e Hercegovinës dhe në Republikën Serbe të Bosnjes RSR (%), 2015.



Burimi: baza e të dhënave të MPB-së (Bosnje e Hercegovina)

Sektorë të tjerë që morën pagesa direkte të konsiderueshme në RSR në vitin 2015 përfshijnë frutat (8 %) dhe grurin (8 %). Përveç qumështit, sektorët më të mbështetur në FBH në vitin 2015 ishin gjedhët (12 %), delet dhe dhitë (7 %), gruri (4 %) dhe frutat (3%). Pagesat direkte janë të shpërndara në mënyrë më të barabartë përgjatë sektorëve në QB, me gjedhët (17 %), misri (16 %), derrat (15 %), qumështi (11 %), frutat (9 %) dhe delet e dhitë (7 %) që përbëjnë pjesën më të madhe të pagesave direkte.

Në kontekstin e procesit të integrimit në BE, struktura ekzistuese e pagesave direkte në Bosnje e Hercegovinë, me një pjesë të konsiderueshme subvencionesh të lidhura me prodhimin (p.sh. pagesat e bazuara në prodhim), tregon që ka mangësi në harmonizimin e saj me PPB-në dhe është e nevojshme që në të ardhmen të realizohet dhe harmonizimi me sistemin e subvencioneve të BE-së. Ky problem tregohet dhe në dokumentet e reja strategjike që ka miratuar FBH-ja dhe RSR-ja, në të cilët parashikohet një lëvizje drejt pagesave direkte bazuar në sipërfaqe/krerë; megjithatë, këto plane mbeten për t'u aplikuar në praktikë.

Duhet theksuar që pagesat direkte janë një çështje shumë e ndjeshme dhe shpesh janë arsyet për mosmarreveshje apo fërkime politike dhe revolta sociale në Bosnje e Hercegovinë. Për më tepër, një nga problemet madhore të lidhura me pagesat direkte është vazhdimësia e mangësive në sistemin e zbatimit. Edhe pse Bosnja e Hercegovina ka regjistra të njësive ekonomike bujqësore dhe sisteme të identifikimit të blegtorisë, ende janë larg përputhjes me standardet e BE-së dhe kërkojnë përmirësime të mëtejshme. Aktualisht, problemi më urgjent është mungesa mbikëqyrjes dhe identifikimit të përshtatshëm të tokës bujqësore (sistemi SIPT), e cila pengon shpërndarjen e saktë dhe të drejtë të pagesave direkte dhe e bën këtë skemë të prekshme nga abuzimet.

3.5 Zbatimi i dokumenteve të politikave bujqësore

Strategjia e re afatmesme për zhvillimin e sektorit bujqësor të FBH-së është në fuqi për të dytin vit, gjë e cila lejon që të bëhet fillimisht një vlerësim i zbatimit që do ti bëhet. Dokumentet strategjike për herë të parë janë të bazuara në parimet e politikë-bërjes publike moderne (analiza e situatës, vendosja e qëllimeve, adoptimi i mekanizmave të veprimit, programet e zbatimit, kuadri financiar dhe monitorimi i vlerësimit). Skemat e pagesave direkte duhet të jenë të bazuara në pagesat për sipërfaqe të të gjitha kulturave bimore dhe të jenë në përputhje me PPB-në e BE-së. Disa masa, të tilla si mbështetja për prodhimin e mishit të shpendëve, ishin planifikuar për t'u shfuqizuar, ndërkohë që mbështetja për zhvillimin rural duhet të rregullohej. Për të forcuar kuadrin institucional dhe ligjor dhe për të njehsuar politikat bujqësore të FBH-së me PPB-në u krijua një kuadër financiar realist, dhe një sërë aktivitetesh në planin e veprimit.

Megjithatë, zbatimi aktual ndryshon ndjeshëm nga planet e shprehura në dokumentin strategjik. Qasja e mëparshme e politikë-bërjes bujqësore ka mbetur gjerësisht e njëjtë. Politikat bujqësore ende mbështeten gjerësisht në pagesat e lidhura me prodhimin (coupled) për ti siguruar mbështetje fermerëve, dhe i jep pak rëndësi zhvillimit rural dhe nuk konsideron ndryshimet madhore në financimet për shërbimet e përgjithshme të lidhura me bujqësinë. Praktikisht, nuk u alokuan fonde për zhvillimin rural në FBH në vitin 2015([17]) dhe mbështetja për shpenzimet e përgjithshme kryesisht mbuloi vetëm programet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për fermerët. Edhe pse vlera totale e zërit të planifikuar financiar për pagesat direkte në dokumentin strategjik (33,6 milionë euro) nuk ndryshonte nga ai i zbatuar në vitin 2015 (33,3 milionë euro), ka një mospërputhje të madhe midis strukturave të tyre dhe qasjeve të tyre të përgjithshme. Për shembull, në vend të nëntë skemave të pagesës direkte, si edhe propozuar në dokumentin strategjik, 23 u aplikuan në vitin 2015. Mbështetja për sektorin e qumështit vazhdon të bazohet në sasinë e shitur tek blerësit e ndërmjetëm ([18]) ; ndërkohë që asnjë

([17]) Alokimet e buxhetit për masat e zhvillimit rural nuk ishin planifikuar aspak në vitin 2015 për shkak të një borxhi të konsiderueshëm të qeverisë së FBH-së prodhuesve bujqësorë nga vitet e mëparshëm.

([18]) Një kalim gradual në kombinimin e pagesës për litër (EUR 0,14) dhe pagesës për krerë (EUR 50), si edhe propozuar në dokumentin strategjik, parashikohet të fillojë nga viti 2016.

skemë e pagesës për sipërfaqe nuk u prezantua në vitin 2015. Për më tepër, nuk u vu re asnjë progres i rëndësishëm në kontekstin e harmonizimit legjislativ dhe institucional me PPB-në e BE-së. FBH-ja nuk ka filluar të krijojë SIAK-un dhe mjetet e tjera administrative që nevojiten për zbatimin, kontrollin dhe monitorimin e duhur të pagesave direkte.

Në RSR, gjithashtu u vu re një mospërputhje e madhe midis zbatimit aktual të politikave bujqësore dhe objektivave të planifikuar në planin e ri strategjik 2016-2020. Plani strategjik për 2016-2020 nuk mbulon periudhën e analizuar në këtë kapitull. Megjithatë, alokimi i mbështetjes për vitin 2016 është përshkruar në planin financiar vjetor. Për sa i përket pagesave direkte, plani i ri strategjik parashikon një kalim nga një model i bazuar në subvencione të lidhura me sasinë e prodhimit apo inputeve të përdorura (subvencione prodhimi ose inputi) në një model të bazuar në pagesa për hektarë toke të kultivuar apo për krerë. Ky objektiv duhet ende të vihet në praktikë në RSR, duke qenë se pjesa më e madhe e subvencioneve në vitin 2015 ishin në formën e subvencioneve për prodhimin dhe ky kalim nuk konsiderohet në paketën financiare vjetore për vitin 2016. Për më tepër, miratimi i rregullores mbi bujqësinë dhe zhvillimin rural, që do të sillte zbatimin e këtyre masave politike në përputhje me objektivat e vendosur në dokumentin e ri strategjik u shty. Një shembull i masave politike është alokimi i qëndrueshëm i burimeve financiare. Strategjia që qeveria e RSR-së ka, është që të sigurojë zbatimin eficent të politikave të zhvillimit rural dhe bujqësor para se rregullorja të miratohet nga parlamenti (RSR 2015b).

Më hollësisht, para se të mund të prezantohet ndonjë ndryshim madhor në sistemin e subvencioneve në RSR, duhet të krijohen SIAK-u dhe regjistra të përditësuar për blegtorinë. Përkrah këtyre kërkesave teknike, pengesa për kalimin në skema të reja të pagesave direkte janë nivelet e ulëta të aftësive dhe kapaciteteve të prodhuesve bujqësorë dhe punonjësve civilë për të kuptuar dhe zbatuar me sukses masat e ndryshme politike. Për shembull, kjo pasqyrohet në efikasitetin e dobët të shperndarjes së pagesave tek përfituesit; pagesat zakonisht bëhen disa muaj me vonesë tek përfituesit (p.sh. fermerët), ndryshe nga sa kërkohet.

Kuadri i mëparshëm rregullues i miratuar në vitin 2002, i cili drejton zbatimin e politikave bujqësore (përfshirë zhvillimin rural) është ende efektiv në RSR. Kjo rregullore jep një prag minimumi prej 6 % të buxhetit total të përgjithshëm të RSR-së që i duhet alokuar politikave bujqësore. Me përjashtim të vitit 2010, ky prag nuk u arrit asnjëherë. Qëllimi për të shpërndarë fondet e disponueshme të mbështetjes bujqësore në tre zonat prioritare të mbështetjes së politikave bujqësore (mbështetja direkte për prodhuesin, zhvillimin rural dhe mbështetja e shërbimeve të përgjithshme) nuk u arrit në periudhën e studimit 2010 – 2015 për shkak të krizave të paparashikuara në sektorin bujqësor që devijuan burimet financiare në fusha të tjera (p.sh. për të adresuar katastrofat natyrore apo mos-funksionimin e tregut). Dokumenti strategjik për periudhën 2016-2020 parashikon që alokimi i fondeve për politikat bujqësore të jetë 48,3 milionë euro (6 % e buxhetit të përgjithshëm) në vitin 2016; megjithatë, vetëm 30 milionë euro u rezervuan në planin vjetor për vitin 2016 (RSR 2015a). Kjo nuk do të lejojë financimin dhe zbatimin e të gjitha masave të planifikuara në dokumentin strategjik. Megjithatë, reduktimi i burimeve financiare të disponueshme për politikat bujqësore ndikoi tek mbështetja për investimet dhe zhvillimin rural duke i reduktuar ato, ndërsa tek pagesat direkte ndikimi ishte i vogël.

3.6 Përfundime dhe rekomandime për politikat

Ky kapitull analizon zhvillimin e politikave bujqësore në Bosnje e Hercegovinë në periudhën 2010-2015. Rezultatet tregojnë që politikat bujqësore në Bosnje e Hercegovinë shfaqin një nivel të lartë paqëndrueshmërie dhe nuk përputhen me objektivat e politikave afatmesme të shprehura. Mbështetja për bujqësinë ndryshon ndjeshëm nga viti në vit në periudhën e diskutuar në këtë kapitull dhe kjo është shkaktuar nga kriza e zgjatur ekonomike dhe politike, lobimet politike dhe mungesa e programimit të qartë të masave politike. Ky zhvillim i paqëndrueshëm politikash gjeneron

një mjedis politik të pasigurt për agjentët që operojnë në sektorin bujqësor, i cili mund të ketë implikime të ashpra për rritjen dhe zhvillimin e tij në të ardhmen.

Mbështetja bujqësore vjetore mesatare në Bosnje e Hercegovinë përfaqësonte 75,9 milionë euro dhe ka shfaqur një tendencë në rënie në periudhën 2010-2015. Masat e shtyllës së parë përfaqësuan pjesën më të madhe të mbështetjes totale (mesatarisht 73% të mbështetjes bujqësore totale) në Bosnje e Hercegovinë gjatë së njëjtës periudhë, ndjekur nga mbështetja për zhvillimin rural (19%). Edhe pse mbështetja bujqësore totale ra në 2010-2015 në Bosnje e Hercegovinë, masat e shtyllës së parë u rritën përgjatë të njëjtës periudhë në kurriz të zhvillimit rural dhe mbështetjes së shërbimeve të përgjithshme. Këto rezultate sugjerojnë që mbështetja direkte për prodhuesin është instrumenti i preferuar për të mbështetur sektorin bujqësor në Bosnje e Hercegovinë. Bosnja e Hercegovina implementon një politikë bujqësore shumë heterogjene në tre njësitë e saj administrative (FBH, RSR dhe QB) sepse ato kanë autoritetin për të hartuar, adoptuar dhe zbatuar masat e tyre të politikave. Politikat bujqësore ndryshojnë midis njësive në aspektin e llojeve të masave të zbatuara dhe sektorëve të mbështetur. Të gjitha njësitë administrative raportojnë luhatje nga viti në vit në nivelet e mbështetjes dhe një tendencë negative përgjatë periudhës së studimit 2010-2015.

Mbështetja bujqësore vjetore mesatare ishte 38,3 milionë euro në FBH, 32 milionë euro në RSR dhe 2,7 milionë euro në QB gjatë periudhës së studimit 2010-2015. Lloji mbizotërues i mbështetjes në të tre njësitë administrative është mbështetja direkte për prodhuesin (pagesat direkte dhe subvencionet e inputit), me pjesën më të madhe të mbështetjes bujqësore totale në QB (mesatarisht 90 % në 2010-2015) ndjekur nga FBH (82 %), ndërsa pjesa më e ulët është raportuar në RSR (70 %). Në mënyrë të ngjashme me shifrat agregate për Bosnje e Hercegovinën, mbështetja e zhvillimit rural përfaqëson pjesën e dytë më të madhe të mbështetjes bujqësore totale në njësitë administrative, që përbëjnë mesatarisht midis 10 % të mbështetjes totale në QB dhe 22 % në RSR.

Edhe pse pagesat direkte (pagesat për sipërfaqe, krerë dhe prodhim) janë skema të mbështetjes direkte kryesore që i jepen fermerëve në të tre njësitë administrative të Bosnje e Hercegovinës, struktura e tyre ndryshon ndjeshëm. Pagesat bazuar në prodhim mbizotërojnë në RSR (mesatarisht 85 % e pagesave direkte). Përveç pagesave direkte, një formë e rëndësishme e mbështetjes direkte për prodhuesit në RSR ishte subvencioni i inputit (karburanti). Produkti më i mbështetur në RSR ishte qumështi (70 % e pagesave direkte në vitin 2015). FBH pati një shpërndarje lehtësisht më të barabartë të pagesave direkte midis subvencioneve për input dhe pagesave për sipërfaqe/krerë (60 % : 40 %), ndërsa subvencionet për input përfaqësonin një pjesë të vogël të mbështetjes direkte totale (2,7 % mesatarisht) në periudhën 2010-2015. QB aplikoi vetëm pagesat direkte pra nuk pati zbatim të subvencioneve për prodhim apo input në periudhën e mbuluar në këtë kapitull. Në përgjithësi, këto analiza tregojnë që pagesat e lidhura me prodhimin (coupled) ende luajnë një rol të rëndësishëm në strukturën e mbështetjes bujqësore në Bosnje e Hercegovinë. Kjo kundërshton filozofinë e PPB-së, e cila kryesisht bazohet në pagesat e pa-lidhura me prodhimin (decoupled), duke implikuar që politikat bujqësore të ardhshme do të duhet të përshtaten në rastin e anëtarësimit të Bosnje e Hercegovinës në BE.

FBH-ja dhe RSR-ja kanë adoptuar kuadro strategjikë të rinj për veprimet e ardhshme në sektorin bujqësor dhe zonat rurale, bazuar në parimet dhe elementët e politikë-bërjes publike moderne (analiza të situatës, vendosja e qëllimeve, mekanizmave të veprimit, programet e zbatimit, kuadrot financiarë, monitorimin dhe vlerësimin). Dokumentet e adoptuara dhe konceptet e tyre të orientuara drejt zhvillimit janë bazuar në sfida të përkufizuara qartë me të cilat përballet sektori bujqësor, si nga mjediset e jashtme ashtu dhe ato të brendshme, dhe identifikojnë pikat e forta dhe të dobëta të sektorit, duke lejuar përkufizimin e prioriteteve afatmesme për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe zonave rurale. Të dy dokumentet padyshim kanë theksuar vendosmërinë e Bosnje e Hercegovinës për t'u integruar me BE-në dhe kanë vënë në dukje planet për një njehsim gradual të politikave bujqësore kombëtare me kërkesat e PPB-së.

Vitet e para të zbatimit të dokumenteve strategjike të adoptuar kanë treguar që strukturat politike qeverisëse në FBH dhe RSR nuk kanë treguar vendosmëri dhe gatishmëri të mjaftueshme për të kryer reforma të mëdha që të vënë në jetë prioritetet e theksuara në dokumentet strategjike. Është një paradoks që autoritetet që porositën dokumentet strategjike u kërkuan autorëve të mbanin një qasje të qartë pro BE-së dhe të identifikojnë të gjitha aktivitetet e nevojshme që do të duhet të ndërmerren për të harmonizuar politikat bujqësore me PPB-në. Megjithatë, kur çështja vjen tek zbatimi, reformat e politikave bujqësore kanë dështuar për të vënë në jetë propozimet që ndodheshin në dokumentet strategjike, të paktën për momentin.

4 Kosova*: zhvillimi dhe vlerësimi i politikave bujqësore

Mihone Kerolli-Mustafa*, Ekrem Gjokajdhe Bekim Hoxha****

* Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit Mitrovicë, Kosovë
** Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural të Kosovës

4.1 Hyrje

Kosova* po përballet me sfida vendimtare në zhvillimin e një ekonomie konkurruese dhe reformimin e politikave kombëtare për të qenë më pranë atyre të BE-së. Një fazë e re në marrëdhënien midis BE-së dhe Kosovës* filloi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit në Tetor të vitit 2015. Kjo marrëveshje hapi një mundësi të re për tregtinë e lirë dhe aplikimin e standardeve evropiane në një shumëllojshmëri të gjerë të sektorëve. Kosova* ka përparuar në procesin e zhvillimit të strategjive të saj bujqësore kombëtare, skemave të granteve, mekanizmave të kontrollit, regjistrat dhe statistikat e fermave. Mbështetja e BE-së nëpërmjet Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA) 2014-2020 dhe nëpërmjet ndihmës nga Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit (ATSHI) ka inkurajuar zhvillimin e mëtejshëm të sektorit bujqësor dhe harmonizimin e politikave kombëtare. Megjithatë, ky proces mbetet shumë sfidues në aspektin e arritjes së të gjithë objektivave të vendosura nga MPB-ja.

Sektori bujqësor në Kosovë* luan një rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e mundësive të punësimit dhe gjenerimin e të ardhurave. Në vitin 2015, sektori bujqësor kontribuoi 13,5 % të VSHB-së dhe rreth 27 % të punësimit total, dhe përbënte 12,8 % të vlerës totale të eksportit (baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Kosovë*)).

Zhvillimi i sektorit bujqësor në Kosovë* është i një rëndësie të veçantë në aspektin e përmirësimit të bilancit tregtar, reduktimit të papunësisë dhe rritjes së sigurisë së produkteve ushqimore dhe mbrojtjen e mjedisit. Ky kapitull prezanton situatën aktuale dhe tendencat e fundit për zhvillimin e politikave bujqësore të Kosovës*, me fokus të veçantë në evoluimin e mbështetjes buxhetore për bujqësinë. Burimet kryesore të të dhënave të përdorura në këtë studim janë Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Departamenti i Analizës Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Për një analizë krahasuese të transfertave buxhetore bujqësore, u përdor një model i përbashkët MPB (Rednak et al., 2013). Kjo analizë përfshin periudhën midis viteve 2010-2015.

Seksioni i dytë i këtij kapitulli diskuton strategjitë dhe programet e politikave bujqësore. Zhvillimi i politikave bujqësore adresohet në seksionin e tretë i cili prezanton dhe diskuton transfertat buxhetore drejt bujqësisë për periudhën 2010-2015, përfshirë përbërjen e mbështetjes nga grupi kryesor i politikave. Seksioni i katërt diskuton pagesat direkte dhe karakteristikat e ndryshimet e tyre me kalimin e kohës. Seksioni i pestë jep një vlerësim të përgjithshëm të zhvillimit dhe zbatimit të politikave bujqësore. Seksioni i fundit jep përfundimet dhe rekomandimet për sa i përket çështjeve kryesore të politikave në kontekstin e njehsimit me politikat e BE-së.

4.2 Strategjitë dhe dokumentet programuese për politikat bujqësore

Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural kryen funksionet e saj bazuar në dokumenta politikë kryesorë të cilat janë: Programi për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (PZHBR) 2014-2020 (MBPZHR 2013), Kuadri i Shpenzimeve Afatmesme (2016-2018) (QK 2015) dhe Programi i Reformimit Ekonomik (PRE) 2016-2018 (QK 2016), në të cilët janë shprehur objektiva të detajuar të politikave afatmesme dhe afatgjata, masat kryesore, mjetet monitoruese dhe kostot e zbatimit të politikave. Politikat afatshkurtra janë detajuar në programin kombëtar vjetor për zhvillimin rural dhe bujqësinë dhe më tej, aktivitetet e lidhura me të, në planin vjetor të veprimit.

PZHBR 2014-2020 është bazuar në PZHBR-në e mëparshme për 2007-2013; si e tillë adreson qëllimet afatgjata dhe prioritetet në përputhje me PPB-në e BE-së dhe lidh procesin e programimit me programet e zhvillimit rural shumëvjeçar. Asistenca e IPA II ([19]) mbështet Kosovën* në arritjen e njehsimit me *acquis-in* e BE-së. Kjo ndihmë lehtëson përmirësimet për operatorët e biznesit dhe për prodhuesit e produkteve agro-ushqimore në tregjet rajonalë dhe të BE-së; punësimin dhe gjenerimin e të ardhurave në sektorin agro-ushqimor dhe shërbimet rurale; zhvillimin e trajnimit profesional, arsimimin mbi menaxhimin e fermave dhe kontabilitetit të fermave; dhe adopton masat për të përmirësuar ripërtëritjen nga efektet e ndryshimeve klimatike. Qëllime të tjera të IPA II janë dhënia e mbështetjes teknike për mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe raportimin për të gjithë nën-sektorët e bujqësisë dhe zhvillimit rural në MBPZHR. Në këtë aspekt, PZHBR-ja ndjek katër fusha prioriteti të cilat i janë caktuar nga IPA (KE 2014), nën të cilën u identifikuan masat specifike (Tabela 4.1).

Për periudhën 2014-2016, MBPZHR vendosi të implementonte vetëm disa prej masave të PZHBR-së të prezantuara në Tabelën 4.1, ndërsa në të njëjtën kohë përgatitej për zbatimin e ardhshëm të masave të tjera (M 501, M 401, M 402 dhe masa pilot M 201). Në përgjithësi, programi i PZHBR-së vë në dukje nevojën për të rritur vetë-përmbushjen ushqimore, konkurrueshmërinë e fermave dhe aksesin e lirë në tregjet e BE-së si mundësi të rëndësishme për përmirësimin e të ardhurave të fermerëve në Kosovë*. Rrjedhimisht, zhvillimi i mjeteve të reja të prodhimit dhe konkurrueshmëria e përmirësuar kërkojnë marketing, paketim, cilësi dhe standarde etiketimi të përmirësuara në shtrirjen më të gjerë të sektorit agro-ushqimor. Në vijim të analizës më të fundit të KE-së, vetëm një pjesë shumë e vogël e fermave të Kosovës* dhe kompanive të përpunimit të ushqimit janë konkurruese me BE-në dhe tregjet ndërkombëtare (KE 2015). Shkaku kryesor i konkurrueshmërisë së ulët bujqësore në Kosovë* është mbizotërimi i fermave të vogla dhe të mbijetesës, një shkallë e lartë e fragmentimit të tokës, aksesi i kufizuar për kredi dhe mungesa e njohurive në përdorimin e teknologjive moderne.

Tabela 4.1.PZHBR 2014-2020 e Kosovës*: prioritetet dhe masat e përzgjedhura për zhvillimin rural.

Prioritetet	**Masat**
Përmirësimi i qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së fermave të të gjitha produkteve bujqësore dhe agro-industriale dhe të vazhdojë përafrimin me standardet e BE-së	M 101 Investime në asetet fizike të njësive ekonomike bujqësore M 103 Investime në asetet fizike në përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore
Rikuperimi, mbrojtja dhe përmirësimi i ekosistemeve të lidhura me bujqësinë e pyjet	M 201 Masat agro-mjedisore dhe bujqësia organike M 202 Mbjellja dhe mbrojtja e pyjeve
Promovimi i përfshirjes social-ekonomike, reduktimi i varfërisë dhe zhvillim rural të balancuar të territorit	M 302 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit M 303 Përgatitja dhe zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal - LEADER
Transferimi i risive dhe njohurive në bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural dhe forcimi i kapaciteteve të administrimit publik në zbatimin e programeve të zhvillimit rural	M 401 Trajnim i përmirësuar M 402 Shërbimet e këshillimit M 501 Asistenca teknike
Të tjera	Projektet e ujitjes

Burimi: MBPZHR 2013.

([19]) Aktualisht Kosova po implementon fazën e dytë të IPA-s (IPA II), e cila u miratua në vitin 2014. Faza e parë e implementimit të IPA-s mbuloi periudhën 2007-2013 dhe synoi t'i jepte BE-së mbështetje për zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës* nga një perspektivë e qartë evropiane. Faza e dytë e IPA-s – IPA II – filloi në vitin 2014 dhe do të mbarojë në vitin 2020. Për këtë periudhë, BE është angazhuar me një total prej 645 milionë euro për Kosovën*, nga të cilat 79,7 milionë euro janë planifikuar për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Me asistencën e donatorëve ndërkombëtarë, MBPZHR-ja po punon që të krijojë strukturat e nevojshme në perputhje me politikat e PPB-së dhe IPARD-it, për procesin e integrimit në BE. Në përpjekje për të rritur për-afrimin me PPB-në e BE-së, MBPZHR-ja ka krijuar një Departament për Shërbimet e Këshillimit, i cili jep mbështetje teknike, ekonomike dhe ligjore për prodhuesit bujqësorë (KE 2015). MBPZHR-ja gjithashtu ka vendosur këshilltarë bashkiakë dhe ka hapur qendra të informimit bashkiak në çdo bashki për të siguruar këshillim dhe mbështetje për fermerët dhe për të rritur prodhueshmërinë. MBPZHR-ja gjithashtu ka krijuar një faqe interneti enkas për të dhënë informacion mbi zhvillimin rural dhe për monitorimin e skemave të granteve dhe subvencioneve në perputhje me standardet e BE-së. Për më tepër, autoriteti menaxhues i krijuar vazhdon të zbatojë dhe monitorojë skemat e granteve nëpërmjet Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë. Fermerët të cilët aplikojë për grante dhe subvencione janë regjistruar nëpërmjet Regjistrit të Fermerëve, i cili është një sistem software i cili përdoret nga zyrat bujqësore në bashki dhe menaxhohet nga MBPZHR. Kjo formë e kontrollit të pagesave përfaqëson bazën për reformat dhe për-afrimin me standardet e BE-së.

4.3 Zhvillimi i politikave bujqësore

Gjatë periudhës së studimit, mbështetja buxhetore për bujqësinë në Kosovë* u rrit nga 11,0 milionë euro në vitin 2010, në 59,1 milionë euro në vitin 2015 (Figura 4.1). Në vitin 2015, mbështetja bujqësore totale u rrit më shumë se sa dyfishi i shënuar në vitin 2014, në të cilin ishte 27 milionë euro. Rritja në mbështetjen totale ishte kryesisht rezultat i rritjes së fondeve për mbështetjen direkte ndaj prodhuesit dhe për masat e zhvillimit strukturor dhe rural, ndërsa mbështetja e shërbimeve të përgjithshme mbeti pothuajse e pandryshuar. Mbështetja direkte për prodhuesin, si pjesë e mbështetjes totale, varionte midis 31,9 % dhe 47 % në periudhën 2010-2015, ndjekur nga mbështetja për zhvillimin rural (midis 39 % dhe 47 %) dhe mbështetjes për shërbimet e përgjithshme (midis 6 % dhe 29,1 %).

Figura 4.1. Zhvillimi i mbështetjes buxhetore për bujqësinë në Kosovë*, 2010-2015.



Burime: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Kosovë*).

Masat e mbështetjes direkte për prodhuesin synojnë rritjen e prodhimit bujqësor, rritjen e të ardhurave të fermerëve dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor në lidhje me sektorët e tjerë dhe me importet. Transfertat buxhetore totale për mbështetjen direkte për prodhuesin u rritën nga 3,5 milionë euro në vitin 2010, në 15,2 milionë euro në vitin 2014 dhe në 27,8 milionë euro në vitin 2015. Mbështetja direkte ndaj prodhuesit jepet në formën e pagesave direkte "për sipërfaqe" për kulturat bimore specifike dhe "për krerë" për sektorët e blegtorisë. Subvencionet e inputit u dhanë vetëm për karburantin për korrje deri në vitin 2013. Pagesat për prodhimin janë futur vetëm së

fundmi (në vitin 2013 për fidanët dhe në vitin 2014 për qumështin), por pjesa e tyre e mbështetjes direkte totale mbeti poshtë 4 % në periudhën e studimit.

Politikat e zhvillimit rural gjithashtu luajnë një rol shumë të rëndësishëm në politikat bujqësore të Kosovës*. Kjo është kryesisht për shkak të specifikave të sektorit bujqësor dhe zonave rurale. Masat e zhvillimit rural janë të fokusuara në forcimin e konkurrueshmërisë së prodhuesve të produkteve ushqimore nëpërmjet mbështetjes së investimeve në prodhimin bujqësor dhe industritë e përpunimit, si dhe nëpërmjet prezantimit të standardeve ndërkombëtare të sigurisë së ushqimit. Në vitin 2015 shpenzimet buxhetore për zbatimin e masave të zhvillimit rural shkuan në 27,8 milionë euro, duke u rritur nga 4,3 milionë euro në krahasim me vlerën e vitit 2010. Në periudhën 2010-2015, kjo mbështetje përfaqësoi rreth 43 % të mbështetjes buxhetore totale për bujqësinë. Mbështetja e zhvillimit strukturor dhe rural synon kryesisht rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit agro-ushqimor. Financimi për masat që synojnë të mbështesin ekonominë dhe popullsinë rurale është rritur në vitet e fundit (nga rreth 0.1 milion euro në 2010, në rreth 1,8 milionë euro në 2015), por pjesa e këtyre fondeve krahasuar me fondet totale për zhvillimin rural, mbetet e ulët, poshtë 10 % (6,5 % në 2015). Këto fonde u dhanë për të ndërtuar kapacitet lokale (LEADER) dhe, prej vitit 2014, për të mbështetur shumëllojshmërinë e fermave dhe aktiviteteve alternative në zonat rurale. Mbështetja për përmirësimin e infrastrukturës rurale dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë rurale nuk është zbatuar për shkak të kufizimeve buxhetore.

Në shumicën e viteve të periudhës së studimit, pjesa më e madhe e buxhetit për përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor i ka shkuar masave që synojnë ristrukturimin e fermës (Figura 4.2). Kjo mbështetje për ristrukturimin e fermave u implementua kryesisht në formën e mbështetjes së investimeve të fokusuara në një sërë nën-sektorësh bujqësorë (si rritja e shpendëve, fruta-perimet, vreshtaria, prodhimi i qumështit dhe mishit, drithërat dhe mjalti) dhe në forma të tjera të ristrukturimit të fermës. Në vitin 2015 fondet për investimet në fermë u rritën ndjeshëm (nga rreth 3,5 milionë euro në 2010, në 21 milionë euro në 2015), duke treguar ndërgjegjësimin e arritur tek politikë-bërësit për nevojën për të rritur prodhueshmërinë e fermës dhe cilësinë e produkteve bujqësore dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë dhe konkurrueshmërinë.

Figura 4.2. Zhvillimi i mbështetjes buxhetore për përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor në Kosovë*, 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Kosovë*).

Mbështetja për ristrukturimin e sektorit agro-ushqimor është e fokusuar në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. Mbështetja synon të përmirësojë përdorimin e produkteve bujqësore nëpërmjet përmirësimit të prodhimeve me vlerë më të lartë; krijimin e qendrave të grumbullimit, paketimit dhe magazinimit; dhe futjen e sistemit të

menaxhimit të sigurisë ushqimore të "Analizës së Riskut dhe Pikave Kritike të Kontrollit" (ARPKK) me synimin për të përmbushur kërkesat e BE-së (Miftari dhe Hoxhaj 2014). Fondet e ekzekutuara për ristrukturimin e sektorit agro-ushqimor nuk ndryshuan ndjeshëm gjatë viteve të periudhës së studiuar (Figura 4.2). Ndërkohë, shumë projekte që u implementuan nën këtë masë gjithashtu u mbështetën nga fonde të BE-së.

Mbështetja e ristrukturimit të pyjeve kryesisht u fokusua në pyllëzim dhe ishte në fuqi deri në vitin 2013. Pas vitit 2013 nuk u alokuan më fonde për këtë masë për shkak të kufizimeve buxhetore.

Mbështetja për shërbimet e përgjithshme ishte relativisht e qëndrueshme gjatë gjithë periudhës së studimit 2010-2015, me një mesatare prej 3 milionë euro. Më shumë se 95 % e kësaj mbështetjeje u alokua për të financuar përmirësimin e standardeve të sigurisë ushqimore (shërbimet veterinare e fitosanitare) dhe vetëm një pjesë e vogël e fondeve u dha për asistencë teknike dhe trajnim profesional për të përmbushur nevojat e zhvillimit rural (0,1 milion euro). Trajnimi profesional i fermerëve është i një rëndësie të madhe për të përshpejtuar zhvillimin bujqësor në Kosovë*. Megjithatë, buxheti për këto aktivitete është ende relativisht i vogël, duke marrë parasysh numrin relativisht të madh të fermerëve të interesuar që të regjistrohen në programe të specializuar trajnimi dhe studimi.

4.4 Pagesat direkte

Numri i instrumenteve të pagesave direkte u rrit ndjeshëm në Kosovë* midis viteve 2010 dhe 2015 (Tabela 4.2). Në vitin 2010, pagesat direkte u dhanë për nën-sektorin e prodhimit të rrushit për verë (pagesat për hektarë të vreshtave), dhe për nën-sektorin e rritjes së lopëve orientuar për prodhim qumështi, deleve dhe dhive (pagesa për krerë). Në vitet në vijim, një sërë instrumentesh të rinj u futën në veprim, të cilët në vitin 2015 numri i tyre u rrit në 15. Në vitin 2015 mbështetja direkte në formën e pagesave për sipërfaqe u dha për fermerë që merreshin me kultivimin e grurit, farës së grurit, misrit, farërave vajore, perimeve, frutave (skemë e futur në vitin 2015) dhe rrushit për verë. Për lopët e orientuara për prodhim qumështi, delet dhe dhitë, gjedhët e therur (skemë e futur në vitin 2015), kosheret e bletëve, dosat dhe shpendët për vezë, mbështetja direkte u dha në formën e pagesave për krerë dhe për frutat dhe fidanët e vreshtave dhe qumështin në formën e pagesës për sasitë e shitura. Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve varen nga skema e mbështetjes (nga 0,1 ha për vreshtat në 5 ha për farën e grurit dhe nga një krerë gjedhi në 2 000 shpendë për vezë) dhe mbahen të qëndrueshme me kalimin e kohës.

Table 4.2. Skemat e pagesave direkte të zbatuara në Kosovë* sipas llojit dhe sektorit, 2010-2015.

Skemat e pagesave direkte	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Pagesat bazuar në sipërfaqe (euro/ha)						
Vreshtat (prodhim rrushi për verë; min (0,1 ha)([a])	250	500	-	500;200	1 000;300	1 000;300
Gruri (min 2 ha)	-	100	100	125	125	150
Misri (min 1 ha)	-	-	100	100	100	150
Fara e grurit (min 5 ha)	-	-	100	200	225	250
Farërat vajore (min 1 ha)	-	-	100	100	100	150
Perimet kultivuar në zonë fushore të hapur (min 0.5 ha)	-	-	-	-	300	300
Drufrutorët (pemët frutore: min 0.5 ha; frut i butë: min 0.2 ha)	-	-	-	-	-	400
Pagesat bazuar në nr e blegtorisë (euro/krerë, koshere)						
Lopët për prodhim qumështi (min 5 lopë)	30	30	50	50	50	70
Dele & dhi (në prodhimin e qumështit; min 30 & 20 krerë)	10	10	10	10	10	15
Koshere (min 30, maks 500 koshere)	-	-	10	10	10	10
Shpendë për vezë (min 2 000 pula)([a])	-	-	-	0.5; 0.4	0.5;0.4	0.5-0.3
Dosa mbarështimi (min 2 dosa)	-	-	-	-	20	20
Gjedhë të therur (bazuar në faturë)	-	-	-	-	-	30
Pagesa bazuar në prodhim (euro/kg, copë)						
Fidanët e frutave dhe hardhive (min 0.5 ha; min 5 000	-	-	-	0.2	0.1-0.2	0.1-0.2

fidanë)(ª)						
Mbeshtetje në cmim për cilësinë e qumështit (për qumësht lope, dele dhe dhie të dërguar në baxho; min 1 500 l/tremujor)(ª)	-	-	-	-	0.02-0.06	0.02-0.06

(ª) Pagesa për njësi ndryshon në varësi të zonës së hardhisë (pagesa për vreshta), numrit të krerëve në fermë (pagesa për pulë për prodhim vezësh), vëllimi i prodhimit (pagesat për fidanë), apo për kategori të cilësisë së qumështit (pagesa premium).

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Kosovë*)

Mbështetja direkte totale është rritur që prej vitit 2010, si rezultat i futjes së instrumenteve të reja të pagesave direkte, si dhe futjes së normave rritëse të pagesave për disa nga instrumentet (veçanërisht për lopët për prodhim qumështi dhe grurin). Në përgjithësi, pagesat direkte për prodhimin e kulturave bimore janë rritur më shpejt sesa ato për prodhimin shtazor (Tabela 4.3). Përveç vitit 2010, pjesa më e madhe e pagesave direkte për kultura bimore u alokua për sektorët e drithërave. Në vitin 2015, pagesat për sipërfaqe për grurin, farën e grurit dhe misrit së bashku, përbënin dy të tretat (2/3) e pagesave direkte totale të kulturave bimore dhe 37 % të pagesave direkte totale. Pagesat direkte për blegtorinë dominoheshin nga mbështetja e lidhur me nën-produktet e qumështit (produkte bulmeti) (pagesat për lopët për prodhim qumështi dhe delet e dhitë dhe shpërblesat "premium-et" e qumështit), të cilat në vitin 2015 përbënin rreth 80 % të pagesave totale për sektorin e blegtorisë dhe 36 % të pagesave direkte totale.

Table 4.3. Shpenzimet buxhetore për pagesat direkte dhe subvencionet e inputit në Kosovë* (milionë euro), 2010-2015.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Pagesat direkte për sektorin e kulturave bimore	**1.115**	**4.295**	**4.956**	**7.911**	**10.370**	**15.621**
Pagesa për sipërfaqe për grurin	-	3.207	3.795	5.772	5.555	6.850
Pagesa për sipërfaqe për farën e grurit	-	-	0.025	0.064	0.107	0.154
Pagesa për sipërfaqe për misrin	-	-	0.575	0.943	1.269	3.245
Pagesa për sipërfaqe për bimët vajore	-	-	0.074	0.041	0.045	0.020
Pagesa për sipërfaqe për vreshtat	0.703	0.699	-	0.995	2.291	1.836
Pagesa për sipërfaqe për drufrutorët	-	-	-	-	-	0.645
Pagesa për sipërfaqe për perimet në fushë të hapur	-	-	-	-	1.027	2.697
Pagesat për prodhim për fidanët e frutave dhe hardhive (copë)	-	-	-	0.096	0.076	0.174
Pagesat për input për karburantin për korrje	0.412	0.389	0.487	-	-	-
Pagesat direkte për sektorët e blegtorisë	**2.384**	**1.413**	**3.791**	**3.981**	**4.938**	**12.181**
Pagesat për krerë për lopët për prodhim qumështi	1.108	0.794	2.105	2.095	2.212	5.416
Pagesat për krerë për delet dhe dhitë për prodhim qumështi	1.276	0.619	1.327	1.151	1.210	3.594
Pagesat për prodhim për qumështin (për litër)	-	-	-	-	0.500	0.869
Pagesat për bletërritësit (për koshere)	-	-	0.359	0.494	0.778	1.842
Pagesa për krerë për shpendët për vezë	-	-	-	0.240	0.232	0.441
Pagesa për krerë për dosat e mbarështimit	-	-	-	-	0.006	0.016
Pagesat për krerë për gjedhët e therur	-	-	-	-	-	0.003
Totali	**3.500**	**5.707**	**8.747**	**11.893**	**15.307**	**27.802**

Burimi: baza e të dhënave të MPB-së (Kosovë).

Pagesat e palidhura me prodhimin (decoupled) nuk aplikohen në Kosovë*, edhe pse janë instrumenti kryesor politik në PPB. Lëvizja drejt një skeme pagese të palidhur me prodhimin (decoupled) mbetet një detyrë sfiduese për Kosovën* dhe kjo duhet të implementohet para vitit 2020, si edhe shprehur në PZHBR 2014-2020. Në përgjithësi, mbështetja direkte për fermën është e rëndësishme për bujqësinë në Kosovë* sepse sektori mbizotërohet nga fermat e vogla. Megjithatë, ende ka presione strukturore të kufizuara në këtë sektor dhe mbështetja bujqësore nuk është hartuar që të jetë e mjaftueshme për të stimuluar rritjen e madhesisë së fermës. Fermerëve të Kosovës* ende u mungon një mënyrë efikase e adoptimit të teknologjisë moderne dhe përvetësimit

të mjeteve financiare për të ndërmarrë investime në fermë që të arrijnë standardet ndërkombëtare të cilësisë ushqimore dhe të bëhen konkurues në tregjet ndërkombëtare (Miftari et al., 2016).

4.5 Zbatimi i dokumenteve të politikave bujqësore

Zhvillimi i përgjithshëm i politikave bujqësore në Kosovë* drejtohet kryesisht nga perspektiva e integrimit në BE. Sic është përshkruar dhe më sipër, bujqësia është një nga sektorët më kërkues e kompleks në zhvillimin e politikave të Kosovës* dhe në *acquis communitaire* të BE-së. Kjo ka vendosur kërkesa shtesë në procesin e ecjes drejt përafrimit me PPB-në e BE-së dhe nevojitet më shumë përpjekje që të sigurohet asistencë shtesë nga donatorët ndërkombëtarë për të krijuar kuadrin e nevojshëm rregullues dhe politikat që do të promovonin zhvillimin e një sektori bujqësor konkurrues. Duke njohur këtë rëndësi, qeveria ka rritur ndjeshëm mbështetjen buxhetore për këtë sektor, veçanërisht që nga viti 2015.

Mbështetja buxhetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Kosovë* është përshkruar në detaje në PZHBR 2007-2013 dhe në PZHBR 2014-2020. Të dy dokumentet janë përgatitur duke ndjekur të njëjtin kuadër me të PPB-së. Megjithatë, fondet për zbatimin e PZHBR-së, veçanërisht për periudhën 2007-2013, ishin shumë të kufizuara dhe prioritetet u lidhën kryesisht me prodhimin bujqësor dhe konkurueshmërinë e sektorit. Politikat bujqësore ishin të fokusuara në masat e mbështetjes direkte që korespondojnë ngushtë me masat e shtyllës së parë të PPB-së dhe masat e mbështetjes së zhvillimit rural të ngjashme me masat e shtyllës së dytë. Edhe pse mbështetja nderkombëtare u rrit në vitin 2015, ekziston nevoja që të sigurohet zbatimi i duhur i skemave të mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural, si pjesë e PZHBR 2014-2020 për të shfrytëzuar produktivitetin e sektorit dhe riorientuar politikat drejt bujqësisë organike, diversifikimit të aktiviteteve dhe transferimit të risive dhe njohurive drejt bujqësisë.

Sipas PRE-së 2016-2018, Kosova* shperndan 50% të buxhetit total drejt subvencioneve dhe granteve për masat në shtyllën e parë. Përveç kësaj, qeveria gjithashtu vazhdon të mbështesë projekte investimesh (masa nën shtyllën e dytë) në vitin 2016. Një arritje e rëndësishme është shënuar në përmirësimin e infrastrukturës bujqësore për agro-biznesin nëpërmjet reformave të planifikuara në PRE 2016, në të cilat politika demonstron angazhim për të mbështetur fermerët duke rritur sasinë e mbulimit që shkon për sistemin vaditës (në 40 % të tokës së punuar), zhvilluar infrastrukturën e tregut të shumicës të produkteve bujqësore, zgjerimin e numrit të njësive testuese laboratorike dhe krijimin e Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor. MBPZHR dha 2,1 milionë euro për projektet e ujitjes në sektorin publik në vitin 2016 dhe 1 milion euro tjetër është planifikuar si pjesë e programit të zhvillimit rural të vitit 2016 që synon fermat private. Megjithatë, zbatimi i këtyre masave do të jetë sfidues, sepse kërkon më shumë burime financiare nga sa janë alokuar nga buxheti kombëtar për të mbështetur programin dhe aktivitetet e tjera, të tilla si ato të lidhura me konsolidimin e tokës bujqësore. Sipas Planit të Veprimit të Strategjisë mbi Konsolidimin e Tokës 2010-2020, zbatimi i këtyre masave do të vazhdojë në periudhën 2016-2018 dhe më shumë se 0,5 milionë euro në vit do të alokohen nga buxheti kombëtar (MBPZHR 2010). Konsolidimi i tokës, si pjesë integrale e politikave të zhvillimit rural, do të ndihmonte fermerët në promovimin e zhvillimit të tregut të tokës dhe në përmirësimin e aksesit në kredi dhe investime.

Në përgjithësi Kosova* ka qenë e suksesshme në përgatitjen për zbatimin e masave kryesore të IPARD II. Megjithatë, ngritja apo rritja e mëtejshme e zhvillimit bujqësor dhe rural, sic mund të përmendim: forcimi i produktivitetit të fermerëve, arritja e konsolidimit të tokës, mbështetja e bujqësisë organike, mbrojtja e mjedisit dhe e pyjeve dhe rritja e asistencës teknike, do të kërkojë reforma shtesë.

4.6 Përfundime dhe rekomandime për politikat

Zhvillimi i politikave bujqësore në Kosovë* gjatë viteve të fundit ka demonstruar një hap të rëndësishëm drejt harmonizimit me politikat bujqësore të BE-së. Tiparet thelbësore të

zhvillimit të politikave bujqësore në Kosovë* mund të përmblidhen në vëzhgimet kryesore që vijojnë:

— Kosova* ka adoptuar dokumente strategjikë afatgjatë dhe afatmesëm, të tillë si PZHBR 2014-2020, Kuadri Afatmesëm i Shpenzimeve, Programi Kombëtar Vjetor për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe PRE, në të cilat u vendosën objektivat dhe prioritetet për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Në përgjithësi, zhvillimi i dokumenteve të programimit dhe harmonizimi me parimet e BE-së tregon një farë progresi, kryesisht në objektivat e forcimit të institucioneve përgjegjëse dhe rritjes së buxhetit.

— Në përgjithësi, financimi për bujqësinë dhe zhvillimin rural është rritur në vitet e fundit, por ende është shumë i ulët për të zbatuar të gjitha masat e synuara nga PZHBR-ja.

— Alokimi i mbështetjes bujqësore totale është ndarë pothuajse barabartë midis mbështetjes direkte për prodhuesin (shtylla e parë) dhe mbështetjes për zhvillimin rural (shtylla e dytë).

— Mbështetja direkte për prodhuesin u rrit ndjeshëm në periudhën 2010-2015 dhe u shpernda kryesisht në formën e pagesave për sipërfaqe të lidhura me kultivimin e kulturave bimore specifike ose të lidhura me pagesat për krerë të bëra për blegtorinë.

— Pjesa më e madhe e mbështetjes së zhvillimit rural shkoi për përmirësimin e konkurueshmërisë së sektorit bujqësor. Megjithatë, nuk pati fonde për të mbështetur përmirësimet e infrastrukturës rurale, mirëmbajtjen e trashëgimisë rurale apo përmirësimin e mjedisit.

— Mbështetja për shërbimet e përgjithshme përfaqëson pjesën më të vogël të buxhetit bujqësor total dhe kryesisht shkon për të mbështetur përmirësimin e standardeve të sigurisë ushqimore.

Për më tepër, fermerët në Kosovë* përballen me kufizime të shumta, të tilla si nivelet e larta të fragmentimit të tokës, teknologji të vjetra në ferma, mungesë e diversifikimit të prodhimit, kapacitet i kufizuar për rritjen dhe mjete të kufizuara të mbështetjes teknike. Edhe pse janë krijuar reforma të ndryshme për të adresuar disa prej këtyre çështjeve (p.sh. konsolidimi i tokës, sistemet e vaditjes dhe bujqësia organike), nevojiten përpjekje të mëtejshme për të forcuar zbatimin e tyre dhe për të përmirësuar konkurueshmërinë e sektorit bujqësor në Kosovë*. Fusha të tjera të neglizhuara që kanë nevojë për veprime të mëtejshme politikash janë mbrojtja e mjedisit dhe zonat më pak të favorshme (zonat kodrinore, etj.) të cilat janë zonat me prodhueshmëri të reduktuar. Për më tepër, sistemi i mbështetjes direkte për fermën aktualisht mbështetet ekskluzivisht në pagesat e lidhura me prodhimin (coupled) të kulturave bimore dhe ajo për krerë, ndërsa hyrja në BE do të kërkojë adaptimin e skemave të pagesave të palidhura me prodhimin (decoupled). Megjithatë, zhvillimi i politikave bujqësore në këtë drejtim do të varet nga kapacitetet administrative dhe njerëzore dhe disponueshmëria e burimeve financiare.

5 IRJ e Maqedonisë: zhvillimi dhe vlerësimi i politikave bujqësore

Dragi Dimitrievski, Ana Kotevskadhe Ivana Janeska Stamenkovska

Universiteti St. Cyril dhe Methodius i Shkupit, Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit

5.1 Hyrje dhe qasja

Politikëbërja është një çështje komplekse, veçanërisht kur fokusohet në një sektor kompleks të tillë si ai agro-ushqimor. Numri i madh i nën-sektorëve, objektivat e ndryshëm dhe sjellja e shumicës së të interesuarve, theksojnë rolet e shumta të politikave bujqësore në këtë sektor, të cilat duhet të rregullojnë dhe mbështesin sjelljen e aktorëve dhe të përmbushin nevojat e prodhuesve dhe komunitetit në përgjithësi. Dimensionet e shumta që duhet të mbulohen kërkojnë qasje të shumta. Rrjedhimisht, nuk ka një zgjidhje të vetme politike dhe shpesh është e nevojshme të bëhen zgjedhje dhe kompromise (Cochran et al., 2009). Analiza e politikave përdoret si një mjet për të zgjedhur opsionet midis alternativave dhe për të matur ndikimin e politikave.

Bujqësia është bërë më e rëndësishme për politikë-bërësit që prej fillimit të procesit të pranimit në BE për IRJ të Maqedonisë. Ky sektor i rëndësishëm për ekonominë e IRJ eMaqedonisë, përbën 11,1 % të VSHB-së totale. Pjesa e të punësuarve në sektorin bujqësor ndaj totalit të të punësuarve përbente 18,5 % në vitin 2014 (baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (IRJ e Maqedonisë)).

Gjatë procesit të liberalizimit të tregut dhe harmonizimit me PPB-në e BE-së, politika bujqësore në IRJ të Maqedonisë ka qenë nën reforma të vazhdueshme. Rrjedhimisht, shtrirja, forma dhe lloji i transfertave buxhetore për bujqësinë kanë qenë nën reforma konstante.

Qëllimi i këtij kapitulli është të përshkruajë dhe vlerësojë zhvillimin e politikave bujqësore në IRJ të Maqedonisë. Të dhënat e përdorura për ngritjen e bazës së të dhënave të MPB-së u morën nga Agjencia për Mbështetje Financiare e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe deklarata financiare përfundimtare e buxhetit të IRJ të Maqedonisë. Meqenëse u krijuan ndryshime më sistematike dhe strukturore për përshtatjen e politikave bujqësore kombëtare drejt PPB-së me ligjin e miratuar në vitin 2010, baza e të dhënave të MPB-së e IRJ të Maqedonisë mbulon periudhën 2010-2015([20]).

Seksioni i dytë i këtij kapitulli jep një përshkrim të shkurtër të dokumenteve kryesore strategjike dhe programuese që përkufizojnë politikat bujqësore në IRJ të Maqedonisë. Seksioni i tretë mbulon zhvillimin e përgjithshëm të politikave bujqësore në vend. Vëmendje e veçantë i është dhënë pagesave direkte si instrumenti kryesor i politikave bujqësore kombëtare, si edhe përshkruar në kapitullin e katërt. Seksioni i fundit jep përfundimet dhe rekomandimet mbi politikat.

5.2 Strategjitë dhe dokumentet programuese për politikat bujqësore

Prioritetet e zhvillimit të politikave bujqësore në IRJ të Maqedonisë janë përkufizuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (SKZHBR). Kuadri kryesor ligjor që përcakton zbatimin e politikave bujqësore në IRJ të Maqedonisë është vendosur në Ligjin mbi Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (MBPEU 2010), plotësuar nga 12 ligje të tjera për të rregulluar çështjet specifike (Dimitrievski et al., 2014). Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU) është autoriteti përgjegjës për planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave bujqësore dhe instrumenteve të tyre, ndërsa

([20]) Të dhënat jepen në bazë vjetore në vijim të implementimit të pagesave.

Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural është përgjegjëse për zbatimin dhe kontrollin e tyre.

SKZHBR përkufizon objektivat afatmesëm dhe afatgjatë të politikave bujqësore (për një periudhë prej 7 vitesh). Prioritetet e politikave bujqësore, si edhe përkufizuar në SKZHBR 2014-2020, janë që të promovojnë ristrukturimin dhe modernizimin e sektorit agro-ushqimor, rregullimin e tregut, kushtet socio-ekonomike në zonat rurale, njohuritë dhe kapitalin njerëzor në bujqësi, standardet e sigurisë ushqimore dhe burimet natyrore (MBPEU 2014). SKZHBR 2014-2020 gjithashtu identifikon disa aspekte të njehsimeve të mëtejshme të politikave bujqësore në IRJ të Maqedonisë me PPB-në. Ato i referohen mbështetjes në rritje për zhvillimin rural, "ndarja" graduale e pagesave direkte, duke rritur masat agro-mjedisore, duke mbështetur fermerët e rinj, krijimin e kooperativave dhe integrimin vertikal, prezantuar bordet drejtuese të tregut dhe standardeve minimale të cilësisë, zbutur ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe përmirësuar menaxhimin e mbeturinave dhe efikasitetin e energjisë.

SKZHBR vendos një cikël programimi 3 vjeçar për planifikimin buxhetor të politikave bujqësore. Cikli aktual mbulon periudhën 2013-2017 dhe parashikon një buxhet vjetor prej 150 milionë euro (MBPEU 2013). Transfertat buxhetore vjetore për bujqësinë janë të përkufizuara në programet vjetore dhe përcaktohen më vete për bujqësinë (kryesisht pagesa direkte) dhe zhvillimin rural (përfshirë modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë). Fondet për politikat bujqësore kryesisht vijnë nga buxheti kombëtar dhe plotësohen nga programi IPARD i BE-së dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë.

Pagesat direkte janë instrumenti kryesor i politikave që përdoret për të mbështetur sektorin bujqësor. Si edhe në PPB, janë të kushtëzuara nga kërkesat e përputhshmërisë që duhen përmbushur të cilat përfaqësojnë një set standardesh bazë të cilët janë të lidhura me mjedisin, sigurinë ushqimore dhe shëndetin e kafshëve dhe të bimëve. Politikat e zhvillimit rural janë më pak të rëndësishme sesa pagesat direkte në aspektin e alokimit buxhetor, por janë më të përputhshme me PPB-në. Politikat e zhvillimit rural kanë katër fusha prioriteti që përkojnë me katër shtyllat e PPB-së 2007-2013. SKZHBR parashikon përshtatje të mëtejshme të politikave bujqësore drejt PPB-së deri sa të bëhen plotësisht të njehsuara kur IRJ e Maqedonisë të marrë anëtarësimin e plotë në BE (MBPEU 2014). Megjithatë, ende nuk është dhënë një hark kohor specifik për njehsimin e plotë të politikave bujqësore me PPB-në. Progresi i ngadaltë i integrimit me BE-në për IRJ të Maqedonisë, i kombinuar me miratimin e reformave të PPB-së, kontribuon në mungesën e një harku kohor të qartë në SKZHBR për njehsimin e plotë të politikave dhe i bën kushtet që duhen përmbushur, objektiva në lëvizje.

Procesi i zhvillimit dhe i hartimit të politikave bujqësore në IRJ të Maqedonisë duket se nuk ndjek politikë-bërjen e bazuar në evidenca, e cila mbështetet në monitorimin e rregullt të zbatimit të politikave, arritjen e qëllimeve dhe vlerësimin e ndikimeve. Edhe pse evidencat tregojnë që instrumente politikë të tillë po implementohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë disa viteve me radhë, pjesa më e madhe e këtyre instrumenteve janë subjekt i ndryshimeve të rregullta që kontribuojnë në paqëndrueshmërinë e politikave bujqësore në vend ([21]). Për më tepër, ka mos-përputhje midis instrumenteve politikë që aktualisht po implementohen dhe alokimeve të tyre buxhetore të planifikuara. Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këtë mospërputhje janë (1) procedurat administrative kërkuese që shkaktojnë shtyrjen e pagesave deri në vitin kalendarik vijues; (2) ndryshime dhe përshtatje të shpeshta të kuadrit rregullues; dhe (3) eksperienca, arsimimi dhe aftësitë relativisht të kufizuara të fermerëve, të cilat i pengojnë ata që të kuptojnë kërkesat administrative komplekse për grumbullimin dhe përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

[21]Për shembull, në vitin 2015, janë bërë 10 ndryshime në kuadrin rregullator të politikës bujqësore; Disa ndryshime ishin të vogla, ndërsa të tjerat ishin thelbësore, përmendim këtu ndryshimin e kritereve të alokimit ose miratimit të instrumenteve të reja.

5.3 Zhvillimi i politikave bujqësore

Transfertat buxhetore vjetore mesatare për bujqësinë shkuan afërisht 90 milionë euro në periudhën 2010-2015 (Figura 5.1). Edhe pse Programi Kombëtar për Politikat Bujqësore 2013-2017 parashikon transferta vjetore prej 150 milionë euro në periudhën 2015-2017 (MBPEU 2013), transfertat buxhetore aktuale arritën një pikë prej 129 milionë euro në 2014, ndërsa arritën vetëm 73 milionë euro në 2015. Meqenëse disa transferta janë programuar përgjatë një periudhe disa vjeçare, niveli i ulët i transfertave vënë re në vitin 2015, është gjithashtu rezultat i niveleve më të larta të realizimit në vitet e mëparshëm.

Nuk janë vënë re ndryshime të rëndësishme në strukturën e mbështetjes me kalimin e kohës; masat e mbështetjes direkte për prodhuesit dominojnë (60% në 2015), ndërsa masat e zhvillimit rural dhe mbështetja e përgjithshme për bujqësinë përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të buxhetit bujqësor total (28 % dhe 12 % në vitin 2015, respektivisht).

Figura 5.1. Mbështetja buxhetore për bujqësinë në IRJ të Maqedonisë, 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (IRJ e Maqedonisë).

Mbështetja direkte për prodhuesin përfaqësoi rreth 44 milionë euro në vitin 2015, e cila tregon rënie në krahasim me vitin 2010, vit në të cilin vlera ishte rreth 66 milionë euro. Pagesa direkte është masa kryesore në mbështetjen direkte për prodhuesin. Pjesa e pagesave direkte nga mbështetja direkte totale për prodhuesin ra lehtësisht në periudhën 2010-2015, nga 99% në vitin 2010, në 86 % në vitin 2015 (Figura 5.2).

Figura 5.2. Shpenzimet buxhetore për mbështetjen direkte për prodhuesin në IRJ të Maqedonisë, 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (IRJ e Maqedonisë).

Pagesat direkte janë shpërndarë për njësi të produktit bujqësor (duhani dhe qumështi ishin përfituesit kryesorë në vitin 2015), për hektarë të tokës së kultivuar (rrushi dhe farërat vajore ishin përfituesit kryesorë për vitin 2015) ose për krerë të blegtorisë. Përfituesit janë të kushtëzuar nga respektimi i kërkesave të ndër-pajtueshmërisë të ngjashme me PPB-në. Subvencionet e inputit janë të papërfillshme, duke përfaqësuar më pak se 1 milionë euro në vit dhe masat e mbështetjes së tregut nuk janë aplikuar në IRJ të Maqedonisë.

Fondet vjetore të alokuara për zhvillimin rural variojnë midis 10 milionë euro dhe 21 milionë euro në periudhën 2010-2015. Mbështetja e zhvillimit rural kryesisht synon rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor (Figura 5.3) dhe kryesisht shperndahet si investime në fermë apo mbështetje për ristrukturimin e sektorit agro-ushqimor (e para ishte më e ulët në vitin 2015). Mbështetja për ekonominë rurale (infrastruktura bazë, rinovimi i shërbimeve dhe zonave rurale) është rritur që prej vitit 2013, ndërsa masat për mbështetjen e agro-mjedisit dhe zonave më pak të favorizuara janë ndjeshëm më pak të mirë-përfaqësuara në strukturën e politikave të zhvillimit rural në vitin 2014 dhe veçanërisht në 2015.

Figura 5.3. Shpenzimet buxhetore për masat e zhvillimit strukturor dhe rural në IRJ të Maqedonisë, 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (IRJ e Maqedonisë).

Zhvillimi rural gjithashtu mbështetet nga fondet e IPARD-it të BE-së. Në vitin 2015, fondet e IPARD-it përfaqësuan rreth 10 % të transfertave buxhetore totale për masat e zhvillimit strukturor dhe rural. Edhe pse thirrja e parë për aplikime për masat e IPARD-it u bë në Dhjetor 2009, pagesat e para u bënë në vitin 2011; kjo sepse zbatimi i programit u fillua me vonesë dhe u desh një kohë e gjatë për të përpunuar dhe vlerësuar aplikimet (koha mesatare u vlerësua të ishte 18 muaj).

Mbështetja e përgjithshme për bujqësinë përfshin vetëm të dhëna nga buxhetet e MBPEU-së, Agjencisë Kombëtare të Ekstensionit, Shërbimit Kombëtar Hidro-Meteorologjik, Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinare dhe Agjencisë së Pagesave. Baza e të dhënave duhet të përmirësohet më tej duke përfshirë të dhëna mbi aktivitetet dhe projektet që janë financuar nga institucionet e tjera kombëtare apo donatorë të huaj.

Shpenzimet në mbështetjen e përgjithshme ishin rreth 7,3 milionë euro në vitin 2010, duke u rritur në rreth 8,8 milionë euro në vitin 2015. Pjesa më e madhe e mbështetjes së përgjithshme totale shkoi për sigurinë ushqimore (rreth 70 %), ndërsa shërbimet e ekstensionit, kërkimit dhe zhvillimit dhe masa të tjera të përgjithshme morën vetëm rreth 15 % secili mesatarisht në periudhën 2010-2015 (Figura 5.4).

Figura 5.4.Mbështetja e përgjithshme për bujqësinë në IRJ të Maqedonisë, 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (IRJ e Maqedonisë).

5.4 Mbështetja direkte ndaj prodhuesit

Pagesat direkte janë instrumenti kryesor i përdorur nga IRJ e Maqedonisë për të mbështetur sektorin bujqësor. Një gamë e gjerë e masave të mbështetjes direkte u implementuan në periudhën 2010-2015. Disa prej masave ishin të pranishme gjatë të gjithë periudhës, pa ndryshime të ndjeshme, dhe disa u përshtatën çdo vit, ndërsa të tjera u implementuan herë pas here.

Instrumenti kryesor i mbështetjes direkte në vitin 2015 përfaqësoi pagesat për sipërfaqe të dhëna për kultivimin e disa kulturave bimore të specifikuara. Pagesat për sipërfaqe u dhanë për të gjitha bimët e arave me përjashtim të duhanit. Disa bimë arash morën pagesë shtesë si edhe pagesën bazë për sipërfaqe, të tilla bimë si drithërat e prodhuara nga disa fara të certifikuara, luledielli, orizi dhe kulturat bimore foragjere.

Pagesat për sipërfaqe për perimet varionin në varësi të varietetit dhe llojit të prodhimit (në disa vite janë në varësi të statusit ligjor të prodhuesit). Sektorët e frutave dhe verës janë të mbështetura me pagesa për sipërfaqen e kultivuar me pemishte dhe vreshta. Pagesat për sipërfaqe gjithashtu alokohen për prodhimin e farërave dhe prodhimin e kërmijve (Tabela 5.1).

Pagesat për krerë jepen për rritjen e gjedhëve, bagëtive të imëta (të gjitha kategoritë), dosat, kosheret dimërore, viçat prodhuar me mbjellje artificiale, pasardhësit femra të gjedhëve, deleve dhe dhive dhe për krerë të therura (gjedhë, derra, zogj përm mish dhe pulave për vezë).

Pagesat për prodhim janë më pak të rëndësishme në aspektin e numrave, por janë të rëndësishme në aspektin e përmasave të transfertave buxhetore. Pagesat për prodhim alokohen për nën-sektorë si drithërat, duhani dhe qumështi (lope, dele dhe dhie), frutat dhe perimet për përpunim, zogjtë njëditorë për mbarështim ose zogave për vezë dhe prodhimin e farërave dhe fidanëve.

Pagesat direkte gjithashtu u alokuan për prodhimin organik dhe për ZVN. Këto pagesa ishin të pranishme gjatë gjithë periudhës së analizës dhe janë shtuar si përqindje në rritje ndaj pagesave direkte (sipërfaqe apo krerë) për mallin përkatës. Prodhimi organik u mbështet me 30 % shtesë sic ndodhi edhe me mbështetjen e programuar për prodhimin jo organik. Në vitin 2015 kjo mbështetje u rrit dhe varionte nga 30 % për bimët e arave, në 50 % për blegtorinë, 70 % për drufrutorët dhe vreshtat në 100 % për prodhimin e perimeve. Mbështetja për ZVN jepet si një pagesë shtesë që shkon në 15 % të mbështetjes së programuar në përgjithësi.

Subvencionet për inputet u dhanë vetëm për siguracionet (60 % të çmimit të sigurimit) në vitin 2015.

Tabel 5.1.Vështrim i përgjithshëm i pagesave direkte të zbatuara në IRJ të Maqedonisë,2015

	Pagesat për prodhim	**Pagesat për sipërfaqe, krerë ose koshere**
Bimet e arave		Bimët e arave përjashtuar duhanin (130 euro/ha)
		Pagesa shtesë për drithërat nga fara të certifikuara (65 euro/ha)
		Pagesa shtesë për orizin dhe luledielli (49 euro/ha)
		Pagesa shtesë për kulturat foragjere (16 euro/ha)
	Fara të drithërave bazë (0.130-0.325 euro/kg)	Farëra të certifikuara (243-974 euro/ha)
Duhani	Duhani me gjethe të vogël (0.974 euro/kg)	
Perimet	Pagesa shtesë për perimet për përpunim (0.024-0.106 euro/kg)	Perimet në fushë të hapur (97-487 euro/ha)
		Perimet në kushte të kontrolluara (1,461 euro/ha)
Frutat	Pagesa shtesë për frutat për përpunim (0.032 euro/kg)	Drufrutorët (243-536 euro/ha), luleshtrydhet në kushte të kontrolluara (1 461 euro/ha)
Hardhitë		Vreshta (649 euro/ha)
Fidanët	Fidanë fruta, hardhi, perime dhe lule (0.081-1.136 euro/p)	
Qumështi	Qumësht lope, dele dhe dhie (0.057 euro/l)	
Gjedhët		Rritja e gjedhit – të gjitha kategoritë (45.4 euro/krerë)
		Pagesa shtesë për viçat me mbjellje artificiale (19.5 euro/krerë)
		Pagesa shtesë për gjedhë femra të moshës 12-24 muaj (24.3 euro/krerë)
		Gjedhë të therura – të gjitha kategoritë (24.3 euro/krerë)
		Pagesa shtesë për gjedhë të reja të therura nga kopetë e prodhimit të mishit (48.7 euro/krerë)
Derrat		Dosat për mbarështim (16.2 euro/krerë)
		Derra të therur (16.2 euro/krerë)
Dele dhe dhi		Rritja e deleve dhe dhive – të gjitha kategoritë (16.2 euro/krerë)
		Pagesa shtesë për qengja të vegjël femër dhe keca të mbajtur për mbarështim (11.4 euro/krerë)
Shpendët	Zogjtë për rritje (0.032-0.065 euro/p)	Pula dhe zogj të therur (0.4-0.5 euro/krerë)
Bagëti të tjera		Kosheret (9.7 euro/koshere dimërore)
		Pagesa shtesë për mbarështim seleksionues të bletës mbretëreshë (16,2 euro/koshere)
		Rritja e strucit (27,6 euro/krerë)
		Kultivim kërmilli (1 461 euro/ha)

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (IRJ e Maqedonisë).

Blerja e krerëve për mbarështim gjithashtu u subvencionua brenda skemës së mbështetjes direkte, edhe pse kjo mbështetje mund të kategorizohet si mbështetje e ristrukturimit në fermë e cila zakonisht jepet nëpërmjet programit të zhvillimit rural. Qëllimi i kësaj mbështetjeje ishte të përmirësonte strukturën rracore në sektorin e blegtorisë dhe rrjedhimisht të rrisë produktivitetin e sektorit. Kjo mbështetje u dha në 3 vitet e para të periudhës së studimit si një subvencion për inputin, ose si 50 % të vlerës së investimit, ose si një pagesë për krerë që lëvizte midis 70 euro/krerë dhe 650 euro/krerë, në varësi të llojit dhe racës së gjësë së gjallë.

5.5 Përfundime dhe rekomandime për politikat

Politikat bujqësore gjithmonë e më shumë janë bërë një çështje thelbësore në axhendën politike të IRJ të Maqedonisë si rezultat i vazhdimësisë së procesit të integrimit në BE. Gjatë viteve të fundit, një numër rregulloresh, strategjish dhe programesh janë miratuar të cilat synojnë që të njehsojnë gradualisht mbështetjen bujqësore sipas PPB-së. Ashtu si në PPB, politikat bujqësore të IRJ të Maqedonisë adoptuan qasjen me dy shtylla të PPB-së – mbështetjen direkte për prodhuesin dhe masat mbështetjes për zhvillimin rural.

Transfertat buxhetore të bujqësisë kanë pasur një strukturë të qëndrueshme në vitet e fundit. Mbështetja direkte ndaj prodhuesit është instrumenti mbizotërues, duke përbërë pjesën më të madhe të buxhetit total (rreth 70 % mesatarisht në periudhën 2010-2015). Mbështetja është e shpërndarë në formën e pagesave të lidhura me prodhimin (coupled) të dhëna për njësi prodhimi, për sipërfaqe të kultivuara të kulturave bimore specifike apo për krerë të blegtorisë. Mbështetja e zhvillimit rural përfaqëson një pjesë më të vogël të mbështetjes bujqësore totale (18 % mesatarisht në periudhën 2010-2015). Zhvillimi rural kryesisht është i fokusuar në rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor dhe kryesisht shpërndahet si investime në fermë apo mbështetje për ristrukturimin e sektorit agro-ushqimor, edhe pse një pjesë e vogël shkon për zhvillimin e infrastrukturës lokale, rinovimit të shërbimeve dhe të zonave rurale. Vetëm një pjesë e vogël e totalit të mbështetjes bujqësore (rreth 10 % mesatarisht) shkon si mbështetje e përgjithshme për bujqësinë për të përmirësuar sigurinë ushqimore dhe shërbimet e ekstensionit.

Politikat bujqësore në IRJ të Maqedonisë shoqërohen me përshtatje të shpeshta të instrumenteve politike dhe devijimin e zbatimit të tyre në lidhje me planet afatgjata të shprehura. Kemi identifikuar disa faktorë që shkaktojnë devijime midis mbështetjes buxhetore të zbatuar dhe të planifikuar, të tilla si procedura administrative kërkuese, ndryshime të shpeshta të rregulloreve themelore dhe nivelet e ulëta të eksperiencës dhe aftësive të fermerëve në aplikimin e mbështetjes publike. Literatura e politikave publike identifikon faktorë të tjerë që ndikojnë në zbatimin e mbështetjes buxhetore, të tilla si qartësia e ligjeve përkatëse, niveli i aftësive së administrimit të politikave, disponueshmëria e burimeve financiare, kushtet socio-ekonomike të grupeve të ndikuar nga mbështetja dhe vëmendja e mediave (Cochran et al., 2009). Secila prej këtyre çështjeve meriton vëmendje të veçantë në procesin e vlerësimit të zbatimit të politikave bujqësore në IRJ të Maqedonisë për të përmirësuar efektivitetin e administrimit publik dhe zbatimin e instrumenteve të miratuara.

Zbatimi dhe projektimi i politikave bujqësore pengohen nga interesat kontradiktore të palëvë të interesuara; diferencat në nivelet relative të ndikimit të tyre (grupeve të interesit) mund të përcaktojë drejtimin e zhvillimit të politikave bujqësore. Kjo ndërlikohet nga fakti që programet e mbështetjes bujqësore të adoptuar rregullohen nga kuadro ligjorë kompleks që janë subjekt i ndryshimeve të shpeshta, të cilët, midis të tjerash, komplikojnë punën e administratës publike. Kjo çështje është e ngutshme sepse "sa më kompleks procesi i zbatimit, ka më shumë gjasa që qëllimi i politikave të shtrembërohet ose të humbasë" (Cochran et al., 2009, f. 10). Aftësitë dhe burimet e administratës publike janë, si rezultat, në tension të vazhdueshëm; të cilat duhet të ndërtojnë kapacitetin e tyre për të mirëmbajtur dhe përditësuar vazhdimisht procedurat administrative në përgjigje të kuadrit ligjor që ndryshon. Kushtet socio-ekonomike nuk mund të adresohen lehtësisht; kërkimi konfirmon rëndësinë e qëndrimeve të fermerëve dhe nevojën për akses më të mirë ndaj kredive dhe financave për të siguruar sukses në politikat e zhvillimit rural në IRJ të Maqedonisë (Kotevska and Martinovska Stojceska 2015). Vëmendja e mediave mbi mbështetjen bujqësore gjithashtu duhet të merret parasysh për të përmirësuar ndërgjegjësimin e të interesuarve, në mënyrë që ata të jenë të vetëdijshëm për përfitimet që mund të marrin si rezultat i politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural, për shembull, të ardhura më të larta, cilësi e përmirësuar e ushqimit, mbrojtje e mjedisit dhe ruajtje e jetesës në zonat rurale.

SKZHBR 2014-2020 identifikon disa prej këtyre kërkesave për të siguruar përmirësimin e zbatimit të politikave bujqësore. Megjithatë, mungon një vlerësim sistematik i ndikimeve

të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të politikave dhe një vlerësim *ex ante* kur prezantohen masa të reja. Për të arritur objektivat e shprehur nevojitet angazhim dhe një vullnet i qartë politik.

6 Mali i Zi: zhvillimi dhe vlerësimi i politikave bujqësore

Aleksandra Martinovic*, Darko Konjevicdhe Mirsad Spahic****

* Universiteti i Donja Gorica, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Sigurisë Ushqimore dhe Ekologjisë, Mali i Zi
** Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Mali i Zi

6.1 Hyrje dhe qasje

Sektori i bujqësisë, meqënëse njihet si një nga tre sektorët më të rëndësishëm në rrugën e zhvillimit të Malit të Zi tërheq vëmendjen e politikë-bërësve, të interesuarve dhe publikut të gjerë. Ky sektor, në Malin e Zi ka nevojë për përmirësime të ndjeshme në shumë fusha për të promovuar rritjen e përgjithshme ekonomike dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori dhe zonave rurale në veçanti, si edhe për tu para-përgatitur për anëtarësimin e ardhshëm në BE. Rrjedhimisht, politikat bujqësore luajnë një rol kryesor.

Mali i Zi është vend kandidat për anëtarësim në BE, i cili në vitin 2014 plotësoi një proces shqyrtimi duke përfshirë të gjithë legjislacionin kombëtar. Qëllimi i procesit të shqyrtimit ishte të vlerësonte legjislacionin kombëtar në aspektin e *acquis communautaire* të BE-së. Procesi rezultoi në një përmbledhje të përgatitjeve të Malit të Zi në lidhje me secilin prej 35 kapitujt e *acquis* dhe kushtet për t'u përmbushur për anëtarësim të plotë në BE.

Sfidat kryesore të identifikuara në kapitullin e bujqësisë dhe zhvillimit rural (Kapitulli 11) i referohen tranzicionit të legjislacionit dhe krijimit të kapaciteteve të nevojshme administrative dhe krijimit të strukturave të kontrollit. Kjo solli krijimin e strukturave të kontrollit dhe sistemeve institucionalë në Malin e Zi që janë të nevojshme për të patur një zbatim efikas të politikave bujqësore në perputhje me rregullat e BE-së. Mali i Zi së fundmi miratoi një strategji për zhvillimin afatmesëm të bujqësisë dhe zonave rurale për 2015-2020, e cila përkufizon një plan veprimi, rrugën dhe drejtimet për zhvillimin e ardhshëm të politikave bujqësore.

Objektivi i këtij kapitulli është të paraqesë gjendjen aktuale të reformave të politikave bujqësore dhe zhvillimin e mbështetjes buxhetore për bujqësinë në periudhën 2010-2015 në Malin e Zi. Burimet kryesore të informimit dhe të dhënave të përdorura në këtë kapitull u morën nga kuadri ligjor kombëtar, zyra kombëtare e statistikave, dokumente kombëtare zyrtare dhe burime të tjera të rëndësishme. Kuantifikimi i mbështetjes buxhetore u bë duke përdorur versionin malazez të bazës së të dhënave të MPB-së (baza e të dhënave të MPB-së (Mali i Zi) 2016). Kjo bazë të dhënash mbulon periudhën 2010 deri në vitin 2015. Është e rëndësishme të vihet në dukje fakti që mbështetja e raportuar për sektorin e bujqësisë është bazuar në masat dhe fondet buxhetore (buxheti bujqësor) të planifikuara dhe jo në realizimin (ekzekutimin) e tyre. Të dhënat mbi transfertat buxhetore të ekzekutuara nuk janë të disponueshme për publikun dhe rrjedhimisht nuk mund të përdoren për këtë analizë.

6.2 Strategjitë dhe dokumentet programuese për politikat bujqësore

Dokumentet kryesore që përcaktojnë politikat e qeverisë për pranimin e Malit të Zi në BE janë të shprehura në Programin për Anëtarësimin në BE për 2014-2018 (MF 2013a). Ky program pranimi përcakton strategjinë për adoptimin e *acquis communautaire*, duke forcuar kështu kapacitetet administrative dhe zhvillimin institucional. Direktivat e Zhvillimit të Malit të Zi për 2013-2016, miratuar nga qeveria në Mars 2013 (MF 2013b), shprehin një vizion zhvillimi socio-ekonomik, duke përfshirë investimet dhe masat e zhvillimit që nevojiten për të arritur një rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Programi identifikon tre sektorë parësorë që u vunë në shënjestër për

veprime të politikave për të promovuar zhvillimin ekonomik të Malit të Zi: turizmi, energjia dhe zhvillimi bujqësor dhe rural.

Këto dokumente formuan bazën për përcaktimin e Strategjisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zonave Rurale për 2015-2020, adoptuar në vitin 2015 (MBZHR 2015a). Megjithatë, Mali i Zi e kishte filluar tashmë procesin e njehsimit gradual të politikave të tij bujqësore me atë të BE-së në vitin 2007, në vijimësi të Strategjisë Bujqësore dhe Zhvillimit Rural për 2007-2013 (MARD 2006). Kjo strategji e mëparshme krijoi strukturën e masave të politikave bujqësore, të cilat ishin ndarë në ato të lidhura me ndërhyrjet në treg (përfshirë pagesat direkte), programin e zhvillimit rural dhe mbështetjen e shërbimeve të përgjithshme. Kjo strukturë e përgjithshme e politikave bujqësore është ruajtur deri më tani. Vetëm disa elementë u modifikuan për t'u përputhur më shumë me kërkesat dhe praktikat e BE-së.

Strategjia e re për 2015-2020 (MBZHR 2015a) dhe plani i veprimit për zbatimin e saj (MBZHR 2015b) ishin parakushte për hapjen e kapitullit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në procesin e pranimit në BE. Strategjia e re përfaqëson bazën për harmonizimin e politikave kombëtare me PPB-në. Harmonizimi me standardet e BE-së parashikohet të vazhdojë paralelisht me përafrimin e kuadrit ligjor, ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe kapacitetin e sektorit privat për të përmbushur kërkesat e PPB-së. Për të arritur këtë vizion, objektivat strategjikë për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale për 2015-2020 janë përkufizuar si vijon (MBZHR 2015b):

— zhvillimi i një sektori agro-ushqimor efektiv, novator dhe të qëndrueshëm që siguron produkte ushqimore të shëndetshme, me cilësi të lartë dhe të specializuar, bazuar në vlerën e shtuar të burimeve natyrore dhe metodave tradicionale të prodhimit dhe që të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e tregut të BE-së dhe ti rezistojë presionit të konkurencës;

— zhvillimi i aktiviteteve ekonomike dhe krijimi i vendeve të reja të punës në zonat rurale, me theks të veçantë në zhvillimin e sektorit të turizmit (shërbime cilësore) dhe një zinxhir furnizimi të shkurtër në prodhimin e produkteve dhe shërbimeve me cilësi të lartë, ndërkohë që në të njëjtën kohë, respektohet trashëgimia kulturore dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore;

— promovimi i zhvillimit rural dhe shërbimeve sociale për të përmirësuar cilësinë e jetës në zonat rurale dhe për të reduktuar migrimin e popullsisë rurale drejt zonave urbane.

6.3 Zhvillimi i politikave bujqësore

Zbatimi i politikave bujqësore planifikohet nëpërmjet buxhetit bujqësor vjetor, i cili propozohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), së bashku me një numër dokumentesh, rregulloresh e ligjesh të tjera që janë të nevojshëm për funksionimine tyre. Buxheti bujqësor përmban një numër masash dhe skemash stimulimi që janë në përputhje me prioritetet e politikave bujqësore, sikundër shprehur në strategjinë për 2015-2020 dhe planin e veprimit për zbatimin e këtij buxheti. (MBZHR 2015a, 2015b) ([22]).

Figura 6.1 tregon zhvillimin/ecurinë e mbështetjes për bujqësinë dhe strukturën e saj në Malin e Zi për periudhën 2010-2015. Sic u tha dhe më lart, këto shifra bazohen në shpenzimet buxhetore të planifikuara për politikat bujqësore dhe jo mbi pagesat aktualisht të disbursuara (ekzekutuara) për masa politike specifike.

Kur analizojmë mbështetjen bujqësore të planifikuar totale, vihet re një tendencë pozitive përgjatë periudhës së studimit 2010-2015. Një rritje më e konsiderueshme në mbështetjen bujqësore të planifikuar u vu re në vitin 2011 dhe vitin 2015. Mbështetja

([22]) Vini re që implementimi i politikave bujqësore në Malin e Zi është mbështetur nga një numër projektesh të financuar nga BE dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë. Projektet më të rëndësishme të financuara nga fondet e BE-së në këtë aspekt, ishin fushat e ngritjes së kapaciteteve, zhvillimit rural, forcimit të kapaciteteve laboratorike dhe sigurisë ushqimore.

bujqësore totale u rrit nga 14,6 milionë euro në vitin 2010, në 20 milionë euro në vitin 2015 (d.m.th. me 37 %)([23]). Mbështetja është përgjithësisht e shpërndarë në mënyrë të barabartë midis mbështetjes së tregut dhe asaj direkte për prodhuesin, masave të zhvillimit rural dhe mbështetjes për shërbime të përgjithshme (Figura 6.1).

Figura 6.1. Mbështetja buxhetore për bujqësinë në Malin e Zi (fonde të planifikuara), 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Mali i Zi).

Përqindja e mbështetjes së tregut dhe asaj direkte për prodhuesin në mbështetjen bujqësore totale varionte midis 27 % dhe 36,2 % në periudhën 2010-2015. Në vitin 2015, kjo përqindje ishte më e ulët, ishte 27 % (5,4 milionë euro) e mbështetjes bujqësore totale. Pagesat direkte, në vitin 2015 përbënin 90 % të totalit të mbeshtetjes së tregut dhe asaj direkte për prodhuesin (80 % në vitin 2010). Pagesat direkte përfshijnë pagesat e lidhura me prodhimin (coupled), (sektori i produkteve bulmetore), pagesat për sipërfaqe të kultivuara (pagesa për sipërfaqe për bimët e arave dhe duhanin) dhe pagesa për numrat e krerëve (sektorët e blegtorisë) (Figura 6.2).

Figura 6.2. Mbështetja e tregut dhe ajo direkte për prodhuesin në Malin e Zi (fonde të planifikuara), 2010-2015.

([23]) Rritja e mbështetjes per sektorin bujqësor për 2015-ën mund t'i atribuohet, në një masë të gjerë, realizimit të projektit MIDAS (Zhvillimi institucional dhe Fuqizimi Bujqesor i Malit të Zi). Për shembull, rreth 22 % e mbeshtetjes se tregut dhe mbështetjes direkte për prodhuesit dhe masave të zhvillimit rural u financuan nga projekti MIDAS në vitin 2015 (MIDAS 2014).



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Mali i Zi).

Masat e zhvillimit rural ndahen në tre shtylla: konkurrueshmëria, menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore (rritja e gjelbër) dhe diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale. Shpenzimet e planifikuara totale për masat e zhvillimit rural u dyfishuan në vitin 2015 në raport me vitin 2010, nga 4,5 milionë euro, në 8,5 milionë euro (Figura 6.3). Kjo masë përfaqësonte 43 % të mbështetjes bujqësore totale në vitin 2015.

Figura 6.3. Mbështetja e zhvillimit strukturor dhe rural në Malin e Zi (fonde të planifikuara), 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Mali i Zi).

Masat që synonin forcimin e konkurrueshmërisë së sektorit agro-ushqimor morën shumicën e fondeve brenda mbështetjes së zhvillimit rural, duke përbërë rreth 88 % të fondeve totale për zhvillimin rural në vitin 2015. Synimi i këtyre masave është të mbështesë investimet në fermë, investimet në sektorin e përpunimit të ushqimit, përmirësimet e cilësisë së produktit dhe promovimin e produkteve bujqësore,

kooperativat e fermave dhe shoqatat kombëtare të fermerëve. Në vitin 2015, një pjesë prej mbështetjes së investimeve në fermë u dha në përputhje me kërkesat e IPARD-it, me qëllimin për të përgatitur zbatimin e ardhshëm të fondeve IPARD.

Masat për menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore mbështesin prodhimin organik dhe përdorimin e qëndrueshëm të kullotave malore. Në vitin 2015 ato përfaqësonin 5 % të totalit të mbështetjes për zhvillimin rural.

Në fund, masat për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale promovojnë përmirësimin e kushteve socio-ekonomike, cilësinë e jetës, krijimin e mundësive të punësimit, rinovimin dhe zhvillimin e zonave rurale (duke përfshirë ndërtimin e infrastrukturës). Ky grup masash përfaqësoi 7 % të totalit të mbështetjes së zhvillimit rural në vitin 2015 (Figura 6.3).

Sipas strategjisë për periudhën 2015-2020 (MBZHR 2015a) dhe planit të saj të veprimit (MBZHR 2015b), autoriteti aktual që menaxhon IPARD-in do të marrë përsipër funksionin e autoritetit për të menaxhuar gjithashtu dhe programin e zhvillimit rural. Pra, rolet e menaxhimit dhe zbatimit do të zhvendosen nga MBZHR drejt autoritetit menaxhues të IPARD. Afati kohor që tregon për këtë zhvendosje të politikave të zhvillimit rural përmblidhet në Tabelën 6.1.

Tabela 6.1. Afati kohor tregues për përshtatjen e politikave të zhvillimit rural në Malin e Zi me sistemin IPARD.

Aktiviteti	Struktura përgjegjëse	Afatikohor
Zbatimi i programit IPARD-like	Drejtoria e MBZHR për Zhvillimin Rural (Agjencia IPARD)	Gjatë vitit 2015
Zbatimi i programit IPARD II, me prezantim në etapa të masave të ndryshme	Drejtoria e MBZHR për Zhvillimin Rural (Agjencia IPARD) dhe Drejtoria e MBZHR për Zhvillimin Rural (Autoriteti Menaxhues i IPARD)	2016 e në vazhdim
Ndryshimi i legjislacionit me fokus përafrimin e tij me *acquis* e BE-së	Drejtoria e MBZHR për Zhvillimin Rural (Autoriteti Menaxhues i IPARD)— propozim	Çdo vit pas2016
Qeveria të miratojë një vendim mbi strukturën operacionale për zbatimin e programit të zhvillimit rural	Drejtoria e MBZHR për Zhvillimin Rural (Autoriteti Menaxhues i IPARD)	Tre mujori i dytë i 2020
Përgatitje për një program të zhvillimit rural; programi do të identifikojë një strategji që të përmbushë objektivat në përputhje me prioritetet e BE-së për zhvillimin rural dhe një përzgjedhje masash që merr parasysh situatën specifike të sektorit bujqësor në Malin e Zi	Drejtoria e MBZHR për Zhvillimin Rural (Autoriteti Menaxhues i IPARD)	Tre mujori i dytë i 2018
Krijimi i një mekanizmi konsultimi për strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të zhvillimit rural (shoqatat e fermerëve, dhoma e tregtisë, fakulteti bioteknik dhe struktura të tjera arsimore)	Drejtoria e MBZHR për Zhvillimin Rural (Autoriteti Menaxhues i IPARD)	Në vazhdimësi që nga 2015
Adoptimi i procedurave për punën e autoritetit menaxhues (manuale)	Drejtoria e MBZHR për Zhvillimin Rural (Autoriteti Menaxhues i IPARD)	Tre mujori i fundit i 2020
Përgatitja e procedurave dhe manualeve për zbatimin e Programit të Zhvillimit Rural	Agjencia Paguese dhe zyrat rajonale	2020
Akreditimi i Agjencisë Paguese	Autoriteti kompetent	2020
Pjesëmarrja e punonjësve të autoritetit menaxhues në grupet e punës së Këshillit Evropian dhe KE-së	Drejtoria e MBZHR për Zhvillimin Rural (Autoriteti Menaxhues i IPARD)	Nga data e firmosjes së Marrëveshjes së Anëtarësimit

Trajnime të vazhdueshme të punonjësve të autoritetit menaxhues në fushat e politikave të zhvillimit rural (ATSHI, binjakëzim/kombinim, instrumente të tjerë të asistencës teknike, seminare, trajnime në punë e konsultime)	Drejtoria e MBZHRpër Zhvillimin Rural (Autoriteti Menaxhues i IPARD)	Në vazhdimësi që nga 2015

Burimi: MBZHR 2015b

Mbështetja e shërbimeve të përgjithshme ka në fokus shërbimet për interesin publik (të tilla si arsimimi, kërkimi, ruajtja e burimeve gjenetike në bujqësi), shërbimet profesionale dhe këshilluese në sektorin e blegtorisë, shërbimet veterinare dhe fitosanitare, standardet e sigurisë së ushqimit dhe asistencën teknike.

Përqindja e mbështetjes së shërbimeve të përgjithshme ndaj asaj totale po bie, por ende përfaqëson një pjesë të rëndësishme të mbështetjes bujqësore totale në periudhën 2010-2015. Vlera e saj totale lëvizte midis 5,2 milionë euro dhe 6,1 milionë euro gjatë periudhës së studimit (Figura 6.4). Pjesa e saj ndaj mbështetjes bujqësore totale ra nga 35 % në vitin 2010, në 30 % në vitin 2015 (Figura 6.1).

Figura 6.4. Mbështetja e përgjithshme për bujqësinë në Malin e Zi (fonde të planifikuara), 2010-2015



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Mali i Zi).

Në përgjithësi, zhvillimi i politikave bujqësore në Malin e Zi tregon përshtatjen graduale ndaj kërkesave të PPB-së. Megjithatë, në mënyrë që të arrihet njehsim i plotë me PPB-në, ende është e nevojshme të prezantohen një sërë reformash dhe ndryshimesh udhëzuese. Pjesa e mbështetjes bujqësore në buxhetin kombëtar total ishte 1,1 % në vitin 2015, e cila është relativisht e ulët kur krahasohet me pjesën mesatare të VSHB-së bujqësore në VSHB-në kombëtare totale, e cila ishte rreth 10 % në vitin 2015 (baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore 2016 (Mali i Zi)). Në mënyrë të tërthortë kjo tregon që mund të nevojiten burime financiare shtesë për të adresuar të gjitha sfidat që nevojitet të zgjidhen në sektorin e bujqësisë dhe zonave rurale. Megjithatë, dokumentet strategjike relevante parashikojnë një prezantim gradual të ndryshimeve të nevojshme për politikat bujqësore dhe, nëse implementohen suksesshëm, do të ketë gjasa të sigurojnë që Mali i Zi të jetë në gjendje të përmbushë angazhimet e tij për procesin e integrimit në BE.

6.4 Pagesat direkte

Në Malin e Zi ka tre lloje pagesash direkte: (1) pagesat për sipërfaqe për bimët e arave dhe duhanin; (2) pagesat për krerë për gjedhët dhe të imtat; dhe (3) subvencionet për prodhimin për litër qumështi të dërguar në baxho (Tabela 6.2).

Tabela 6.2. Pasqyra e skemave të pagesave direkte të zbatuara në Malin e Zi, 2015

Sektori	Pagesat për sipërfaqe/krerë	Pagesat për prodhim
Bimë Arash (përjashtuar duhani)	Drithërat, patatet, grurin për miell dhe kultura bimore të tjera (160 euro/ha)	
	Bimënforagjere (100-150 euro/ha)	
	Farë Patatesh — elitë (700 euro/ha)	
	Fara drithërash (400 euro/ha)	
Duhani	1 000 euro/ha	
Qumështi		Qumështi i lopës, deles dhe dhisë (0.06 euro/l)
		Pagesa shtesë për prodhuesit e mëdhenj (0.01 euro/l)
		Pagesa shtesë për cilësinë e qumështit (0.01-0.03 euro/l)
Gjedhët	Lopët e mëshqerrat e mbarështimit (70 euro/krerë)	
	Buaj dhe dema (të therur) për mish(120-140 euro/krerë)	
Dele dhe dhi	8 euro/krerë	

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Mali i Zi).

Në vitin 2015, shpenzimet e planifikuara për pagesat direkte përbënin 5,3 milionë euro ose 27 % të mbështetjes bujqësore totale. Sektorët e produkteve bulmetore dhe të mishit të gjedhit janë përfituesit më të mëdhenj të kësaj mbështetjeje e cila përbënte 61 % të pagesave direkte totale në vitin 2015. Kriteret e përzgjedhjes për të marrë pagesat direkte kërkojnë që përfituesit të regjistrohen në Regjistrin e Fermës dhe të përmbushin kërkesa të tjera specifike që ndryshojnë sipas masave (p.sh. sipërfaqja minimale, numri i krerëve dhe sasia e prodhuar) (Tabela 6.2).

Në përgjithësi, pagesat direkte në Malin e Zi nuk janë në perputhje me ato që janë zbatuar aktualisht nga BE. Kjo është e vërtetë si për llojin e masës së aplikuar, edhe për kapacitetin institucional për t'i menaxhuar dhe zbatuar ato. Në kontrast me PPB-në, të gjitha pagesat direkte janë të lidhura me prodhimin dhe ndër-pajtueshmëria nuk është një kërkesë e detyrueshme për përfituesit në Malin e Zi. Për më tepër, duke marrë në konsideratë mbizotërimin e fermave të vogla në Malin e Zi, është e nevojshme të adresohet aksesi i tyre në pagesat direkte, dhe më specifike, në rrugën e procesit të pranimit në BE. Për më tepër, SIAK dhe SIPT të aplikuara nga PPB për të menaxhuar dhe zbatuar pagesat direkte nuk janë zbatuar për menaxhimin dhe kontrollin e pagesave direkte në Malin e Zi.

Sipas strategjisë dhe planit të veprimit (MBZHR 2015a, 2015b), parashikohet që njehsimi i pagesave direkte dhe kapacitetit institucional (SIAK, SIPT) me kërkesat e PPB-së, do të implementohet gradualisht në Malin e Zi. Lidhur me këtë aspekt dokumentet strategjike përshkruajnë veprimet e mëposhtme:

— rritjen graduale të mbështetjes bujqësore dhe rritjen e numrit të përfituesve dhe tokës bujqësore në aksesin në pagesat direkte;

— ndarjen graduale të pagesave për sipërfaqe nga prodhimi dhe futjen e një skeme të thjeshtë për bimët e arave, kulturat e përhershme dhe kullotat;

— vendosjen e disa kritereve të përzgjedhjes së përfituesve për të marrë pagesat direkte, të lidhura me përkufizimin e një fermeri aktiv, aktivitetit bujqësor, zonës që përmbush kriteret për t'u përzgjedhur dhe kërkesat minimale të përzgjedhjes në perputhje me kërkesat e BE-së;

— ristrukturimin e mbështetjes direkte në aspektin e rritjes së shpenzimeve për pagesat pa lidhje me prodhimin (decoupled) dhe, rrjedhimisht, uljen në terma relativë të

shpenzimeve të disponueshme për pagesat e lidhura me prodhimin (coupled) për mishin e gjedhit, bagëtitë e imëta, qumështin dhe duhanin;

- Prezantimi i standardeve të ngjashme me ndër-pajtueshmërinë për fermerët që marrin pagesa direkte (me përjashtim të fermave të vogla);
- Futja e masave të gjelbra si në PPB.

Tabela 6.3. Aktivitetet e planifikuara për harmonizimin e pagesave direkte në Malin e Zi.

Drejtimi i palidhur me prodhimin (decoupled)	Drejtimi i lidhur me prodhimin (coupled)	Viti
Prezantimi i bimëve të përhershme skemën e pagesave për sipërfaqe të palidhura me prodhimin (decoupled)	Status quo	2016
Prezantimi i prodhimit të perimeve në skemën e pagesave për sipërfaqe të palidhura me prodhimin; përshtatja e pagesave për hektarë për kulturat bimore	Pagesa të reja për kulturat bimore; vazhdimi i pagesave për blegtorinë dhe qumështin	2017
Pagesat për bimët e arave dhe të përhershme të vendosen plotësisht	Vazhdimi i pagesave për kulturat bimore (gradualisht në rënie në favor të pagesave të palidhura me prodhimin); vazhdimi i pagesave për bagëti dhe qumësht	2018
Prezantimi i kullotave permanente në skemën e pagesave të palidhura me prodhimin për sipërfaqe, ndërkohë që mbahet pagesa për sipërfaqe të prezantuara më parë (bimë arash dhe kultura të përherhshme)	Vazhdimi i pagesave për kulturat bimore (gradualisht në rënie në favor të pagesave të palidhura me prodhimin); vazhdimi i pagesave për blegtorinë dhe qumështin (gradualisht në rënie në favor të pagesave për kullotat e përhershme)	2019
Pagesat direkte të vendosura plotësisht; SIAK plotësisht i krijuar; prezantimi i standardeve të ngjashme me ndër-pajtueshmërinë	Vazhdimi i pagesave për bimët e arave të mbjella; vazhdimi i pagesave për sektorët që përmbushin kriteret për t''u mbështetur pas anëtarësimit në BE	2020

Burimi: Plani i Veprimit për përafrimin me *acquis*, Kapitulli 11 – Bujqësia dhe Zhvillimi Rural (MBZHR 2015b)

Koha për të bërë ndryshimet e nevojshme në legjislacionin kombëtar ekzistues që kërkohet për të vënë në jetë këto zhvillime të politikave të planifikuara përmblidhet në Tabelën 6.3.

Në periudhën pasardhëse, dokumentet strategjikë parashikojnë dhënien e pagesave për prodhimin e bulmetit bazuar në cilësinë e qumështit, dhe jo në sasinë e qumështit të prodhuar. Në të njëjtën kohë, përmirësimi në cilësinë e qumështit do të ndihmohet nga masat e zhvillimit rural që mbështesin investimet në pajisjet dhe infrastrukturën e fermave.

Pagesat direkte aktualisht menaxhohen nga MBZHR në bashkëpunim me institucione të ndryshme të tilla si shërbimet e ekstensionit për prodhimin e kulturave bimore, shërbimi i përzgjedhjes së blegtorisë dhe inspektoriatet përkatëse (veterinar dhe fitosanitar). Në planifikimin e ardhshëm, parashikohet që të ngrihet Agjencia Paguese e cila do të jetë përgjegjëse për zbatimin e pagesave direkte.

6.5 Vlerësimi i zbatimit të dokumenteve të politikave bujqësore dhe përfundimet

Gjetjet e paraqitura në këtë kapitull tregojnë që nuk u vunë re ndryshime të rëndësishme në strukturën e fondeve buxhetore për mbështetjen bujqësore gjatë periudhës së studimit. Megjithatë, analizat në këtë kapitull janë bazuar në mbështetjen e planifikuar. Pavarësisht kësaj, zhvillimi i mbështetjes bujqësore të planifikuar tregon një tendencë pozitive me një shpërndarje të qëndrueshme të mbështetjes nëpër masat e ndryshme (pra, mbështetja direkte për prodhuesin, programi i mbështetjes rurale dhe mbështetja e shërbimeve të përgjithshme) gjatë periudhës së studimit 2010-2015. Në të njëjtën kohë, harmonizimi i politikave bujqësore të Malit të Zi me PPB-në e BE-së promovohet qartë në dokumentet strategjikë dhe planin e veprimit që përkufizon planet e ardhshme për zhvillimin e politikave në Malin e Zi (MBZHR 2015b).

Mali i Zi vendosi të adoptojë *acquis*-in e BE-së gradualisht në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Kjo do të thotë që Mali i Zi synon përafrimin e politikave bujqësore kombëtare me PPB-në me anëtarësimin në BE. Prezantimi i të gjitha strukturave të nevojshme institucionale dhe kuadrot rregullues duhet të jenë në përdorim në momentin e pranimit të Malit të Zi në BE për të qenë në gjendje të menaxhojnë dhe marrin fonde nga BE dhe të paguajnë përfituesit në përputhje me rregullat dhe procedurat e BE-së.

Për të arritur adoptimin e plotë të *acquis*-it të BE-së, duhet ende të bëhet një progres i dukshëm. Në veçanti, politika bujqësore malazeze duhet të lëvizë nga zbatimi i pagesave të lidhura me prodhimin (coupled) në përdorimin e pagesave të palidhura me prodhimin (decoupled), e cila është mbështetja mbizotëruese nën PPB-në. Për më tepër, kapacitetet administrative që nevojiten për zbatimin e suksesshëm të politikave bujqësore ende nuk janë të mjaftueshme dhe duhet të forcohen ndjeshëm. Mali i Zi duhet të krijojë kushtet e duhura për krijimin e SIAK dhe SIPT, të cilët përdoren nga PPB për të menaxhuar dhe zbatuar pagesat direkte, së bashku me elementët e tjerë të nevojshëm për përdorimin efikas të fondeve të mbështetjes. Paralelisht, gjithashtu është e nevojshme të fillojë zbatimi i programit IPARD sa më shpejt, në mënyrë që fondet e BE-së të mund të përdoren për të forcuar strukturën institucionale malazeze dhe për të promovuar rritjen e sektorit bujqësor dhe zonave rurale. Për më tepër, duhet theksuar që një qasje moderne e bazuar në evidenca duhet të implementohet më rreptësisht në Malin e Zi për të përmirësuar procesin e vendimmarrjes në ciklin e politikave bujqësore, me qëllim kalimin nga projektimi tek zbatimi. Detyrat sfiduese në këtë aspekt janë që të ndërtohen statistika të politikave bujqësore dhe të krijohen kapacitete institucionale për të përdorur këto statistika për politikë-bërje.

7 Serbia: zhvillimi dhe vlerësimi i politikave bujqësore

Natalija Bogdanov, Ružica Papić dhe Saša Todorović

Universiteti i Beogradit, Fakulteti i Bujqësisë

7.1 Hyrje dhe qasja

Gjatë dekadës së fundit, politikat bujqësore në Serbi kanë hasur ndryshime të shpeshta që lidhen me kuadrin politik, mekanizmat e zbatimit dhe transfertat buxhetore drejt bujqësisë. Pavarësisht paqëndrueshmërisë, papajtueshmërisë së masave politike dhe zhvendosjeve të paparashikuara të mekanizmave të zbatimit, në vitet e fundit është arritur një progres në krijimin e strukturave institucionale dhe përshtatjes së konceptit të njehsimit të politikave bujqësore me PPB-në. Shtysa më e fuqishme për përshpejtimin e reformave institucionale dhe politike ishte hapja e negociatave për pranimin e Serbisë në BE në fund të vitit 2013. Gjatë 3 viteve të fundit, janë adoptuar dokumentet ligjorë, strategjikë dhe programues që rregullojnë politikat bujqësore dhe janë ngritur strukturat institucionale për të adresuar kërkesat mbi procesine integrimit në BE.

Kuadri ligjor për zbatimin e politikave bujqësore rregullohet nga ligjet që janë miratuar që prej vitit 2013. Kuadri strategjik përcaktohet nga Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën 2014-2024 (adoptuar më 2014) dhe programi IPARD (adoptuar në 2016), që të dy japin një bazë më transparente dhe të qëndrueshme për zbatimin e politikave. Edhe pse ka pasur një farë progresi në formulimin e politikave, ende ka probleme në zbatimin e tyre. Kërcënimi më i madh ndaj realizimit të objektivave politikë të parashikuar nga kjo strategji vjen nga mungesa e dokumenteve programues afatmesëm, një sistem i paqëndrueshëm financimi dhe reduktimit të dukshëm në mbështetjen buxhetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural në vitin 2015 (e cila vazhdoi edhe në vitin 2016).

Ky raport synon dhënien e informacionit që do të mundësojë kuptimin e zhvillimeve të fundit të politikave bujqësore serbe. Më saktësisht, në këtë kapitull do të (1) shohim dokumentet kryesorë strategjikë dhe programues në vend, me theks të veçantë në masat që duhet të implementohen në të ardhmen; (2) ekzaminojmë transfertat buxhetore dhe fondet gjatë viteve të fundit, sipas shtyllave dhe grup-mallrave; (3) përshkruajmë sistemin e pagesave direkte për të theksuar ndryshimet në masat e zbatimitdhe kriteret e përzgjedhjes së përfituesve; dhe (4) vlerësojmë procesin e zbatimittë politikave dhe nxjerrim konkluzione.

Qasja metodologjike përfshin analizë përmbajtjeje cilësore të dokumenteve strategjikë dhe programues që rregullojnë kuadrin aktual të politikave bujqësore. Vëmendja fokusohet kryesisht në funksionalizimin e politikave, pra në përmbajtjen e akteve legjislative që qeverisin zbatimin e skemave të mbështetjes dhe masave politike. Analiza sasiore e transfertave buxhetore sipas shtyllave të politikave dhe grupit të masave u krye duke përdorur bazën e të dhënave të MPB-së të Serbisë, e cila përdor skemën e klasifikimit të MPB-së për grupimin e masave të mbështetjes në grupin përkatës (Rednak et al., 2013) ([24]).

7.2 Strategjitë dhe dokumentet programuese për politikat bujqësore

Përshpejtimi i procesit të integrimit në BE ka rezultuar në përmirësime të shumta politike dhe institucionale në bujqësinë serbe. Dokumentet ligjore, strategjike dhe programuese që aktualisht qeverisin politikat bujqësore në Serbi, u përditësuan; gjithashtu disa

([24]) Masat e mbështetjes, përfshirë të dhënat mbi buxhetin e ekzekutuar, janë të grupuara në përputhje me modelin MPB dhe nuk ndjekin strukturën e dhënë nga legjislacioni kombëtar.

struktura institucionale u përshtatën për të përmbushur sfidat e modelit të ri të zbatimit të politikave.

Politikat e Bujqësisë dhe zhvillimit rural në Serbi për periudhën 2010-2015 u bazua në dy akte legjislative kryesore:

— Ligji mbi Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (miratuar në vitin 2009) ([25]), i cili përkufizoi mekanizmat për krijimin dhe zbatimin e politikave bujqësore dhe dokumentet kryesore në qeverisjen e politikave bujqësore nga perspektiva afat-mesme dhe afat-gjatë;

— Ligji mbi Stimujt në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural (miratuar në vitin 2014), i cili zëvendësoi Ligjin mbi Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe rregullon llojet e mbështetjes, financimin dhe metodat e zbatimit, por nuk merret me çështjet që kanë të bëjnë me hartimin dhe adoptimin e kuadrit politik.

Ligji mbi Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural parashikon që politikat bujqësore të Serbisë duhet të rregullohen nga Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Programi Kombëtar për Bujqësinë dhe Programi Kombëtar për Zhvillimin Rural. Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural u adoptua në vitin 2014, duke përcaktuar vizionin, synimet strategjike dhe kuadrin buxhetor për periudhën 2014-2024. Programi Kombëtar për Bujqësinë dhe Programi Kombëtar për Zhvillimin Rural, të cilët supozoheshin të përcaktonin objektivat e politikave afat-mesme dhe zbatimin e tyre, nuk janë adoptuar. Ndërkohë, Ligji mbi Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural u zëvendësua nga Ligji mbi Stimujt në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural, i cili nuk parashikon nevojën për një kuadër politik për periudhën afatmesme. Rrjedhimisht, duke përdorur programin shumëvjeçar, politikat bujqësore po implementohen në bazën e rregulloreve vjetore (bazuar në Ligjin mbi Stimujt në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural), ndërsa masat mbështetëse po implementohen në bazë të legjislacionit dytësor (librat e rregullit).

Masat mbështetëse të parashikuara nga Ligji mbi Stimujt në Bujqësi dhe Zhvillim Rural janë paraqitur në Tabelën 7.1, duke përfshirë ndryshimet në lidhje me ligjin e mëparshëm.

Në aspektin e shtrirjes, qëllimeve dhe alokimit të fondeve buxhetore sipas llojit të stimulit, Ligji mbi Stimujt në Bujqësi dhe Zhvillimi Rural parashikon që shuma maksimale e pagesave direkte do të varet nga burimet e disponueshme (përkufizuar nga ligji vjetor mbi buxhetin), shuma e mbështetjes sipas llojit të stimulit dhe numrit te përfituesve. Ligji përcakton që numri i stimujve për prodhimin e qumështit mund të vendoset në një nivel më të lartë në varësi të cilësisë së qumështit dhe sasisë së qumështit të prodhuar për lopë gjatë periudhës së prodhimit të qumështit (laktacionit). Për më tepër, pagesat direkte, zhvillimi rural dhe stimujt specialë mund të vendosen në shuma të ndryshme, në varësi të faktit nëse qëllimi i tyre janë zonat me kushte bujqësore të vështira apo jo (i cili nuk është rast për stimujt për mbështetje me kredi).

Funksionalizimi i politikave bujqësore rregullohet nga:

— Rregullorja Vjetore mbi Shpërndarjen e Subvencioneve në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural ([26]), e cila përcakton fondet totale, llojin dhe shumat maksimale për disa stimuj, në përputhje me Ligjin mbi Stimujt në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural dhe ligjin vjetor mbi buxhetin e Republikës së Serbisë.

— Librat vjetorë rrugullues mbi kushtet dhe metodat e ushtrimit të së drejtës për mbështetje për masa specifike, të cilat përcaktojnë në detaje shumën e mbështetjes, kriteret e përzgjedhjes dhe metodën e ushtrimit si të të drejtave ashtu edhe të përgjegjësive të përfituesve.

([25]) Gazeta Zyrtare e Serbisë, 41/2009 dhe 10/2013

([26]) Këto masa janë financuar nga Fondi për Zhvillimin Bujqësor, Drejtoria për Pagesat Bujqësore dhe Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Tabela 7.1. Masat e mbështetjes të parashikuara nga Ligji mbi Stimujt në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural në Serbi.

I Pagesat direkte
Shtesa në pagesë (Premium)
Shtesa në pagesat për qumështin
Stimujt për prodhimin bimor
Stimuj bazë për prodhimin bimor
Stimuj të lidhur me prodhimin
Stimuj për prodhimin e blegtorisë
Stimuj për krijimin e stokut rracor cilësor
Stimuj për shtesën e peshës (trashjen) së gjedhëve, qengjave dhe derrave
Stimuj për lopët me orientim prodhim qumështi
Stimuj për kosheret e bletëve
Stimujt për prodhimin e peshkut për konsum
Subvencione inputi
Subvencione inputi për plehun, farërat dhe inpute të tjera
Stimuj për kostot e magazinimit në magazinat publike
II Zhvillimi rural
Subvencione për investimet në bujqësi për të rriturvkonkurrueshmërinë dhe për të arritur standarde cilësorë
Subvencione për investime në prodhimin bujqësor (në ferma)
Krijimi dhe forcimi i grupeve të prodhuesve
Subvencione për investimet në përpunimin e produkteve bujqësore dhe marketing
Subvencion për pagesat shtesë të sigurimit për kulturat bimore, plantacionet shumëvjeçare, fidanishtet dhe krerët ([a])
Subvencione për zhvillimin e qëndrueshëm rural
Zbatimi i masave agro-mjedisore
Prodhimi organik
Ruajtja e burimeve gjenetike të bimëve dhe kafshëve
Pagesa kompensimi për zbatimin e praktikave të mira bujqësore, mirëqenies së kafshëve dhe politika të tjera për të mbrojtur e ruajtur mjedisin
Subvencione për përmirësimin e ekonomisë rurale
Investime për përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës rurale
Përmirësimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale duke mbështetur aktivitetet jo-bujqësore
Aktivitete ekonomike të tilla si shtimi i vlerës produkteve bujqësore, prezantimi dhe certifikimi i sistemeve të sigurisë së ushqimit dhe cilësisë së ushqimit, produktet organike dhe produkte me tregues gjeografik
Përmirësimi i trajnimit në sferën e zhvillimit rural
Mbështetje për përgatitjen dhe zbatimin e strategjive lokale të zhvillimit rural
Mbështetje për shërbimet e këshillimit dhe ekstensionit ([b])
III Mbështetja me kredi
Subvencionimi i inputit në pjesën e normës së interesit
IV Stimuj specialë
Stimuj për sistemet e informacionit të marketingut në bujqësi Stimuj për krijimin, zhvillimin dhe operimin e të dhënave të kontabilitetit mbi njësitë ekonomike bujqësore Stimuj për zbatimin e programeve të mbarështimit, për të arritur synimet në mbarështimin blegtoral Stimuj për zbatimin e projekteve të kërkimit, zhvillimit dhe risive në bujqësi Stimuj për prodhimin e materialeve mbjellëse, certifikimin dhe seleksionimi me klone

([a]) Kjo masë më parë klasifikohej në subvencionet për input.
([b]) Kjo masë më parë klasifikohej në mbështetjen speciale

Burimi; Gazeta Zyrtare e Serbisë, 142/2014 dhe 103/2015.

Faktorët që pengojnë vlerësimin e efektivitetit të politikave bujqësore janë mungesa e monitorimit të institucionalizuar dhe sistemeve të vlerësimit, mungesa e tregueve të referencës dhe synimeve që zakonisht mungojne, janë të dobëta apo të përkufizuara dobët. Sipas Ligjit mbi Stimujt në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural, Ministria e Bujqësisë është e detyruar të publikojë një Raport të Gjelbër vjetor, i cili duhet të përfshijë vlerësimin e situatës në sektor dhe efektet e masave që u implementuan në vitin e

mëparshëm. Raporti i Gjelbër publikohet që prej vitit 2014 cdo vit dhe prezantohet me përmbajtje të ngjashme nga viti në vit. Raporti i Gjelbër nuk analizon efektet e masave të politikave por merret vetëm me përbërjen e buxhetit për bujqësi sipas llojit të subvencionit sikundër përkufizuar sipas rregulloreve vjetore. Edhe pse baza statistikore e të dhënave, SIAK dhe regjistrat e brendshëm të Ministrisë janë përmirësuar, këto burime nuk janë përdorur për të vendosur tregues bazë transparentë dhe sistematikë për një vlerësim objektiv të situatës në sektor.

7.3 Zhvillimi i politikave bujqësore

Në periudhën 2010-2015, nivelet e shpenzimeve buxhetore për të mbështetur bujqësinë varionin nga 191,1 milionë euro në 2010-n, në 315,4 milionë euro në 2014-n. Pjesa e buxhetit për bujqësinë në buxhetin total gjithashtu varionte, por mbeti poshtë 5 % (sic ishte parashikuar në Ligjin mbi Stimujt në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural). Në të gjithë periudhën 2010-2015, pjesa e shpenzimeve në bujqësi në buxhetin total ishte më e ulët se kontributi i sektorit në VSHB (8-10 %; baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore 2016 (Serbia)), e cila rezulton në një raport të këtyre dy treguesve me vlerë rreth 0,5 dhe vendos Serbinë në një nivel mesatar midis vendeve në zhvillim (Bogdanov et al., 2016).

Rritja e qëndrueshme dhe konstante e mbështetjes buxhetore për bujqësinë, e cila filloi në vitin 2009, u ndërpre në vitin 2015 (Figura 7.1) ([27]). Transfertat buxhetore totale për bujqësinë në vitin 2015 ranë me 33 % krahasuar me vitin 2014, me mbështetjen direkte për prodhuesin që pësoi reduktimet më të mëdha (me 38 % krahasuar me vitin 2014). Fondet e alokuara për masat e zhvillimit rural u rritën (me 24 %) në vitin 2015 në raport me 2014-n, sikundër ndodhi edhe me përpjesën e tyre në buxhetin total (nga 4,0 % në vitin 2014, në 7,4 % në vitin 2015). Rritja e fondeve të alokuara për mbështetjen e zhvillimit rural u shkaktua nga rritja në financimin e investimeve në fermë për të përmirësuar konkurrueshmërinë (nga 10.0 milionë euro në vitin 2014, në 13,8 milionë euro në vitin 2015). Financimet për masat e mbështetjes së përgjithshme mbetën në të njëjtin nivel në terma absolutë (24 milionë euro) në periudhën 2010-2015, ndërsa pjesa e tyre ndaj buxhetit total u rrit nga 7,6 % në vitin 2014, në 11,3 % në vitin 2015.

Figura 7.1. Mbështetja buxhetore për bujqësinë në Serbi, 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Serbi).

([27]) Për shkak të mungesave në të dhënat për mbështetjen buxhetore për bujqësinë në mes të viteve 2000, nuk është e mundur të krahasohen të dhënat në të gjithë dekadën me saktësi; megjithatë, mund të diskutojmë me siguri të lartë që buxheti i bujqësisë në vitin 2015 ishte ndër më të ulëtit e dekadës së fundit.

Shumica e fondeve të shtyllës së parë janë alokuar për mbështetjen direkte për prodhuesin (100 % në vitin 2015). Për sa i përket mbështetjes totale për bujqësinë, mbështetja direkte për prodhuesin tregoi një tendencë në rritje në periudhën 2010-2014, ndjekur nga një rënie e ndjeshme në vitin 2015. Mbështetja direkte për prodhuesin u rrit nga 154,7 milionë euro në vitin 2010, në 278,8 milionë euro në vitin 2014, dhe më pas ra në 172,5 milionë euro në vitin 2015. Pati një zhvendosje të madhe në strukturën e mbështetjes direkte për prodhuesin në periudhën 2010-2015. Pagesat direkte u rritën nga më pak se 15 % në vitin 2010, në rreth 70 % të mbështetjes direkte totale për prodhuesin në vitin 2015. Subvencionet e inputit, të cilat janë të dytat për nga rëndësia, përbënin rreth 30 % të mbështetjes totale për prodhuesin në vitin 2015, duke rënë me më shumë se 85 % krahasuar me vlerat që ishin në vitin 2010 (Figura 7.2).

Figura 7.2.Shpenzimet buxhetore për mbështetjen tregut dhe asaj direkte për prodhuesin në Serbi, 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Serbi).

Së bashku me ndryshimin në strukturën e mbështetjes direkte për prodhuesin, gjithashtu ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në alokimin sipas grup-mallrave. Mbështetja direkte për prodhuesin për kulturat bimore u reduktua, ndërsa mbështetja direkte ndaj prodhuesve të blegtorisë u rrit në periudhën 2010-2015. Mbështetja për kulturat bimore ra nga më shumë se 90 % në 2010-n në 41,3 % në 2015-n. Mbështetja direkte për blegtorinë u rrit nga rreth 5 % në 2010-n, në 57,7 % në 2015-n. Një pjesë e vogël e mbështetjes direkte për prodhuesin (rreth 1,1 % në 2015-n) nuk u nda sipas sektorëve por u dha për të gjitha grup–mallrat (Figura 7.3).

Figura 7.3. Mbështetja direkte ndaj prodhuesit sipas grup-mallrave në Serbi, 2010-2015.



Burimi: baza e të dhënave të MPB-së (Serbi).

Në përgjithësi, pavarësisht vazhdimësisë së zbatimit të disa prej masave (p.sh. pagesat për krerë), zhvillimi i mbështetjes për bujqësinë pasqyron një zhvendosje të madhe konceptuale në periudhën 2010-2015 në drejtim të pagesave direkte dhe në favor të prodhimit blegtoral, pavarësisht kushteve me shkurtimet buxhetore që ndodhën në vitin 2015.

7.4 Mbështetja direkte ndaj prodhuesit

Mbështetja direkte për prodhuesin në Serbi ka pësuar adaptime dhe ndryshime konstante në dekadën e fundit. Një reformë kryesore u prezantua në fillim të viteve 2000, kur pagesat direkte u prezantuan si pagesa të lidhura me nivelet e prodhimit (coupled), qoftë kjo në sipërfaqet e kultivuara apo numrin e krerëve. Synimi i pagesave direkte ishte të kompensonte fermerët për tkurrjet në mbështetjen e tregut. Që prej vitit 2010 ka patur dhe ndryshime të tjera në skemat e mbështetjes direkte, të cilat lidhen me kriteret e përzgjedhjes së përfituesve, produktet e mbuluara nga mbështetja dhe vlera e fondeve të alokuara.

Tabela 7.2. Mbështetja direkte ndaj prodhuesit sipas grup-masave në Serbi (milionë euro), 2013-2015

	2013	2014	2015	Ndryshimi 2015/2014
Pagesat direkte bazuar në prodhim (subvencionet për prodhim)	36.9	40.6	37.1	-8.6 %
Pagesat direkte bazuar në sipërfaqen/nr e krerëve	145.4	148.5	85.0	-42.8 %
Pagesat për hektarë (pagesat për sipërfaqe)	93.6	93.5	22.6	-75.8 %
Pagesat për krerë (pagesat për krerë)	51.8	55.1	62.4	13.3 %
Subvencionet për input variabël	45.0	89.7	50.4	-43.8 %
Subvencion për karburant	42.0	51.7	25.3	-51.1 %
Subvencion për plehun	0.0	32.6	23.3	-28.5 %
Subvencion për sigurimin	3.0	5.4	1.8	-66.6 %

Burimi: baza e të dhënave të MPB-së (Serbi).

Tabela 7.2 tregon mbështetjen direkte për prodhuesin sipas grup-masave në Serbi për periudhën 2013-2015. Ndryshimet më të rëndësishme të vëzhguara në këtë periudhë përfshijnë një rritje të subvencioneve për inputet në vitin 2014 dhe një rënie në vlerën totale të mbështetjes direkte në vitin 2015. Vlerat totale të subvencioneve të inputit pothuajse u dyfishuan në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013. Shkurtimet e buxhetit për mbështetjen direkte për prodhuesin në vitin 2015 nuk u shpërndanë në mënyrë të barabartë në të gjithë sektorët. Pagesat për sipërfaqe treguan reduktimin më të madh (-76 %), ndjekur nga subvencionet në input (-44 %). Pavarësisht reduktimit radikal të mbështetjes direkte, pagesat direkte të lidhura me blegtorinë u rritën me 13 % në vitin

2015 krahasuar me vitin 2014. Në aspektin e shpërndarjes së mbështetjes direkte në vitin 2015, pagesat për krerë mbizotëronin (duke përfaqësuar 36 % të mbështetjes direkte totale për prodhuesin), ndjekur nga subvencionet për inputet (29 %), subvencionet për prodhimin (22 %) dhe pagesat për sipërfaqe (13 %).

Fermerët duhet të regjistroheshin në regjistrin e fermës që të mund të përzgjidheshin për mbështetje direkte. Për më tepër, kriteret e përzgjedhjes për të marrë mbështetjen për blegtorinë kërkonin që fermerët të regjistronin krerët apo kosheret në bazën e të dhënave qendrore (me përjashtim të shpendëve). Në vitin 2010 dhe 2011, marrësit e mbështetjes direkte (me përjashtim të fermerëve në ZVN), ishin të detyruar të paguanin pensionin e detyrueshëm dhe kontributet e sigurimit të paaftësisë.

Pagesat bazuar në prodhim (subvencionet për prodhimin)

Shpërblesa në cmim për qumështin është masa e vetme e pagesës direkte e bazuar në prodhim që është zbatuar në periudhën 2010-2015. Subvencionet e prodhimit për produktet e tjera u anulluan para vitit 2010 dhe u zëvendësuan me pagesa për sipërfaqe.

Vlera e mbështetjes në cmim për qumështin varionte midis 0,04 euro dhe 0,06 euro për litër midis vitit 2010 dhe 2013. Në vitin 2013, u vu kufiri minimal dhe maksimal për qumështin e derguar ne baxho dhe u mbajtën pagesa të sheshta për litër (0.06 euro për litër). Pragu i ulët i përzgjedhjes së përfituesve për mbështetjen e prodhimit të qumështit të derguar në baxho u prezantua për fermerët që gjendeshin në ZVN. Shuma totale e mbështetjes në cmim për qumështin ishte 36,7 milionë euro në vitin 2015, duke rënë me 8,6 % krahasuar me vlerën e tij në vitin 2014 (Tabela 7.3).

Tabela 7.3. Mbështetjet në cmim të produkteve të bulmetit në Serbi (euro/litër), 2010-2015.

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Mbështetjet në cmim të produkteve të bulmetit (dhënë për qumësht lope, deleje apo dhie të dërguar në baxho; sasia minimale dhe maksimale e vendosur për t'u paguar)	0.04	0.05	0.04; 0.06	0.06	0.06	0.06

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Serbi).

Pagesat bazuar në sipërfaqe/krerë

Pagesat direkte për hektarë/krerë janë forma kryesore të skemave të mbështetjes për fermerët në Serbi. Gjatë dy viteve të fundit të studimit, rreth 50 % e buxhetit bujqësor total ishte alokuar për pagesat direkte. Masat specifike të pagesës direkte të zbatuara në periudhën 2010-2015 varionin ndjeshëm në aspektin e shumës së pagesës (total dhe për hektarë/krerë), mbulimit të produktit dhe kritereve të përzgjedhjes së përfituesve.

Në vitin 2012, pagesat për sipërfaqe ishin të synuara vetëm për sipërfaqe në bimët e arave; megjithatë, që prej vitit 2013, kjo mbështetje është zgjeruar (në formën e një norme të sheshtë) edhe për bimët e përhershme. Në vitin 2013, pagesat për sipërfaqe zëvendësuan disa nga subvencionet e inputit që përdoreshin më parë për plehun dhe karburantin.

Që prej futjes së kësaj skeme mbështetëse, dhe pas një kohe relativisht të shkurter, ka pasur një rënie konstante në vlerën e pagesave për sipërfaqe për hektarë, nga 56,8 euro/ha në vitin 2012, në 49.3 euro/ha në vitin 2015. Për më tepër, sipërfaqja maksimale që mund të përzgjidhet për pagesa për sipërfaqe u reduktua ndjeshëm në vitin 2015 nga 100 hektarë në 20 hektarë. Ky prag relativisht i ulët i bën pagesat për sipërfaqe të ngjashme me një skemë pagese e kryer me shuma gjithëpërfshirëse "*lump sum*" (veçanërisht për fermat e mëdha). Në thelb, reduktimi i buxhetit bujqësor total dhe, në veçanti, rënia e madhe në pagesat direkte në vitin 2015 në raport me vitin 2014, kryesisht coi në reduktimin e sipërfaqeve që mund të përzgjidhen për tu mbështetur (Tabela 7.4).

Tabela 7.4. Skemat e pagesave bazuar në sipërfaqe në Serbi (euro/ha), 2010-2015.

Përshkrimi/Kërkesat specifike	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Pagesa për bimët e arave (dhënë për sipërfaqe të kultivuara me drithëra, patate, bimë foragjere, bimë industriale dhe duhan gjethe)			57			
Pagesa për bimët e arave dhe për bimët e përhershme (dhënë për bimët e arave, pemishte dhe vreshta); paguar maks 100 ha				53	51	
Pagesa për bimët e arave dhe për bimët e përhershme (dhënë për bimët e arave, drufrutorët dhe vreshtat); paguar për maks 20 ha						50

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Serbi).

Pagesat direkte për krerë u futën për herë të parë në vitin 2007 në Serbi. Në krahasim me pagesat për sipërfaqe, ato janë më të ndryshme në aspektin e numrit të masave dhe llojet e krerëve të mbështetura (Tabela 7.5). Në vitin 2010 dhe 2011, pagesat për krerë u implementuan për krerët e mbarështimit (lopë, dele e dhi dhe derra) dhe, që prej vitit 2012, janë shtrirë edhe për gjedhët dhe derrat për majmëri. Që prej vitit 2013, pagesat për krerë gjithashtu kanë përfshirë mbështetje për qengjat për mish, kosheret, lloje të ndryshme shpendësh të rritur me shtim natyror dhe, që prej vitit 2015, viçat e qumështit.

Tabela 7.5 Skemat e pagesave direkte bazuar në numrin e krerëve të blegtorisë në Serbi (euro/krerë ose euro/koshere), 2010-2015.

Përshkrimi		2010	2011	2012	2013	2014	2015
Pagesa për lopë mbarështimi (racë e pastër) (a)		121	245	221	177	170	207
Pagesë për dele dhe dhi mbarështimi (racë e pastër) (a)		29	39	35	35	60	58
Pagesa për dosa mbarështimi (racë e pastër)(a)		29	39	35	35	34	58
Pagesë për buaj të rinj për majmëri (b)		-	-	88	88	85	83
Pagesa për derra për majmëri (b)		-	-	9	9	9	8
Pagesa për qengja dhe keca për majmëri (b)		-	-	-	9	17	17
Pagesa për rritje shpendësh me shtim natyror	Pula të tipit të rënda/lehta	-	-	-	0.5/0.9	0.5/0.9	0.5/0.8
	Pulat/Gjelat e detit	-	-	-	-	2.6	2.5
Pagesat për koshere		-	-	-	4	4	4
Pagesat për viçat e qumështit (rracë për mish ose e kryqëzuar me rraca për mish; pa dërgesa në baxho)		-	-	-	-	-	166

(a)Dhënë për numrin e krerëve me origjinë/racë të regjistruar; u vendos pragu dhe numri maksimal i krerëve.
(b) Dhënë për krerët e dërguara në thertore (nga viti 2012 e në vazhdim) apo ato për eksport (nga viti 2013 e në vazhdim).

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Serbi).

Subvencionet e inputit

Tendenca e përgjithshme për subvencionet e inputit tregonte një përqendrim në mbështetjen për naftën dhe plehun mineral, ndërsa llojet e tjera të subvencioneve të inputeve kanë qenë të një rëndësie të vogël në Serbi në periudhën 2010-2015. Kjo tendencë vazhdoi deri në vitin 2015, por me një rënie të menjëhershme në shumën totale të subvencioneve të inputeve (nga 84,3 milionë euro në 2014-n, në 48,6 milionë euro në 2015-n), e cila u shkaktua nga reduktimi i sipërfaqes maksimale që kualifikohej për t'u përzgjedhur për subvencione të karburantit dhe plehut (nga 100 ha në 20 ha). Për më tepër, përveç subvencioneve për karburantin dhe plehun, u implementuan subvencionet për sigurimin gjatë gjithë periudhës së studimit (Tabela 7.6). Megjithatë,

pjesa e tyre ndaj vlerës totale të subvencionit të inputeve ishte relativisht e vogël (më pak se 3,7 %).

Tabela 7.6. Skemat e subvencionit për input në Serbi, 2010-2015.

Përshkrimi/kërkesat specifike		Unit	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Plehërat, farërat dhe karburanti (rimbursim i një pjese të kostove të inputeve të blera; për sipërfaqe nën kultivim me bimë arash dhe perime; paguar për min 0,5 ha dhe max 100 ha; pagesë e kufizuar për hektarë)								
Pleh mineral		Maks euro/ha	58	59				
Farëra të deklaruara		Maks euro /ha	39	39				
Karburant naftë, naftë euro, naftë bio		Maks euro /ha	39	39				
Shtesë për sipërfaqet e kultivuara me duhan		Maks euro /ha	194	196				
Subvencion për karburant (rimbursim për naftën)								
Vendosur Për litër; sasi totale e kufizuar		euro /litër			0.53; 0.20			
Vendosur Për litër; pagesë e kufizuar për hektarë		maks euro /ha				53	26	25
Plehërat (rimbursim i pjesës së kostos së produkteve të blera për ushqyerjen e bimës)								
Vendosur Për kg; sasi totale e kufizuar		euro /t	0.10					
Vendosur Për kg; pagesë e kufizuar për hektarë		maks euro /ha					26	25
Sigurimi (bashkë-financim i pagesave shtesë për sigurimin e bimëve dhe blegtorisë)		%	40	40	40			
	Paguar për maks 100 ha	%				40	40	
	Paguar për maks 20 ha	%						40

Burimi: baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (Serbi).

Rishpërndarja e mbështetjes direkte nga subvencionet e inputeve në pagesa për sipërfaqe, shoqëruar me prezantimin e kufinjve të ndryshëm të përzgjedhjes nga viti 2010, ishte në dëm të fermave të mëdha. Kjo ishte veçanërisht e qartë në vitin 2015, me prezantimin e kufirit maksimal të përzgjedhjes në 20 hektarë për pagesat për sipërfaqe. Kur u krahasua vlera totale e subvencioneve për inputet (pra, subvencionet për plehun dhe karburantin) dhe pagesat për sipërfaqe (midis viteve), pagesat u reduktuan nga një vlerë fillestare prej 136 euro/ha në vitin 2010, në një maksimum prej 100 euro/ha për sipërfaqet deri në 20 ha; dhe 50 euro/ha për sipërfaqet që kalonin këtë kufi në vitin 2015 (Tabela 7.4 dhe Tabela 7.6).

7.5 Zbatimi i dokumenteve të politikave bujqësore

Pavarësisht mungesës së dokumenteve programuese shumëvjeçare, adoptimi i i kuadrit ligjor ka kontribuar në rritjen e konsistencës së politikave bujqësore në aspektin e vazhdimësisë së masave të mbështetjes që janë aplikuar në vitet e fundit. Megjithatë, funksionalizmi i politikave bujqësore mbetet problematik dhe përballet me një sërë pengesash.

Pengesa më e madhe e politikave bujqësore të Serbisë është kuadri buxhetor i paparashikueshëm dhe i paqëndrueshëm. Implikimet e një procesi të tillë politikë-bërës sjellin që rishpërndarja e mbështetjes së disponueshme midis masave të ndryshme kryhet bazuar në fondet që janë të disponueshme në një vit të caktuar dhe në prioritete të zgjedhura nga komisione pune te ngritura enkas *"ad hoc"*, pa ndjekur kritere të përkufizuara qartë apo pa kryer një vlerësim të nevojave të nën-sektorëve të ndryshëm apo fushave të zhvillimit bujqësor apo rural.

Disa prej masave të parashikuara në Ligjin mbi Stimujt në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural por që nuk janë financuar jepen më poshtë:

— subvencionet e lidhura me prodhimin për kulturat bujqësore, bazuar në rendimentet dhe llojin e kulturave bujqësore;

— mbështetje për kostot e magazinimit në magazinat publike;

— mundësia për pagesa shtesë për cilësinë e qumështit dhe stimuj për sasinë e qumështit të prodhuar për lopë;

— investime për të përmirësuar dhe zhvilluar infrastrukturën rurale;

— pagesa kompensimi për zbatimin e praktikave të mira bujqësore, mirëqenien e kafshëve blegtorale dhe politika të tjera për të mbrojtur dhe ruajtur mjedisin;

— mbështetje për përgatitjen dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit rural lokal.

Realizimi aktual i fondeve në lidhje me fondet e planifikuara për disa masa politikash në vitin 2015 paraqitet në Tabelën 7.7. Në përgjithësi, realizimi i të gjitha masave të politikave është më i ulët se planifikimi (pra, %-et në Tabelën 7.7 janë më të ulët sesa 100%). Një shkallë e lartë e realizimit vëzhgohet për pagesat direkte (më shumë se 90%), ndjekur nga masat e mbështetjes së shërbimit të përgjithshëm të përzgjedhur (p.sh. 89 % për mbështetjen e zbatimit të programeve të mbarështimit) dhe masat e përzgjedhura të zhvillimit rural (p.sh. 77 % për mbështetjen e ruajtjes së burimeve gjenetike të bimëve dhe kafshëve dhe 76 % për mbështetjen në investime). Masat e politikave që mbeten kanë një normë realizimi që është më e ulët se 50 %, ndërsa disa masa për zhvillimin rural kanë norma realizimi prej 0 %. Duhet të vihet në dukje që të dhënat e raportuara në Tabelën 7.7 nuk marrin parasysh vonesat në pagesa, pezullimet apo vonesat në nisjen e disa prej masave apo çështjeve të tjera të zbatimit ([28]) dhe rrjedhimisht normat e realizimit në Tabelën 7.7 mund të kuptohen për disa masa.

Table 7.7. Realizimi i mbështetjes buxhetore të planifikuar për masat e përzgjedhura në Serbi në vitin 2015.

Masat e mbështetjes	% e realizimit
Pagesat direkte bazë për prodhimin e kulturave bujqesore	96
Pagesa për lopë mbarështimi cilësore	98
Pagesa për viçat e qumështit	91
Subvencion për pagesë shtesë për sigurimet	21
Subvencione për investimet në prodhimin bujqësor	76
Shtimi i vlerës për produktet bujqësore	47
Ruajtja e burimeve gjenetike të bimëve dhe kafshëve	77
Përmirësimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale nëpërmjet mbështetjes së aktiviteteve jo-bujqësore	39
Përmirësimi i trajnimit në fushën e zhvillimit rural	0
Mbështetje për përgatitjen dhe zbatimin e strategjive lokale të zhvillimit rural	0
Mbështetja me kredi	16
Mbështetje për zbatimin e programeve të mbarështimit	89
Mbështetje për zbatimin e projekteve të kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit në bujqësi	12

Burimi: analiza e autorëve

Procesi i politikë-bërjes bujqësore në Serbi vuan nga mungesa e aplikimit të sistemeve të vlerësimit dhe monitorimit, vendosjen e matjes krahasuese dhe synimeve për të udhëhequr hartimin, adoptimin dhe zbatimin e masave politike të ndryshme. Kjo mungesë bën që alokimi i mbështetjes bujqësore, hartimi dhe aplikimi i masave specifike në praktikë të bazohet në vendime të koordinuara mes palëve, (komisione pune të ngritura enkas *ad hoc)* që janë bazuar në kritere jo transparente. Sistemi ekzistues siguron (pak a shumë) vazhdimësinë e mbështetjes së parashikuar nga rregulloret e

([28]) Për shembull, për shkak të numrit të rritur të aplikimeve për mbështetje për investime në fund të vitit 2015, qeveria dha 10,1 miliardë RDS shtesë (83 milionë euro) të fondeve për këto masa në tre mujorin e parë të vitit 2016.

politikave bujqësore në aspektin e masave që duhet të aplikohen, por jo në aspektin e shumës së alokuar për subvencionet dhe llojet e përfituesve.

Shumë studime kanë diskutuar që kufizimi kryesor i politikë-bërjes është mungesa e koordinimit dhe harmonizimit të politikave kombëtare serbe, më së shumti në lidhje me zbatimin e tyre e jo me aspektin e kuadrit konceptual (Podunavac 2011). E njëjta gjë mund të diskutohet nëse performanca e politikave bujqësore vlerësohet në raport me politikat tregtare. Vihet re një dështim në koordinimin e politikave bujqësore me politikat tregtare. Në përgjigje të krizës së tregut, qeveria shpesh ka përdorur instrumentet tregtare së bashku me masat e parashikuara në ligjin mbi stimujt dhe buxhetet bujqësore. Për shembull, në vitin 2015, qeveria serbe përdori Drejtorinë e Shtetit për Rezervat e Mallrave për të blerë prodhimin e tepërt të qumështit dhe për të aktivizuar tarifa shtesë për të mbrojtur tregun vendas nga konkurentët e huaj.

7.6 Përfundime dhe rekomandime për politikat

Sebia ka përparuar disi në përafrimin e dokumenteve të saj të programimit dhe strukturave administrative me kërkesat e BE-së, por progresi që është bërë për funksionalizimin e politikave efektive ka qënë i pamjaftueshëm.

Zhvillimi i ardhshëm i bujqësisë në Serbi përcaktohet në Strategjinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën 2014-2024, i cili është një dokument gjithëpërfshirës. Megjithatë, programi shumëvjeçar dhe paketat financiare për masat e politikave të ndryshme nuk u miratuan. Në mungesën e programimit afatmesëm, politikat bujqësore implementohen duke aplikuar Ligjin mbi Stimujt e Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural dhe Ligjin mbi Buxhetin, në bazë të rregulloreve vjetore dhe librave të rregullit. Për më tepër, procesit politikë-bërës i mungon përdorimi i një sistemi të standardizuar të monitorimit dhe vlerësimit për të vlerësuar zbatimin dhe ndikimet e masave të politikave dhe për të vlerësuar shkallën e koherencës midis objektivave të politikave dhe efektet e tyre. Këto kufizime të sistemit aktual serb të koordinimit të politikave, hartimit dhe zbatimit nën-kuptojnë që nuk mund të garantohet alokimi racional dhe efektiviteti i mbështetjes buxhetore për bujqësinë. Në përpjekje për të kapërcyer këto kufizime janë përdorur zgjidhje dhe instrumente të ndryshme ligjorë që janë jashtë shtrirjes së politikave bujqësore në vitet e fundit.

Shpërndarja aktuale a pagesave direkte tregon ekzistencën e një sërë mangësish sistematikë:

— Mbështetja për zhvillimin rural dhe për shërbimet e përgjithshme është e përfaqesuar jo mjaftueshëm në zbatimin aktual të politikave bujqësore. Një nivel veçanërisht i ulët mbështetjeje ka shkuar për mjedisin dhe zhvillimin e infrastrukturës rurale.

— Sistemi aktual për hartimin dhe zbatimin e pagesave direkte nuk mbështetet në objektiva dhe tregues të vlefshëm bazë apo në vlerësime ndikimi bazuar në evidenca të masave të aplikuara. Rrjedhimisht, objektivat e disa masave, llojeve të stimujve dhe kritereve të përzgjedhjes janë përkufizuar dobët, me rezultatin që një pjesë e madhe e buxhetit është shpenzuar në një mënyrë që nuk garanton arritjen e objektivave të përgjithshëm politikë të shprehur në strategji.

— Skemat e mbështetjes direkte ndaj prodhuesit përputhen vetëm pjesërisht me kërkesat e PPB-së. Shumica e masave të pagesës direkte implementohen në kufinj përzgjedhës me maksimum të ulët dhe kontribuojnë shumë pak në rritjen e konkurrueshmërisë dhe përshpejtimin e ndryshimeve strukturore në bujqësi, e cila është në kundërshtim me objektivat e përgjithshëm politikë të përkufizuara në strategji. Për më tepër, mbështetja direkte për prodhuesin lidhet me prodhimin (përdorimi i inputit, nivelin e prodhimit, sipërfaqen e kultivuar për kultura bimore të caktura apo numra krerësh të blegtorisë); kjo është në kundërshtim me PPB-në, e cila mbështetet gjerësisht në pagesat e palidhura me prodhimin (decoupled).

— Struktura e dyfishtë e fermave, e cila është karakteristikë e bujqësisë serbe, nuk reflektohet qartë në politikat bujqësore (p.sh. në kriteret e përzgjedhjes së

përfituesve). Edhe pse kufinjtë për përzgjedhjen e përfituesve janë vendosur në një nivel relativisht të ulët për shumicën e masave të zbatuara dhe i japin mundësi shumë fermerëve që të aplikojnë, kjo qasje çon në një nivel më të ulët jo-proporcional për shumë ferma të mëdha.

- Metoda e pagesave të kryera me shuma gjithëpërfshirëse 'lump sum', në të cilat pagesat janë të fiksuara në shuma të barabarta për të gjithë fermerët që marrin pjesë në skemë (pavarësisht madhësisë dhe specializimit të fermës), nuk bëjnë asnjë kontribut real në qëllimet më të gjera të sektorit (p.sh. ndryshimet strukturore, konkurrueshmëri më të lartë, mallrat publike, etj.). Duke u mbështetur në fonde buxhetore të kufizuara për bujqësinë, ky sistem kontribuon në objektivat e barazisë, por jo në rritjen e fermës apo konkurrueshmërinë e sektorit.
- Masat e mbështetjes që janë përshtatur për fermat e vogla për të adresuar nevojat e tyre specifike nuk janë marrë në konsideratë në politikat bujqësore serbe. Janë bërë disa përpjekje për të adresuar nevojat specifike të fermave të vogla që ndodhen në ZVN (p.sh. kufi minimal përzgjedhjeje relativisht i ulët i vendosur për shpërblesat në çmimin e qumështit, subvencione më të larta për investimet në fermë), por pyetja mbetet nëse këto masa janë të mjaftueshme apo jo për të adresuar nevojat e zhvillimit të këtyre fermave të vogla.

— Nevojitet një përshtatje më e mirë midis rolit mbështetës tek të ardhurat të pagesave direkte dhe objektivave të politikave të lidhura me konkurrueshmërinë dhe sigurimin e mallrave publike. Aktualisht, vetëm pagesat për sipërfaqe dhe për krerë alokuar për prodhimin organik synojnë përmirësimin e mjedisit; kritere të tjera mjedisore apo të lidhura me konkurrueshmrinë që shoqërojnë disbursimin e pagesave direkte (p.sh. menaxhimi i tokës, bashkëpunimi/kooperimi, transferimi i aseteve të fermave tek fermerët më të rinj, etj.) përdoren rrallë. Futja e konceptit të ndër-pajtueshmërisë si një kërkesë përzgjedhjeje për marrjen e mbështetjes direkte mund të adresojë pjesërisht këtë mangësi në politikat bujqësore aktuale, edhe pse mund të shkaktojë kosto shtesë në krijimin e kuadrit ligjor dhe institucional.

Reforma e dokumenteve ligjore, strategjike dhe programuese që qeverisin politikat bujqësore të Serbisë dhe strukturat institucionale të lidhura me pranimin në BE kanë qenë në krye të axhendës së Ministrisë së Bujqësisë për disa vite. Megjithatë, progresi drejt adoptimit dhe zbatimit të nevojshëm të ndryshimeve në politikat bujqësore, në veçanti ato të lidhura me harmonizimin e tyre me PPB-në,mund të vihet në praktikë. Kjo përkeqësohet nga fakti që akreditimi i Agjencisë së Pagesave nuk është përfunduar, si rezultat i të cilit disbursimi i fondeve IPARD, fonde të cilat mund të përdoren për ndërtimin institucional dhe konkurrueshmëri të përmirësuar të sektorit bujqësor, ka gjasa të vonohet përtej kohës së menduar (2016). Për më tepër, pasiguria për dinamikat e pranimit në BE dhe zhvillimet e fundit në tregjet globale dhe rajonale kërkojnë një fokus më të fuqishëm në situatën reale dhe problemet e sektorit bujqësor. Rrjedhimisht, një vendim politik i qartë mbi objektivat politikë parësorë (zgjedhja midis konkurrueshmërisë, barazisë dhe mallrave publike) dhe vendosjes së synimeve eksplicite, janë të një rëndësie të veçantë për të siguruar vendosjen efektive të mbështetjes për bujqësinë.

Referenca

Baza e të dhënave të bujqësisë dhe politikave bujqësore (2016). Bazë e të dhënave e konsoliduar dhe e përpiluar për Shqipërinë, Bosnje e Hercegovinën, Kosovën*, IRJ të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë. Gjendet në:http://app.seerural.org/agricultural-statistics/.

Baza e të dhënave MPB APM (2016). Databaza e Masave të Politikave Bujqësore përpiluar për Shqipërinë, Bosnjën e Hercegovinën, Kosovën*, IRJ të Maqedonisë, Kosovën*, IRJ të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë (të dhëna të papublikuara).

Bajramović, S., Nikolić, A., Butković, J. (2014). Bujqësia dhe Politikat Bujqësore në Bosnje e Hercegovinë. Në: Volk, T., Erjavec, E., Mortensen, K. (red.): Politikat Bujqësore dhe Integrimi Evropian në Evropën Juglindore, FAO, Budapest, fq. 73-94.

Bajramović, S., Ognjenović, D., Butković, J. (2016). Bosnja dhe Hercegovina: Prezantim mbi Politikat Bujqësore. Në: Volk, T. et al. (red.): Analizë e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural në vendet e Ballkanit Perëndimor. EUR 27898 EN, Qendra e Bashkuar Kërkimore, Komisioni Evropian, doi:10.2791/744295, fq. 52-67.

Bogdanov, N., Stević, M., Papić, R. (2016). Politikat bujqësore në Serbi – sfida dhe zgjidhje aktuale. Në: Stojanovic, Bogdanov, N., Sevarlic, M. (red.): Statusi dhe perspektiva të agro-biznesit dhe zonave rurale në Serbi, NDES, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Beogradit, fq. 114-136.

Cochran, C.E., Mayer, L.C., Carr, T.R., Cayer, N.J. (2009). Politika publike amerikane; Një hyrje. Wadsworth Cengage Learning.

Dimitrievski, D., Kotevska, A., Janeska Stamenkovska, I., Tuna, E., dhe Nacka, M. (2014). Bujqësia dhe politikat bujqësore në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Në: Volk, T., Erjavec, E., Mortensen, K. (red.): Politikat bujqësore dhe integrimi evropian në Evropën Juglindore, FAO, Budapest, fq. 121–134.

KE (2014). Instrumente për Asistencën Para- Anëtarësimit (IPA II) 2014-2020: Programi i Mbështetjes së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural V, Komisioni Evropian, Bruksel.

KE (2015). Raporti i Progresit Kosovë 2015. Strategjia e Zgjerimit 2015, Dokumente Pune të Stafit të Komisionit, Komisioni Evropian, Bruksel.

BE (2016). Raporti Financiar i 9të nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshilli mbi Fondin Evropian mbi Garancinë Bujqësore Viti Financiar 2015. Dokument Pune i Stafit të Komisionit që shoqëron dokumentin e Raportit nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshilli, Komisioni Evropian COM(2016) 578. Gjendet në: http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52016SC0293&from=EN.

FBH (2014a). Strategjia e Zhvillimit Afatmesëm e Sektorit Bujqësor në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës 2015-2019. Ministria e Bujqësisë, Menaxhimit të Ujërave dhe Pylltarisë së Federatës së BA, Sarajevë.

FBH (2014b). Programi i Zhvillimit Rural të Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës për Periudhën 2014-2020. Ministria e Bujqësisë, Menaxhimit të Ujërave dhe Pylltarisë së Federatës së BA, Sarajevë.

QSH (2013). Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020. Qeveria e Shqipërisë, Tirana.

QK (2015). Kuadri i Shpenzimeve Afatmesme 2016-2018. Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Prishtinë.

QK (2016). Programi i Reformimit Ekonomik 2016-2018. Qeveria e Kosovës, Prishtinë.

Kotevska, A. dhe Martinovska Stojceska, A. (red) (2015). Ndikimi i strukturës socio-ekonomike të popullsisë rurale në suksesin e politikave të zhvillimit rural – Maqedonia, Serbia dhe Bosnje dhe Hercegovina. Shoqata e Ekonomistëve Bujqësorë të Republikës së Maqedonisë, Shkup.

MBPZHR (2010). Strategjia e Konsolidimit të Tokës 2010-2020. Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë.

MBPZHR (2013). Programi për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural 2014-2020. Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë.

MBPEU (2010). Ligji mbi bujqësinë dhe zhvillimin rural. Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë së Ujërave, Shkup (në maqedonisht)

MBPEU (2013). Programi kombëtar për bujqësinë dhe zhvillimin rural për periudhën 2013-2017. Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë së Ujërave, Shkup (në maqedonisht).

MBPEU (2014). Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural 2014-2020. Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë së Ujërave, Shkup (në maqedonisht).

MBZHR (2006). Bujqësia e Malit të Zi dhe Bashkimi Evropian – Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Podgoricë.

MBZHR (2015a). Strategjia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zonave Rurale - 2015-2020. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Podgoricë.

MBZHR (2015b). Plani i Veprimit për përafrimin me acquis, Kapitulli 11 – Bujqësia dhe Zhvillimi Rural. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Podgoricë.

MBZHRAU (2014a). Strategjia Ndër-Sektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (SNBZHR 2014-2020). Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 709, 29.10.2014, Tiranë.

MBZHRAU (2014b). Masterplani i Veprimit për zbatimin e SNBZHR 2014-2020. Dokumente pune të stafit, Tiranë.

MBZHRAU (2016a). Plan Veprimi për zbatimin e SNBZHR 2016-2018. Dokumente pune të stafit, Tiranë.

MBZHRAU (2016b). Raporte vjetore të Këshillit të Ministrave. Dokumente pune të stafit, Tiranë.

MBZHRAU (2016c). Raport Bashkimit Evropian – Takimi i nën-komisionit shqiptar për Bujqësinë dhe Peshkimin për 2015, Tiranë.

MF (2013a). Programi i Malit të Zi për Anëtarësimin në Bashkimin Evropian për Periudhën 2014-2018. Ministria e Financave, Podgoricë.

MF (2013b). Direktivat e Zhvillimit të Malit të Zi 2013-2016. Ministria e Financave, Podgoricë.

MTJME (2016). Raport mbi asistencën ndërkombëtare për sektorin e bujqësisë, ushqimit dhe zhvillimit rural 2015 në Bosnje dhe Hercegovinë. Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike të BA-së, Sarajevë.

ZHIFBMZ (MIDAS) (2014).Zhvillimi Institucional dhe Fuqizimi Bujqësor i Malit të Zi, Zyra e Huave dhe Granteve IBRD dhe GED. Banka Botërore dhe MBZHR. Gjendet në: http//www.midas.co.me (accessed November, 2014).

Miftari I., Hoxha B., Gjokaj E. (2016). Kosovë: prezantim i politikave bujqësore. Në: Volk, T., Erjavec E., Ciaian, P., y Paloma, S.G. (red). Analizë e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Qendra e Bashkuar Kërkimore, Komisioni Evropian, EUR 27898 p 77-88, doi:10.2791/744295.

Miftari, I., Hoxhaj, H. (2014). Bujqësia dhe politikat bujqësore në Kosovë. Në: Volk, T., Erjavec, E., Mortensen, K. (red.): Politikat bujqësore dhe Integrimi Evropian në Evropën Juglindore, FAO, Budapest, fq 107-119.

Mrdalj, V. (2015). Analiza agregatne budžetske podrške poljoprivrednim proizvođačima (PSEb) u Republici Srpskoj, Agroznanje, Vol. 16 (3) (327-337), Banja Luka.

OECD (2008). Vlerësimi i Mbështetjes për Prodhuesin e OECD-së dhe treguesit e lidhur të mbështetjes bujqësore; Koncepte, përllogaritje, interpretime dhe përdorimi (manual PSE), Drejtoria e Tregtirsë dhe Bujqësisë OECD, Paris. Gjendet në: https://www.oecd.org/tad/agricultural-policies/psemanual.htm.

Gazeta Zyrtare e Serbisë, 41/2009 dhe 10/2013. Ligji mbi Bujqësinë dhe Zhvillimin Bujqësor.

Gazeta Zyrtare e Serbisë, 142/2014 dhe 103/2015. Ligji mbi Stimujt në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural.

Podunavac, M. (red) (2011). Politikat publike të Serbisë (Javne politike Srbije). Heinrich Böll Stiftung, Zyra rajonale për Evropën Juglindore, Beograd.

Rednak, M., Volk, T., Erjavec, E. (2013). Një mjet për klasifikimin uniform dhe analizat e mbështetjes buxhetore të bujqësisë për vendet kandidate në BE. Analizë e Ekonomisë Bujqësore, 2013, vëll. 14, nr. 1, 76-96.

RSR (2015a). Plani Strategjik për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zonave Rurale në Republikën Srpska 2016-2020. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave të Republikës Srpska, Banja Luka.

RSR (2015b). Informacija o Zakonu o podsticajima o poljoprivredi i ruralnom razvoju. Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i vodoprivrede Republike Srpske, Banja Luka.

Vaško, Ž., Ostojić, A., Roković, G., Drinić, L., Mrdalj, V., Figurek, A., Brković, D. (2016). Poljoprivreda i ruralni razvoj u Republici Srpskoj do 2020. Godine. Univerzitet u Banjoj Luci, Poljoprivredni fakultet, Banja Luka.

Volk, T. (ed.) (2010)., Bujqësia në vendet e Ballkanit Perëndimor. Studime mbi sektorin bujqësor dhe të ushqimit në Evropën Qendrore dhe Lindore, vol. 57. Leibniz-Institut für Agrarentëicklung in Mittel- und Osteuropa (IAMO), Halle (Saale). Gjendet në:http://www.iamo.de/dok//sr_vol57.pdf.

Volk, T., Erjavec, E., Mortensen, K. (red.) (2014). Politikat bujqësore dhe integrimi evropian në Evropën Juglindore. Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara, Budapest. Gjendet në: http://seerural.org/wp-content/uploads/2009/05/FAO-SWG-Book-12-11-2014_Final.pdf.

Volk, T., Erjavec, E., Ciaian, P., y Paloma, S. G. (red.) (2016). Analiza e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural të vendeve të Ballkanit Perëndimor. EUR 27898 EN, Qendra e Bashkuar Kërkimore, Komisioni Evropian, EUR 27898, doi:10.2791/744295.

Lista e akronimeve dhe përkufizimeve

AL	Shqipëria
ZVN	Zona që përballen me Veshtirësi Natyrore
MPB	Masa të Politikave Bujqësore
PZHBR	Programi për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
BA	Bosnja dhe Hercegovina
QB	Qarku Bërçko
PPB	Politikat e Përbashkëta Bujqësore
CEFTA	Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
PRE	Programi i Reformimit Ekonomik
RRDHKF	Rrjeti i të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave
FAO	Organizata për Ushqimin dhe Bujqësinë e Kombeve të Bashkuara
FBH	Federata e Bosnje e Hercegovinës
IRJ e Maqedonisë	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYR)
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
VSHB	Vlera e Shtuar Bruto
ARPKK	Analiza e Riskut dhe Pikat Kritike të Kontrollit
SIAK	Sistemi i Integruar i Administrimit dhe Kontrollit
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
IPA	Instrumenti përAsistencë Para-Anëtarësimi
IPARD	Instrumenti përAsistencë Para-Anëtarësimi për Zhvillimin Rural
SNBZHR	Strategjia Ndër-sektoriale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
JRC / QPK	Qendra e PërbashketKërkimore e Drejtorisë së Përgjithshme
LEADER	Liaison Entre Actions de Développement de l'Économie Rurale (Lidhjet mesEkonomisë rurale dhe Veprimeve Zhvillimore)
SIPT	Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe ZhvillimitRural
MBPEU	Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë së Ujërave
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujit
ME	Mali i Zi
MIDAS	Zhvillimi Institucional dhe Fuqizimi Bujqësori Malit të Zi
MK	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
SKZHBR	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PFB	Pariteti i Fuqisë Blerëse
RS	Serbia

RSR	Republika Serbe e Bosnjës
SWG	Grupi i Përhershëm Punues për Zhvillimin Rural Rajonal
ATSHI	Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit
SBSH	Sipërfaqe Bujqësore e Shfrytëzuar
BP	Ballkani Perëndimor
XK	Kosova, nën Rregulloren 1244/99, të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, në referenca përdoret si Kosovë*

Lista e figurave

Figura 1.1. Prirjet në nivelet e prodhimit të kulturave bimore në vendet e BP-së për periudhën 2010-2015 (përqindjet ndaj niveleve në 2010).....11

Figura 1.2. Prirjet në numrin e krerëve të blegtorisë dhe niveleve të prodhimit të qumështit në vendet e BP-së, 2010 – 2015 (Perqindja ndaj niveleve në 2010).....12

Figura 1.3. Prirjet në nivelet e prodhimit bujqësor agregat në disa prej vendeve të BP-së, 2010-2015 (perqindja ndaj nivelit në vitin 2010) ([a]).....13

Figura 1.4. Tregtia e produkteve agro-ushqimore në vendet e BP-së (milionë euro),2010-2015.....14

Figura 1.5. Eksportet e produkteve agro-ushqimore si një pjesë e importeve të produkteve agro-ushqimore në vendet e BP-së, 2010-2015. 14

Figura 1.6.Përbërja rajonale e eksporteve të produkteve agro-ushqimore në vendet e BP-së, 2010-2015.....16

Figura 1.7.Përbërja rajonale e importeve të produkteve agro-ushqimore në vendet e BP-së, 2010-2015 16

Figura 1.8. Niveli relativ i mbështetjes totale buxhetore për bujqësinë në vendet e BP-së (euro/ha SBSH).....20

Figura 1.9.Përbërja e mbështetjes totale buxhetore për bujqësinë sipas shtyllave të MPB-së në vendet e BP-së, 2010 – 2015. 20

Figura 1.10. Niveli relativ i mbështetjes direkte për prodhuesin në vendet e BP-së (euro/ha të SBSH), 2010 - 2015.....22

Figura 1.11.Përbërja e masave të mbështetjes direkte për prodhuesin në vendet e BP-së, 2010 – 2015.....22

Figura 1.12. Nivelet relative të mbështetjes së zhvillimit strukturor dhe rural në vendet e BP-së (euro/ha, SBSH), 2010 - 2015 23

Figura 1.13. Përbërja e mbështetjes së zhvillimit strukturor dhe rural në vendet e BP-së, 2010-2015 24

Figura 1.14.. Niveli relativ i mbështetjes së përgjithshme për bujqësinë në vendet e BP-së (euro/ha e SBSH).....25

Figura 1.15.Përbërja e mbështetjes së përgjithshme për bujqësinë në vendet e BP-së, 2010-2015 26

Figura 1.16.Pagesat direkte dhe subvencionet e inputit në Shqipëri sipas mallrave, 2010-2015 32

Figura 1.17. Pagesat direkte dhe subvencionet për input në Bosnje e Hercegovinë sipas mallrave, 2010-2015. 32

Figura 1.18. Pagesat direkte dhe subvencionet e inputit në Kosovë* sipas mallrave, 2010-2015. 33

Figura 1.19. Pagesat direkte dhe subvencionet e inputit në IRJ të Maqedonisë sipas mallrave, 2010 – 2015. 34

Figura 1.20. Pagesa direkte dhe subvencionet e inputit në Malin e Zi sipas mallrave, 2010 – 2015. 35

Figura 1.21. Pagesat direkte dhe subvencionet e inputit në Serbi sipas grup-mallrave, 2010-2015 35

Figura 2.1. Mbështetja buxhetore për bujqësinë sipas shtyllave të MPB-së në Shqipëri, 2010-2015 44

Figura 2.2. Shpenzimet buxhetore për masat e përgjithshme të lidhura me bujqësinë në Shqipëri, 2010-2015. 46

Figura 3.1.Vështrim i përgjithshëm i mbështetjes direkte ndaj prodhuesit në Bosnje e Hercegovinë (milionë euro), 2010-2015. 61

Figura 3.2.Përbërja e pagesave direkte për prodhuesit në Bosnje e Hercegovinë, 2010-2015.....62

Figura 3.3.Përbërja e pagesave direkte ndaj prodhuesit sipas grup-mallrave kryesore në Federatën e Bosnje e Hercegovinës dhe në Republikën Serbe të Bosnjes RSR(%), 2015.....62

Figura 4.1. Zhvillimi i mbështetjes buxhetore për bujqësinë në Kosovë*, 2010-2015....69

Figura 4.2. Zhvillimi i mbështetjes buxhetore për përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor në Kosovë*, 2010-2015.....70

Figura 5.1. Mbështetja buxhetore për bujqësinë në IRJ të Maqedonisë, 2010-2015. 77

Figura 5.2. Shpenzimet buxhetore për mbështetjen direkte për prodhuesin në IRJ të Maqedonisë, 2010-2015. 77

Figura 5.3. Shpenzimet buxhetore për masat e zhvillimit strukturor dhe rural në IRJ të Maqedonisë, 2010-2015. 78

Figura 5.4.Mbështetja e përgjithshme për bujqësinë në IRJ të Maqedonisë, 2010-2015. 79

Figura 6.1. Mbështetja buxhetore për bujqësinë në Malin e Zi (fonde të planifikuara), 2010-2015. 85

Figura 6.2. Mbështetja e tregut dhe ajo direkte për prodhuesin në Malin e Zi (fonde të planifikuara), 2010-2015.....85

Figura 6.3. Mbështetja e zhvillimit strukturor dhe rural në Malin e Zi (fonde të planifikuara), 2010-2015.....86

Figura 6.4. Mbështetja e përgjithshme për bujqësinë në Malin e Zi (fonde të planifikuara), 2010-2015.....88

Figura 7.1. Mbështetja buxhetore për bujqësinë në Serbi, 2010-2015.....95

Figura 7.2.Shpenzimet buxhetore për mbështetjen tregut dhe asaj direkte për prodhuesin në Serbi, 2010-2015. 96

Figura 7.3. Mbështetja direkte ndaj prodhuesit sipas grup-mallrave në Serbi, 2010-2015. 96

Lista e tabelave

Tabla 1.1. Vlerësimi i njehsimit të metodologjive statistikore në vendet e BP-së me rregullat dhe përkufizimet e Eurostat-it, 2015 6

Tabela 1.2. Skema e klasifikimit të MPB-së e mbështetjes buxhetore për bujqësinë..... 7

Tabela 1.3. Sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar e përdorur për llogaritjen e niveleve relative të mbështetjes buxhetore për bujqësinë në vendet e BP. 8

Tabela 1.4. Baza e konsoliduar e të dhënave për bujqësinë dhe politikat bujqësore hartuar për vendet e BP-së: pamje e faqes së përmbajtjes. 9

Tabela 1.5.Rëndësia e bujqësisë në ekonominë e vendeve të BP-së.....10

Tabela 1.6. Rëndësia e sektorit agro-ushqimor në tregtinë e jashtme në vendet e BP-së. 13

Tabela 1.7. Përbërja e eksporteve agro-ushqimore sipas grupeve më të rëndësishme tarifore në shtetet e BP-së (%) 15

Tabela 1.8. Pamje e përgjithshme e dokumenteve të programimit afatmesëm dhe afatgjatë në vendet e BP-së. 18

Tabela 1.9. Mbështetja buxhetore totale për bujqësinë në vendet e BP-së (milionë euro), 2010-2015 19

Tabela 1.10. Mbështetja direkte për prodhuesin në vendet e BP-së (milionë euro), 2010-2015. 21

Tabela 1.11. Mbështetja e zhvillimit strukturor dhe rural në vendet e BP-së (milionë euro), 2010–2015. 23

Tabela 1.12 Mbështetja e përgjithshme për bujqësinë në vendet e BP-së (milionë euro), 2010 - 2015.....25

Tabela 1.13. Skemat e pagesve direkte dhe subvencionet e inputit në vendet e BP-së sipas shumës së pagesës për njësi dhe mall/produkt, 2015. 28

Tabela 1.14.. Kërkesat minimale për sa i përket sasive të shitura, hektarëve nën kultivim dhe numrit të krerëve në vendet e BP-së sipas skemave kryesore të pagesave direkte, 2015. 30

Table 2.1. Niveli relativ i mbështetjes buxhetore për bujqësinë në Shqipëri, 2010 – 2015. 44

Tabela 2.2. Shpenzimet buxhetore për masat e zhvillimit strukturor dhe rural në Shqipëri (milionë euro), 2010-2015.....45

Tabla 2.3. Mbështetja direkte për prodhuesin në Shqipëri (milionë euro), 2010-2015. ..46

Tabela 2.4. Krahasimi midis planifikimit dhe zbatimit aktual të reformave të politikave institucionale dhe bujqësore në Shqipëri. 49

Tabela 3.1. Zhvillimi i mbështetjes buxhetore për bujqësinë në Bosnje e Hercegovinë (milionë euro) 2010-2015.....56

Tabela 3.2. Numri i pagesave direkte të zbatuara dhe skemat e subvencionit për inputin në Bosnje e Hercegovinë sipas njësive administrative, 2010 dhe 2015. 58

Tabela 3.3. Skemat e pagesave direkte dhe subvencioneve të inputit të zbatuara në Bosnje e Hercegovinë në vitin 2015 nga njësitë administrative. 60

Tabela 4.1.PZHBR 2014-2020 e Kosovës*: prioritetet dhe masat e përzgjedhura për zhvillimin rural. 68

Table 4.2. Skemat e pagesave direkte të zbatuara në Kosovë* sipas llojit dhe sektorit, 2010-2015. 71

Table 4.3. Shpenzimet buxhetore për pagesat direkte dhe subvencionet e inputit në Kosovë* (milionë euro), 2010-2015. 72

Tabel 5.1.Vështrim i përgjithshëm i pagesave direkte të zbatuara në IRJ të Maqedonisë,2015 80

Tabela 6.1. Afati kohor tregues për përshtatjen e politikave të zhvillimit rural në Malin e Zi me sistemin IPARD. 87

Tabela 6.2. Pasqyra e skemave të pagesave direkte të zbatuara në Malin e Zi, 2015 89

Tabela 6.3. Aktivitetet e planifikuara për harmonizimin e pagesave direkte në Malin e Zi. 90

Tabela 7.1. Masat e mbështetjes të parashikuara nga Ligji mbi Stimujt në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural në Serbi. 94

Tabela 7.2. Mbështetja direkte ndaj prodhuesit sipas grup-masave në Serbi (milionë euro), 2013-2015 97

Tabela 7.3. Mbështetjet në cmim të produkteve të bulmetit në Serbi (euro/litër), 2010-2015. 98

Tabela 7.4. Skemat e pagesave bazuar në sipërfaqe në Serbi (euro/ha), 2010-2015. ...99

Tabela 7.5 Skemat e pagesave direkte bazuar në numrin e krerëve të blegtorisë në Serbi (euro/krerë ose euro/koshere), 2010-2015.....99

Tabela 7.6. Skemat e subvencionit për input në Serbi, 2010-2015. 100

Table 7.7. Realizimi i mbështetjes buxhetore të planifikuar për masat e përzgjedhura në Serbi në vitin 2015. 101

Europa Direct është një shërbim për t'ju ndihmuar që të gjeni përgjigjet e pyetjeve tuaja mbi Bashkimin Evropian.

Telefon pa pagesë (*)**:**

00 800 6 7 8 9 10 11

(*)Informacioni jepet falas, sikundër janë edhe shumica e telefonatave (edhe pse disa operatorë, kabina telefonike apo hotele mund t'ju kërkojnë pagesë)

Më shumë informacion mbi Bashkimin Evropian gjendet në internet (http://europa.eu).

SI TË SIGURONI PUBLIKIMET E BE-së

Publikime pa pagesë:

- një kopje:
  nëpërmjet librarisë së BE-së (http://bookshop.europa.eu);
- për më shumë se një kopje apo poster/harta:
  nga përfaqësitë e Bashkimit Evropian (http://ec.europa.eu/represent_en.htm);
  nga delegacionet në vendet jashtë BE-së (http://eeas.europa.eu/delegations/index_en.htm);
  duke kontaktuar shërbimin e Evropa Direkt (http://europa.eu/europedirect/index_en.htm) ose duke telefonuar 00 800 6 7 8 9 10 11 (telefon pa pagesë nga çdo vend në BE (*).

  (*)Informacioni jepet falas, sikundër janë edhe shumica e telefonatave (edhe pse disa operatorë, kabina telefonike apo hotele mund t'ju kërkojnë pagesë).

Publikime me pagesë:

- nëpërmjet Librarisë së BE-së (http://bookshop.europa.eu).

KJ-NA-28527-EN-N

JRC Mission

As the science and knowledge service of the European Commission, the Joint Research Centre's mission is to support EU policies with independent evidence throughout the whole policy cycle.

EU Science Hub
ec.europa.eu/jrc

@EU_ScienceHub

EU Science Hub - Joint Research Centre

Joint Research Centre

EU Science Hub

doi:10.2760/146697
ISBN 978-92-79-66935-4